



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHE

KRYETAR I KKT-së  
Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS SË ENERGJISË

Z. DAMIAN GJERNUKI

Kryetar i Këshillit Bashkisë

Z. Enver Sulejmani

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkisë

Nr. 28 Datë 24.04.2018

Kryetar i Bashkisë

Z. Gjon Gjonaj

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR I BASHKISE PUKË

STRATEGJIA TERRITORIALE

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 1, Datë 20.06.2018

DPKZHT: Z. Eduard Sokoli

KONSULENT "GAIA S.A. MELETON", Dimitrios Mamounis, Nr. Liç.554





## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>HYRJE .....</b>	<b>3</b>
<b>1. STRATEGJA TERRITORIALE .....</b>	<b>5</b>
1.1. Udhëzime të detyrueshme dhe dispozita .....	5
1.2. Rezultatet për konsultim publik .....	8
1.3. Analiza e metabolizmit dhe vlerësimi i përgjithshëm i territorit të njësisë .....	10
1.4. Përcaktimi i territorit sipas pesë sistemeve territoriale .....	32
1.5. Identifikimi i nevojave, potenciali dhe kufizimet .....	35
1.6. Vizioni i Zhvillimit dhe Strategja Territoriale .....	42
1.6.1. Vizioni i zhvillimit .....	42
1.6.2. Strategja dhe Objektivat e Zhvillimit .....	42
1.6.3. Parimet dhe politikat kryesore për çdo sistem.....	48
1.6.4. Parashikime demografike.....	57
1.6.5. Rezervat e strehimit.....	63
1.6.6. Parashikimet financiare .....	76
1.6.7. Struktura e ndërtimeve .....	90
1.6.8. Niveli i cilësisë së mjedisit.....	92
1.7. Ndryshime të mundshme të sistemeve .....	96
<b>2. PLANI I VEPRIMEVE STRATEGJIKË DHE PROJEKTET PILOT TË ZHVILLIMIT .....</b>	<b>98</b>
2.1. Plani i Veprimit .....	98
2.2. Projekte Pilote të zhvillimit.....	127
<b>ANEKS .....</b>	<b>166</b>
1. KONSULTIMI ME GRUPET E INTERESIT DHE AKTORË TË NDRYSHËM .....	166
2. SYGJERME DHE KOMENTE NGA PJESMARËSIT NË DËGJESËN E DYTË PUBLIKE.....	169
3. TAKIM E FORUMIT TË BASHKËRENDIMIT TË PLANIFIKIMIT VENDOR (FBPV) .....	179
4. TREGUESIT E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT .....	183
<b>REFERENCAT .....</b>	<b>196</b>





## HYRJE

Ky material është një relacioni teknik i fazës B të studimit "Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkitë Pukë". Në këtë fazë është hartuar Strategjia Territoriale e Bashkisë Pukë, ku përfshihen vizioni i zhvillimit të Bashkisë për vitin 2032, objektivat strategjike dhe akset prioritare, si dhe është formuluar plani i veprimit me projektet e propozuara për Bashkinë.

Për studimin "Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkitë: MIRDITË, PUKË", u nënshkrua një kontratë më 04-07-2017 ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe GAIA SA, ndërsa, në të njëjtën kohë, u nënshkrua marrëveshja trepalëshe ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Urban, Bashkisë Mirditë dhe kompanisë GAIA SH.A. STUDIME, më 06-07-2017.

Pas nënshkrimit të kontratës, u realizua takimi për nisjen e procesit të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, ditën e Enjte, më 06.07.2017, ku edhe u prezantuan pikat kyçë dhe hapat për përgatitjen dhe përfundimin e studimit dhe u analizuan rolet e të gjitha palëve të përfshira. Në kuadër të takimit hapës, u realizua takimi i parë njohës ndërmjet kryetari të Bashkisë Ndrec Dedaj dhe stafit të saj, z. Altin Marashi (Drejtor i Urbanistikës), znj. Adelina Dukaj (urbaniste e bashkissë) dhe z. Blenard Dudi (ekspert GIS-i), me përfaqësuesit e studiuesve të Shoqërisë GAIA SH.A. STUDIME. Në vazhdim, filluan punimet për grumbullimin dhe analizën e të dhënavë. Faza A u prezantua më 14 Shtator 2017 në një konsultim publik të organizuar në Pukë dhe u dorëzua më 18 Shtator 2017. Në këtë Fazë B, e cila është faza e vlerësimit të rezultateve të analizave, identifikohen problemet dhe mundësitë e zonës së studimit dhe bëhen disa parashikime të popullsisë, si edhe parashikime ekonomike për një periudhë kohore të 15 viteve të ardhshme. Qëllimi i kësaj faze është formulimi i planit të veprimit të bashkisë dhe programet kryesore pilote të zhvillimit, me qëllim përbushjen e vizionit të zhvillimit dhe strategjisë së bashkisë.

Në këtë pikë dëshirojmë të falenderojmë kryetarin e Bashkisë së Pukës z. Gjon Gjonaj për bashkëpunimin dhe sigurimin e informacionit të vlefshëm për vizionin e qytetit.

Dëshirojmë gjithashtu të falenderojmë të gjithë stafin e Bashkisë dhe posaçërisht Eduard Sokoli (Arkitekt, Drejtor Urbanistike), Endrit Kraja (Jurist), Gjin Filipi (Pergjesës Sektori i Pyjores), Denisa Islami (Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore), Mirjana Pashkaj (Specialiste IT dhe Turizëm), Agron Hadroj (Përgjegjës PMNZSH) dhe Behar Ademi (Specialist në Sektorin e Shërbimeve) dhe z. Petrit Dedaj (Specialist Hartograf), me të cilët kemi pasur komunikim të vazdueshëm, bashkëpunim dhe shkëmbim të dhënash dhe mendimesh gjatë gjithë Fazës A dhe Fazës B.

Gjatë gjithë zhvillimit të përgatitjes së Fazës A dhe B të studimit, kishte një bashkëpunim të plotë dhe komunikim të dyanshëm me AKPT dhe z. Taulant Dano dhe z. Ermal Pashollari, të cilët janë mbikëqyrësit e përgjithshme dhe koordinatorët e planit «Hartimi i Planit të Përgjithshëm Vendor për bashkitë: MIRDITË, PUKË».



cilin do të dëshironim ta falënderonim për kontributin e tij të rëndësishëm në hartimin e Fazës A dhe B të studimit.

Së fundi, do të donim të falënderonim të gjithë anëtarët e Grupit të Studimit GAIA SH.A. STUDIME dhe veçanërisht partnerët vendorë:

zpj. Diana Bardhi, Inxhiniere Civile, Udhëheqëse e Ekipit, Zyra Vendore Tiranë

zpj. Boriana Golgota, Arkitekte dhe Urbaniste, Zyra Vendore Tiranë

z. Elton Toska, Arkitekt, Koordinator i të gjitha Ekipave Vendore në bashkitë Pukë dhe Mirditë

zpj. Etmira Kanani, Eksperte Ligjore



# 1. STRATEGJIA TERRITORIALE

## 1.1. Udhëzime të detyrueshme dhe dispozita


### PROJEKTE KOMBËTARE

Legjislacioni kombëtar i planifikimit të territorit, konkretisht Ligji nr. 107, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” parashikon materializimin e Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK), Planeve Kombëtare Sektoriale (PKS) për të gjithë territorin kombëtar ose pjesëve të tij dhe të Planeve të Detajuara për Zona me Rëndësi Kombëtare (PDZRK), si mjete bazë të planifikimit hapësinor kombëtar.

Në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të integruar të Bashkisë, objektivat dhe politikat strategjike bazohen në udhëzimet e detyrueshme të parashikuara nga Plani Kombëtar i Rregullimit të Territorit. Në veçanti, lidhur me rëndësnë e tij në nivel politik, institucional dhe ekonomik; përfitimet e shumta (ekonomike, sociale e mjedisore) shtjellohen nëpërmjet qëllimeve të mëposhtme:

- Promovimi i kohezionit territorial përmes zhvillimit të balancuar ekonomik dhe social të rajoneve dhe përmirësim të konkurrencës.
- Nxitje e zhvillimit të gjeneruar nga funksionet e përziera urbane dhe përmirësimi i marrëdhënieve midis zonave urbane dhe rurale.
- Promovim të aksesit.
- Përmirësimi i aksesit në njohuri dhe informacion.
- Reduktimi i dëmtimit të mjedisit.
- Mbrojtja e burimeve natyrore dhe kulturore.
- Forcimi i trashëgimisë kulturore si faktor i zhvillimit.
- Zhvillimi i burimeve të energjisë duke ruajtur, paralelisht, sigurinë e energjisë.
- Promovimi i cilësisë dhe turizmit të qëndrueshëm.
- Ulja e ndikimit të fatkeqësive natyrore.

PPK identifikon pesë sistemet territoriale (urban, bujqësor, natyror, ujor dhe të infrastrukturës) me objektiva dhe politika specifike, të cilat organizohen sipas qendrave, akseve dhe zonave. Plani i Përgjithshëm Kombëtar propozon konsolidimin dhe zhvillimin policentrik të sistemit **urban**, i cili do të zbusë diferencimet dhe pabarazitë. Gjithashtu nxit fuqizimin e rajoneve të cilat kanë marrëdhënie komunikimi dhe plotësuese me njëra-tjetrën. Për sa i përket sistemit **bujqësor** propozohen politika për mbrojtjen e tokës bujqësore ndaj zhvillimit urban. Objektivi kryesor është rritja e efikasitetit dhe produktivitetit të prodhimit bujqësor, përmes politikave si ruajtja, stabilizim (konsolidim) e modernizi i proceseve agrare. Në vijim, PPK parashikon mbrojtjen dhe promovimin e sistemit **natyror**, duke zgjeruar përqindjen totale të zonave të mbrojtura në nivel kombëtar. Rëndësi e veçantë i jepet sistemit **ujor**, i cili pasqyron disa problematika si: menaxhimi i burimeve ujore, sigurimi i cilësisë së tyre si dhe kontrolli nga ndotjet që ndodhin në këto sipërfaqe. Në këtë kuadër, PPK ka formuluar rekomandimet përkatëse për menaxhimin e



kontrolluar si përdorimi racional i ujit, kontrolli i aktiviteteve të jashtëligjshme, koordinimi dhe bashkëpunimi me shërbimet vendase, razonale e qëndrore, përmirësimi i kuadrit institucional për monitorimin, menaxhimi i qëndrueshëm i ujërave nëntokësore duke përfshirë puset, kontrollin dhe shfrytëzimin e ujërave të shiut, investime në fushën e kërkime shkecore lidhur me resurset ujore. PPK mbështet zhvillimin e integruar të **sistemit infrastrukturor** duke nxitur përmirësimin e rrjeteve të transportit, energjisë dhe komunikacionit. Kështu, parashikohet zhvillimi i sistemit të transportit multimodal, si një sistem i integruar dhe miqësor me mjedisin, i cili do të sigurojë lidhjen dhe aksesin në nivel kombëtar e ndërkufitar, do të promovojë transportin publik dhe mjetet alternative të tij, dhe do të lidhë akset rrugore të transportit me kalimet turistike e historike.

Bashkia Pukë përshkohet nga aksi interurban Shkodër - Vau i Dejës - Kukës, i cili i takon akseve tërthore mbështetëse. Ky aks lidhet në lindje me korridorin strategjik tërthor "Ruga e Kombit" dhe me qytetin e Kukësit, i parashikuar si nyje ndërkombëtare, ndërsa në perëndim me korridorin strategjik gjatësor "Autostradën Veri-Jug" dhe me qytetin e Shkodrës, i parashikuar si hub ndërkombëtar.

Bashkia Pukë është pjesë e zonës me specifikë zhvillimit Pukë - Mirditë - Fushë Arrëz. Nëntoka e kësaj zone është e pasur me minerale, duke u dalluar për industrinë nxjerrëse dhe përpunuese të tyre. Në veçanti, në pjesën veriore të Bashkisë Mirditë, në lindje të Bashkisë Pukë dhe në Bashkinë Fushë Arrëz, gjenden rezerva të konsiderueshme të bakrit. Për këtë arsy e në zonë gjenden dy miniera: në Lakrosh e Munellë, si dhe uzina e pasurimit të bakrit. Minierat e bakrit ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë negativisht në rrjedhat ujore të zonës. Për këtë arsy, duhet të merren masa për rehabilitimin dhe minimizimin e ndotjes. Përveç kësaj, rajoni pasqyron shumëlojshmëri elementesh natyrore e peisazhiste, të cilat duhen ruajtur dhe promovuar. Zona ka mundësi të shumta për prodhimin dhe kultivimin e lajthisë, arrave dhe gështenjave. Për këtë arsy shikohet i nevojshëm përforcimi i një zinxhiri të integruar të prodhimit për kultivimin, mbledhjen dhe përpunimin e këtyre produkteve.

Bashkia Pukë gjendet midis poleve të zhvillimit Shkodër-Lezhë dhe Kukës-Hastropojë, me të cilat shikohet prioritet përmirësimi i lidhjes duke qenë se shërbejnë si porta hyrëse në anën veri-perëndimore e veri-lindore të rajonit malor verior të vendit. Është e rëndësishme afërsia e bashkisë me dy zona ndërkufitare të bashkëpunimit që përfshijnë edhe nyje mulimodale të transportit ndërkombëtar: Kukës-Prishtinë dhe Shkodër-Podgoricë. Në bashkia përshkohet edhe kalimi i aksit dytësor për tu përfocuar, sipas sistemit infrastrukturor të hartuar nga PPK. Pjesë e rëndësishme është edhe rruga shtetërore SH5 pranë të cilës gjendet qendra e bashkisë (e përcaktuar nga PPK si qendër tretësore urbane). Gjegjani është caktuar si qendër lokale e specializuar dhe shtrihet pranë boshtit me vlera natyrore e mjedisore dhe mundësi zhvillimi të korridoreve të çiklizmit, përmes të cilit lidhet me bashkinë Mirditë.

Forcimi i bashkëpunimit me bashkitë fqinje Mirditë, Fushë Arrëz dhe Vau i Dejës përbën një prioritet për PPK.



## Drejtimet për ekonominë dhe infrastrukturën përfshijnë:

- Vlerësimin e zonave me pasuri minerare dhe zhvillimin e industrisë së prodhimit e përpunimit të tyre.
- Zhvillimin e turizmit me fokus: zonat me prioritet turistik përreth Pukës dhe Kabashit si dhe krijimi i itinerareve vozitës përgjatë liqeneve artificialë Koman - Fierzë. Me interes për zhvillimin turistik përbëjnë edhe monumentet natyrore, zonat përreth lumenjve, të cilat këshillohen të funksionojnë si korridore të gjelbra - ekologjike dhe për iteneraret çiklistike.
- Përmirësimin e aksesit të qendrave lokale nga qendra e bashkisë me nyjet multimodale kombëtare.
- Ruajtjen e tokës bujqësore, zhvillimin e kulturave të specializuara dhe prodhimin e produkteve cilësore vendase.
- Trajtimi i burimeve të ndotjes së mjedisit dhe sidomos të ujërave.

Shënohet se, planet e miratuara kombëtare sektoriale **Plani i Integruar Ndërsektorial i Bregdetit** dhe **Plani i Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës** nuk ndikojnë zonën e studimit.

**Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit për Rajonin e Alpeve Shqiptare** synon zhvillimin e balancuar të turizmit në Alpet Shqiptare përmes mbrojtjes dhe përmirësimit të mjedisit natyror dhe kulturor dhe forcimit të aktivitetit ekonomik në rajon nëpërmjet zhvillimit të integruar të aktiviteteve të turizmit dhe shtimit të produktivitetit. Për më tepër, projekti synon përmirësimin dhe zgjerimin e strukturës së mikpritjes, akomodimit dhe shërbimit, përmirësimin e qasjes në rajonet me interes turistik, si edhe përmirësimin e standardeve të jetesës të banorëve vendas. Zona e Komanit trajtohet si vendbanim i kategorisë së dytë dhe është një port i hyrjes në Alpe nga brendësia e vendit. Komani plotëson kriteret për funksionimin si një shtyllë lokale atraktioni turistik, në mënyrë që të realizohet një shpërndarje e ekuilibruar e vizitorëve dhe paralelisht të lehtësojë blokimet e vizitorëve në vendbanimet e kategorisë së parë.

## PROJEKTET RAJONALE DHE LOKALE

Më poshtë listohen planet rajonale që prekin dhe ndikojnë zonën e studimit.

**Skenarët e Zhvillimit Nënrajonal në Qarkun Shkodër (2015)** synon zhvillimin e qëndrueshëm social dhe ekonomik dhe identifikon si fusha prioritare arsimin (krijimin e potencialit të fuqisë punëtore të kualifikuar), infrastrukturën dhe shërbimet, turizmin dhe industrinë bujqësore, koordinimin ndërmjet agjencive dhe organeve dhe mbrojtjen nga përblytjet.

Për bujqësinë dhe blegtorinë, propozohet rritja e produktivitetit përmes financimit, mbështetjes për informacion dhe edukim, përmirësimit të marketingut (p.sh. krijimit të brandeve), promovimit të bashkëpunimit dhe kombinimit me agroturizmin. Pë sa i përket turizmit, bashkia është një nën-seksion i veçantë me potencial për zhvillimin e ekoturizmit dhe turizmit kulturor.



**Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal (2010), rezultat i Bashkëpunimit Rajonal të Shkodrës dhe GTZ, fokusohet tek arsimi, shërbimet sociale, infrastrukturën, turizmin dhe agrobiznesin si edhe në bashkëpunim më të mirë mes e bashkive dhe Prefekturave.**

Bashkia e Pukës trajtohet si një zonë me perspektiva të larta për zhvillimin e turizmit familjar dhe industrinë e ekonomisë shtëpiake. Forcimi i turizmit do të arrihet nëpërmjet çertifikimit të produkteve, pjesëmarrjes dhe organizimit të festivalave, bashkëpunimit midis prodhuesve dhe rajoneve dhe rritjes së ndërgjegjësimit të komunitetit lokal.

## 1.2. Rezultatet për konsultim publik

Gjatë fazës A' të studimit dhe pak para përfundimit të saj, në Bashkinë e Pukës u zhvillua një konsultim publik, më 14 shtator 2017, për të paraqitur rezultatet e kësaj faze. Përveç konsultimit, u shpërndanë pyetësorë tek të pranishmit me qëllim për të shprehur pikëpamjet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me studimin, si edhe për problemet më të rëndësishme që mund ata të kenë identifikuar në bashki. Në total janë plotësuar 23 pyetësorë. Pyetësorët përbëheshin nga 11 pyetje të tipit të hapur, kryesisht të cilat kanë lidhje me mundësitë për zhvillim ekonomik dhe pikat e dobëta të Bashkisë. Nga pyetësorët rezultuan konkluzionet e mëposhtme, të cilat janë një pamje më të përgjithshme se si njerëzit e bashkisë, aktorët e ndryshëm dhe palët e tjera, shohin zonën e Bashkisë, por për shkak se numri i mostrave ishte i vogël, nuk mund të dalin konkluzione sasiore.

Nga pyetjen e parë, në lidhje me sektorët në të cilat bazohet rritja ekonomike, shumica e të anketuarve iu referuan bujqësisë, blegtorisë, turizmit, tregtisë dhe shërbimeve. Po aq e rëndësishme është edhe kontributi i përpunimit e i shfrytëzimit të pasurisë minerare dhe drurit. Për pyetjen se cilat sektorë mund të zhvillohen më së shumti, përgjigjet mbisin kryesisht të njëjta. Shumica e të anketuarve u përgjigjën bujqësia, duke theksuar burimet natyrore si bimët medicinale, blegtorinë, shërbimet dhe shfrytëzimin e pasurisë minerare. Përveç kësaj, industria, sporti dhe investimet mund të zhvillohen më tej. Së fundi, u përmend edhe turizmi, kryesisht për shkak të ajrit të freskët të zonës.

Në lidhje me pyetjen për problemet më të rëndësishme të bashkisë, shumica e njerëzve shohin si dobësi kryesore mungesen e burimeve njerëzore, kryesisht për shkak të migrimit të popullsisë, papunësinë dhe mungesen e investimeve, të cilat mund të stimulojnë ekonominë e Bashkisë. Përveç kësaj, problem i madh për Bashkisë Pukë cilësohet mungesa e kanalizimeve, furnizimit me ujë dhe infrastrukturës rrugore, si dhe problemi i edukimit të mangët të rinjve. Rrezik për zonën konsiderohet të jetë ndërtimi arbitrar dhe mungesa e studimeve dhe planeve zhvillimore të përshtatshme. Së fundmi, mungesa e tregjeve të përbashkëta dhe firmave të huaja pengon zhvillimin ekonomik të rajonit.



Në lidhje me veprimet e reja që do të zbatohen në 5-10 vitet e ardhshme, përgjigja më e zakonshme është ndërtimet. Më konkretisht, ndërtimi i hidrocentraleve të vogla, magazinave si edhe landfilleve për menaxhimin e mbeturinave të ngurta. Pritet të jetë i arsyeshëm forcimi i sektorëve kryesorë të ekonomisë, si bujqësia, blegtoria, minierat (rihapja e minierave të bakrit në Fushë Arréz dhe Munella) dhe turizmi. Ata besojnë se, në një masë të caktuar, do të ketë një adresim dhe trajtim të dobësive dhe sidomos infrastrukturës teknike. Qëllimi është krijimi i kushteve të favorshme ekonomike për 5-10 vitet e ardhshme dhe të zvogëlimi i papunësisë. Në vitet e ardhshme rajoni duhet gjithashtu të kryejë studime dhe plane për zhvillimin e zonave rurale në mënyrë që të reduktojë pabarazitë sociale dhe territoriale.

Këto projekte konsiderohen të nevojshme pasi ato do të ndikojnë pozitivisht në zhvillimin ekonomik të bashkisë. Kur u pyetën se si zhvillimi ekonomik i Bashkisë do të ndikohet nga projektet e ardhshme, përgjigjet lidhen kryesisht me rritjen ekonomike për shkak të rritjes së të ardhurave dhe bizneseve të reja që besohet se do të hapen. Pritet ulje e problemeve kryesore në lidhje me cilësinë e rrjeteve dhe shërbimeve dhe rrjedhimisht edhe ulje e papunësisë. Si konkluzion, pritet zhvillimi ekonomik për banorët e zonës dhe përmirësimi i cilësisë së jetës. Të gjitha projektet e mësipërme, përveç zhvillimit ekonomik, do të ndikojnë pozitivisht në mjedis, nëse kombinohen me disa projekte të tjera të tilla si studime për turizmin dhe bujqësinë, mbrojtjen e gjelbërimit dhe mbjelljen e bimëve të reja si dhe mbajtjen pastër të qytetit.

Sic mund edhe të shihet nga shumica e përgjigjeve të dhëna, theks të veçantë i kushtohet mjedisit, promovimit dhe mbrojtjes së tij. Kjo është arsyaja pse në pyetje se si ata mendojnë se PPV do të ndikojë në mjedis, shumica e të anketuarve besojnë se PPV do të zgjidhë problemet kryesore të bashkisë. Në veçanti, besohet se do të ketë përmirësim të infrastrukturës, rritje e cilësisë së ajrit, përmirësimi i rrjeteve të infrastrukturës (uji, kanalizimi e rrugët) dhe reduktim të papunësisë. Gjithashtu, pritet krijimi i një ekipi ekspertësh monitorimi, dhënia e sanksioneve për dëmtuesit e mjedisit, përcaktimi i zonave të mbrojtura, si dhe ritja e investimeve në secilin sektor. Duke qenë se turizmi përbën një degë të rëndësishme të ekonomisë vendase, pritet kryesisht rritja e turizmit të gjelbër dhe të bardhë.

Objektivat kryesore të të anketuarve në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, lidhen kryesisht me pyjet dhe çeshtjen e mbeturinave. Në veçanti, konsiderohen të nevojshme hapa në të ardhmen për shtimin e investimeve në pyje në lidhje me mbrojtjen e tyre, ndalimin e prerjeve, mbjelljen e pemëve dhe krijimi i zonave të mbrojtjes nga zjarri. Gjithashtu, priten reduktimi i mbeturinave organike, menaxими i mbeturinave, sensibilizimi i banorëve dhe bizneseve për mbajtjen pastër të ambjentit dhe ndërtimin e barrierave prej betoni për tu mbrojtur nga erozionit.

Në lidhje me problematikat e përbashkëta të bashkisë Pukë dhe bashkive fqinje, shikohet si problem kryesor: komunikimi dhe bashkëpunimi i jo i shpeshtë midis bashkive. Problematika të njëjtë ndajnë në lidhje me infrastrukturën e dobët, papunësinë, mungesën e investimeve dhe fondeve, si dhe lëvizjen e popullsisë.



Për sa i përket infrastrukturës teknike, shqetësimë të përbashkëta i referohen rrjeteve të ujut e kanalizimeve si dhe shtrimi i rrugëve lidhëse, në veçanti rrugëve malore të cilat mund të shtojnë fluksin e turistëve malorë. Gjithashtu shikohen si prioritare ndriçimin e rrugëve dhe plotësimi i infrastrukturës sociale (arsim dhe shëndetësi).

Së fundi, pyetjes për komente të fundit apo shënimë shtesë, shumica ju janë përgjigjur me nevojën e riparimit të rrjetit rrugor, përmirësimit të infrastrukturës, punësimit të të rinjve e grave, zvogëlimit të numrit të papunëve (për rrjedhim uljen e lëvizjes së njerëzve me qëllim gjetjen e vendeve të punës). Për më shumë, disa nga të anketuarit përmendën nevojën për mbrojtjen e pyjeve, mbjelljen e pemëve dhe ndërtimin e vendrave sociale e kulturore.

### 1.3. Analiza e metabolizmit dhe vlerësimi i përgjithshëm i territorit të njësisë

#### Të përgjithshme

Sipas VKM 671/2015, metabolizmi i një zone është modeli teorik që e trajton qytetin si një ekosistem, dmth, konsiderohet se qyteti ka një strukturë dhe funksion të ngjashëm me atë të ekosistemeve natyrore. Sipas këtij paralelizmi, qyteti i shndërron (metabolizon) lëndët e para (p. sh. ujë, karburanti) dhe prodhon emetime ndotjeje dhe mbetje. Për herë të parë si metabolizëm urban u përcaktua "totali i materialeve dhe të mirave materiale që nevojiten për mbajtjen e banorëve të një qytetit në shtëpi, në punë dhe në argëtim"<sup>1</sup>. Përkufizimi i mëvonshëm thotë se është "shuma totale e proceseve teknike dhe socio-ekonomike që realizohen në qytete dhe janë përgjegjës për zhvillimin, prodhimin e energjisë dhe hedhjen e mbetjeve" (Kennedy et al., 2007).<sup>2</sup> Bazohet në identifikimin dhe analizën e proceseve që ndodhin nëpërmjet inputeve dhe oututeve të energjisë dhe burimeve brenda kufijve të qytetit, përmes ndërveprimit të natyrës dhe shoqërisë, të qytetit dhe të fshatit. Objktivi është që të kuptohet sjellja e zonës së studimit dhe përshtatja e saj në një bazë më të qëndrueshme. Rezultatet që dalin janë veçanërisht të dobishme për formulimin e strategjive të qëndrueshme, planeve dhe politikave.

Për analizën e metabolizmit urban janë zhvilluar ndërkombëtarisht metoda dhe mjete të ndryshme (p.sh. metoda e monitorimit urban të integruar (IUME), metoda e gjurmës ekologjike, etj). Tipar i përbashkët i të gjitha metodave është që të dhënat sasiore janë me rëndësi jetike, dhe gjithashtu duhet të raportohen në shkallë të përshtatshme. Nga kërkimi i kryer në zonën e studimit, u konstatua se diçka e tillë nuk është e realizueshme. Të dhënat statistikore të gjetura janë të paplota dhe të paqarta dhe me vlefshmëri e përfaqësim të panjohur. Më shumë dhëna ka në nivel Qarku ose vendi. Megjithatë, u gjykuar që reduktimi i madhësive nga nivelet e larta në Bashkinë në studim do të conte në përfundime të gabuara, sepse to mbizotërojnë qendra urbane

Wolman A (1965), The metabolism of cities. *Scientific American*, vol. 213 (3), p.179-190.

Kennedy C., Cuddihy J. and Engel-Yan J. (2007), The changing metabolism of cities. *Journal of Industrial Ecology*, vol. 11 (2), p.43-59.

shumë më të mëdha, të cilat kanë metabolizëm shumë të ndryshëm (më linear), me konsum më të madh dhe më pak prodhim burimesh dhe materialesh, ndërsa pesha e popullsisë në totalin e Qarkut është shumë e vogël. Përveç kësaj, dimensionet që përcaktojnë intensitetin e metabolizmit janë të shumta (p.sh. struktura e qytetit, sistemi i transportit, faktorët ekonomikë, qeverisja, mënyra e jetesës, klima) dhe bashkëveprojnë, duke krijuar një rrjet kompleks marrëdhëniesh dhe ndikimesh në sistemin urban. Prandaj, do të nevojitej një studim i veçantë për përshkrimin dhe analizën e Bashkisë Pukë si ekosistem, duke përdorur mjete dhe tregues sasiorë e cilësorë.

Ndërkohë, përafrohet niveli dhe tendenca e metabolizmit të zonës së studimit brenda rrjedhës së energjisë, ujit, materialeve dhe mbeturinave. Analiza e këtyre komponenteve bazuar në informacionin sasior dhe cilësor të dhënë, bëhet me ndihmën e treguesve, të cilët përfaqësojnë katalizatorët metabolikë dhe cilësinë e jetës. Në këtë stad, duke përcaktuar bazën për përgatitjen e strategjisë, qëllimi është sqarimi i bashkëveprimit midis tendencave të zhvillimit dhe të dhënave në lidhje me sistemin urban të Mirditës. Me zbatimin e kësaj metode, identifikohen problemet e bashkisë në lidhje me cilësinë e jetës (atmosferën, zhurmat) dhe flukset e burimeve natyrore, energjisë dhe materialeve. Në këtë mënyrë, klasifikohen disa sektorë të cilët priten të përmirësohen në kuadër të hartimit të strategjisë territoriale. Në veçanti, konsiderohet i nevojshëm propozimi i udhëzimeve strategjike për rivitalizimin e metabolizmit urban të bashkisë Pukë, me qëllim arritjen e qëndrueshmërisë urbane.

## Energjia

Një nga të mirat materiale më të rëndësishme që konsumohet nga njerëzit nëpërmjet komuniteteve të organizuara, është energjia. Energjia nuk humbet, por konvertohet nga një formë energjie në një formë tjeter. Për këtë arsy, në vijim i referohemi përdorimit të energjisë dhe burimeve natyrore të rinovueshme (ose jo) që konsumohen për konvertimin e energjisë nga një formë në një tjeter. Format e ndryshme të energjisë, si ajo elektrike, termike, e ndriçimit, mekanike (potenciale dhe kinetike), kimike e bërthamore, përdoren nga sektorë të ndryshëm brenda dhe jashtë kufijve të një bashkie. Fushat kryesore të aplikimit janë sektori i banimit, transportit, industrisë, shërbimeve dhe bujqësisë.

Sektori i banimit dhe sektori i shërbimeve, përveç përqindjes të madhe të energjisë elektrike, konsumon edhe një pjesë të konsiderueshme druri dhe produkte të naftës përgrohje. Megjithatë, sektori më intensiv në Shqipëri, është sektori i transportit. Në vitin 2008 ky sektor përrthithi 44% të përdorimit të përgjithshëm të energjisë. Nga viti 2000 e më pas ka një rritje të provuar të transportit, veçanërisht në lidhjet rrugore, që u shoqërua me një rritje në konsumit të karburantit.



Shpërndarja gjeografike e konsumimit të energjisë (Figura 1.3.1) tregon se 70% e totalit të energjisë përdoret në ultësirën bregdetare të Shqipërisë ku është përqëndruar pjesa më të madhe e popullsisë dhe e aktiviteteve të vendit.




Figura 1.3.1: Shpërndarja e konsumit të energjisë për çdo prefekturë të Shqipërisë<sup>3</sup>

Energjia elektrike mund të prodhohet nga centralet me avull, hidro, bërthamore dhe nga parqet eolike e ato diellore. Një bashki mund të prodhojë energji elektrike që futet në rrjetin elektrik të vendit dhe shpërndahet në përputhje me rrethanat sipas zonës. Energjia elektrike përdoret në funksionimin e pajisjeve elektrike shtëpiake, të ndriçimit, në sistemet e ngrohjes të ambjentit dhe të ujit etj.

Në Shqipëri është e rëndësishme sasia e energjisë elektrike që prodhohet nga hidrocentralet. Burimet energjetike brenda Bashkisë Pukë nuk janë të shumta. Megjithatë, në kufijtë e Bashkisë Pukë, janë vendosur dy hidrocentralet më të mëdha në vend (shih foto 1.3.1 dhe 1.3.2). Fillimisht, lumi Drin, pjesë e të cilit shtrihet brenda kufijve të Bashkisë Pukë, përbën një bërthamë të rëndësishme shfrytëzimi për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet. Konkretisht në veriperëndim të Bashkisë Pukë gjendet hidrocentrali i madh i "Fierzës", i cili është dhe i dyti më i madh në vend pas hidrocentralit të Komanit. Katër njësitë e instaluara në këtë hidrocentral kanë turbina vertikale "Francis" me kapacitet 125 MW secila. Përveç kësaj, fabrika ka gjeneratorë të tensionit 13.8 kV dhe transformatorë 13.8 kV / 242 kV për lidhje me nënstacionin e transmisionit. Ky hidrocentral prodhon në total 1600 Gwh dhe 5760 TJ. Hidrocentrali i dyte, i "Komanit", është më i madhi në vend. Atje ndodhet një nga tre digat që janë vendosur në Drin, me një lartësi prej 130 m. Hidrocentrali përbëhet nga katër turbina "Francis" me kapacitet 150 MW secila, me kapacitet total të instaluar prej 600 MW. Gjithashtu, brenda Bashkisë gjendet edhe një hidrocentral më i vogël, "HEC Dardha", me një kapacitet prej 5800 KW.



<sup>3</sup> Burimi: Raport Vjetor, Gjendja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Viti 2010



Foto 1.3.1: Hidrocentrali i Fierzës



Foto 1.3.2: Hidrocentrali i Komanit

Në bashkinë Pukë nuk janë gjetur burimet të shfrytëzimit të energjisë së rinoqveshme (diellore, eolike). Megjithatë, potenciali për shfrytëzimin e energjisë së erës është i lartë. Siç shihet në figurën 1.3.2b, Shqipëria ndahet në 7 zona të erës gjenerike dhe zona e Bashkisë Pukë ka një intensitet mesatar të lartë të erës pasi renditet në kategorinë e 2-të më të lartë: shpejtësia mesatare vjetore e erës 3.6-4.0. Për kundrazi, sipas zonimit të potencialit të energjisë diellore të vendit, rrezatimi diellor është më i kufizuar në zonën të cilën përket edhe Bashkia e Pukës, sepse siç duket në figurën 1.3.2a gjendet në zonë ku mbizotëron rrezatimi diellor mesatar vjetor prej 3.70-3.83 kWh/m<sup>2</sup>.

Në konkluzion, energjia elektrike e përdorur për nevojat e Bashkisë dhe banorëve të saj rrjedh nga zona të tjera. Për të përbushur nevojat aktualisht të larta dhe gjithnjë në rritje, është ndërtuar kohët e fundit një nënstacion i ri i energjisë elektrike, duke përmirësuar dhe zgjeruar sistemin e gjërë të transmetimit të energjisë elektrike.






Figura 1.3.2a: Rrezatimi diellor mesatar vjetor<sup>4</sup>



Figura 1.3.2b: Shpejtësia mesatare vjetore e erës<sup>5</sup>

Sipas të dhënave të Bankës Botërore, përdorimi i energjisë elektrike për banor në Shqipëri ka paraqitur rritje nga 1990 në 2012 (Figura 1.3.3). Në veçanti, për vitin 2012, përdorimi për banor ishte rreth 2118,26 kWh. Përkatësisht për vitin 2011 përdorimi për banor ishte rreth 2,205.7 kWh. Sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të vitit 2011, Bashkia e Pukës ka një popullsi prej 11.069 banorësh. Bazuar në popullatën, duket se, në total, Bashkia ka përdorur në vitin 2011 ( $11,069 * 2,205.7$ ) 24,414,893.3 kWh energji elektrike. Për këtë studim u llogarit edhe konsumi i energjisë elektrike për vitin 2010, ku për çdo banor ishte 1943,34 kWh. Gjithashtu, Banka Botërore kohët e fundit ka bërë publike edhe konsumin e energjisë elektrike për banor për vitin 2014 dhe në rastin e Shqipërisë ishte rreth 2,309.37 kWh.

<sup>4</sup> Burimi: Sustainable energy for Albania - <http://aea-al.org/>

<sup>5</sup> Burimi: Sustainable energy for Albania - <http://aea-al.org/>




Figura 1.3.3: Evolucioni i konsumit të energjisë elektrike për frymë në Shqipëri. Shënohet vlera për vitin 2011 (burimi: <https://www.google.gr/publicdata>)

	Popullsia 2011	Konsumi i energjisë elektrike (kWh)
Pukë	3,607	7,955,959.9
Gjegjan	2,846	6,277,422.2
Rrapë	1,357	2,993,134.9
Qelëz	1,761	3,884,237.7
Qerret	1,498	3,304,138.6

Tabela 1.3.1: Konsumi i energjisë elektrike në Bashkinë Pukë në bazë të konsumit për banor nga të dhënat e Banka Botërore.



Konsumi i energjisë elektrike nuk është veçanërisht i lartë, pasi popullsia e rajonit nuk është e madhe dhe nuk ka karakter urban, përvèç qytetit të Pukës.

Energjia termike përdoret kryesisht për ngrohjen e banesave, të ujit, përgatitjen e ushqimit etj. Parametri bazë i përdorimit për ngrohjen e ndërtuesës është gjendja termike mesatare deri e keqe e ndërtueseve ekzistuese. Veçanërisht për ngrohjen e ujit, është gjithashtu i kufizuar përdorimi i energjisë diellore me ngrohës diellorë shtëpiakë. Për më tepër nuk shfrytëzohen në nivel Bashkie format e tjera të burimeve të rinovueshme, si biomasa ose energjia gjeotermale, nuk janë duke u shfrytëzuar në



nivelin e Bashkisë. Në veçanti për energjinë gjeotermale nuk ka fushë të shfrytëzueshme të regjistruar në zonën e studimit.

Burimi kryesor që konsumohet për ngrohje është druri, me çdo ndikim në mjedis dhe ndikimi në shëndetin e qytetarëve nga shkarkimi i grîmcave dhe blozës. Furnizimi me dru bëhet nga pikat e ligjshme të shitjeve, por edhe direkt nga sipërfaqet pyjore, prandaj përllogaritja e sasisë nuk mund të jetë e saktë. Gjithashtu, nuk ka të dhëna për përqindjet e drurit të konsumuar për sa i përket prejardhjes së tij (brenda ose jashtë Bashkisë).

Në Shqipëri dhe si rrjedhojë në zonën e studimit, nuk është e mundur të zhvillohet sistemi i gazit natyror në hapësirë afatshkurtër, pasi që ka prodhim të papërfillshëm të gazit natyror endogen dhe njëkohësisht nuk ka lidhje me rrjetin evropian të gazit natyrore. Përveç kësaj, në sipërfaqen e Bashkisë nuk ka njësi të nxjerrjes së hidrokarbureve për prodhimin e lëndëve djegëse.

Për i përket konsumit primar të energjisë, dmth para se të shndërrohet në lëndë djegëse për përdorim përfundimtar, i cili është i barabartë me prodhimin vendas plus importet dhe ndryshimet e rezervës, minus eksportet dhe karburantet që furnizojnë anijet dhe aeroplanët, të dhënat rezultuan në bazë të konsumit për kg të ekuivalentit të naftës (O.E.) për banor nga Banka Botërore për vitin 2011.

Sipas Bankës Botërore konsumi për banor ishte në 2010 729.154 kg O.E., në 2011 764.969 kg O.E., në 687.896 kg O.E. në 2012, në 801.33 kg O.E. në 2013 dhe në 808.456 kg O.E. në 2014.




Figura 1.3.4: Konsumi i energjisë parësore në kg të karburantit ekuivalent për çdo person për vitin 2011<sup>6</sup>

<sup>6</sup> Burimi:<http://data.worldbank.org/indicator/EG.USE.PCAP.KG.OE/countries/AL?display=graph>

Njësi administrative	Popullsia 2011	Konsumi i energjisë në kg OE
Pukë	3,607	2,759,243.183
Gjegjan	2,846	2,177,101.774
Rrapë	1,357	1,038,062.933
Qelëz	1,761	1,347,110.409
Qerret	1,498	1,145,923.562

Tabela 1.3.2: Konsumi i energjisë primare në Bashkinë Pukë në bazë të konsumit për banor nga Banka Botërore.




Figura 1.3.5: Parashikimi për nevoja energjie për sektor (2004)<sup>7</sup>

Bazuar në sa më sipër, shumica dërrmuese e energjisë së konsumuar vjen nga zonat jashtë bashkisë, dhe kjo krijon probleme të varësisë nga stoku i energjisë. Prodhimi i decentralizuar i energjisë përbën tendencën e ardhshme me synim zgjidhjen e varësisë nga rezervat e energjisë së rajoneve të tjera. Këtu, ndërkohë, duhet theksuar se një pjesë e madhe e energjisë së prodhuar në Shqipëri vjen nga burime të ripërtëritshme të energjisë (hidrocentrale), fakt i cili kontribuon në efikasitetin e energjisë së metabolizmit. Përdorimi i energjisë së rinovueshme zvogëlon shanset për krijimin dhe shtrirjen e ndikimeve të rëndësishme mjedisore. Theks i veçantë duhet të vendoset në kufizimin e djegies së drurit për ngrohje pasi rëndon në masë të madhe cilësinë e mjedisit për shkak të emetimeve të tymrave në ajër.

Megjithatë, një problem me të cilin ballafaqohet Bashkia e Pukës ka të bëjë me hapësirën e kufizuar të shfrytëzimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë brenda kufijve të saj administrativ. Në veçanti, stacionet më të mëdha të hidrocentraleve janë të vendosura jashtë kufijve të bashkisë. Përdorimi më i madh i këtyre, kryesisht në nivel ndërtuesash, i kombinuar me zhvendosjen drejt shfrytëzimit të rrezatimit diellor

<sup>7</sup> Burimi: Sustainable energy for Albania - <http://aea-al.org/>



me objekte brenda në qytet, do të mund të përmirësonin balancën e rrjedhës së energjisë.

Më në përgjithësi, sektori i energjisë në zonën e studimit ka nevojë për modernizim dhe aplikim të teknologjive të reja, në mënyrë që të përdoren si mjete për të reduktuar konsumin dhe barrën e energjisë. Në thelb, flukset e energjisë në sistemin urban të bashkisë përfshijnë faktorë të ndryshëm dhe kompleks, ndërsa janë të lidhura me ndikime të rëndësishme mjedisore, të cilat mund të tejkalojnë kufijtë e bashkisë. Kjo e bën menaxhimin e çështjes së energjisë një sfidë. Riorganizimi urban, përdorimi i teknologjive të reja, sensibilizimi i banorëve dhe profesionistëve mund të kontribuojnë në kursimin e energjisë.

### Uji

Shqyrtimi i burimeve ujore, si komponent i flukseve në sistemin metabolik të qytetit të Pukës do të bëhet në drejtim të sistemit të menaxhimit, kërkesës për konsum në lidhje me ofrimin dhe gjenerimin e mbetjeve. Komponenti i burimeve ujore trajtohet si një rrjedhë e vetme që ndjek rrjedhën dhe daljen e sistemit.

Uji i pastër është më i çmuari i të gjithë të aseteve materiale. Gjithashtu qasja ndaj sasive të mjaftueshme të ujit të pastër përbën një tregues kyç për zhvillimin e një zone dhe jetës sociale të saj. Mjaftueshmëria varet kryesisht nga prania e burimeve ujore, ujërave nëntokësore (akuifereve) dhe ujërat sipërfaqësore (liqene, lumenj, etj), ndërsa cilësia/pastërtia e ujit varet nga shkalla e ndotjes së tokës dhe sipërfaqes së ujit. Uji është i nevojshëm në sektorët shtëpiak, bujqësor dhe industrial, si dhe në shërbime e turizëm.

Bashkia e Pukës shtrihet në dy basene. Pjesa më e madhe e tyre shtrihet në basenin Drin-Bunë (i cili përbën një basen të madh, të shtrirë edhe në shtetet fqinje) dhe në basenin e Matit, në një pjesë shumë të vogël. Lumi Drin është një nga më të mëdhenjtë në Ballkan dhe përbën boshtin e rrjetit hidrografik të basenit të Drin-Bunë.

Si rezultat në Bashkinë Pukë, vërehet një kapacitet ujor i rëndësishëm si nga prania e degëve të Drinit, ashtu dhe për shkak të burimeve të shumta, por edhe të Ligenit të Komanit.

Si lumenjtë (me disa digave që janë ndërtuar), ashtu edhe burimet janë mënyra kryesore për furnizim me ujë dhe ujitje të Bashkisë së Pukës. Në këtë zonë, janë ndërtuar në të shkuarën kanale të rëndësishme ujitjeje (prej betoni), që llogariten se shtrihen në rreth 120 km. Nga këto më të rëndësishmet janë: një kanal i cili fillon nga ligeni i Pukës, me drejtim nga fshatrat në perëndim të ligenit dhe kanali në Nj.A. Gjegjan.

Rrjeti i ujësjellësit mbulon vetëm një pjesë të Bashkisë, duke i shërbyer vetëm zonave urbane. Në qytetin e Pukës rrjetit të vjetër i është shtuar dhe një i ri. Gjithashtu ka një rrjet ujësjellësi në Njësinë Administrative Gjegjan, Kçirë dhe Qelëz. Nj.A Kçirë furnizohet vetëm me autobot, ndërsa në fshatrat e tjera furnizimi me ujë i banorëve bëhet privatisht nga burimet, ndonjëherë edhe me tubacione plastike të improvizuara



që lidhin burimin me shtëpitë e tyre. Sipas të dhënave në Tabelat 10.3.2, 10.3.3 dhe 10.3.4, rrjeti që mbulon zonat urbane është 20.3 km, ndërsa rrjeti në hapësirën (Puka f) është 77.3 km. Ky rrjet nuk është zgjera, të paktën gjatë dhjetëvjeçarit të fundit.

Në rrjetin ekzistues të Bashkisë, rrjedhja e ujit nuk është e vazhdueshme. Për shembull në vitin 2015, ndërsa në hapësirën urbane të Bashkisë Pukë, rrjedhja e ujit është mjaft e kënaqshme (rrjedhje e vazhdueshme për 21 orë/ditë), ndryshe nga zonat rurale ku rrjedhja ishte e vazhdueshme vetëm për rreth 14 orë në ditë.

Në përgjithësi, mungojnë të dhënat e detajuara mbi kërkesën dhe konsumin e ujit për të gjitha kategoritë e ndryshme të përdoruesve, si në aspektin e rrjeteve të organizuara ashtu edhe të shpimeve private. Sipas të dhënave të disponueshme të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës kanalizimeve ([www.dpuk.gov.al](http://www.dpuk.gov.al)) në vitin 2015, nga 5,724 banorë të zonave urbane (Bashkia Pukë), vetëm 2747 ishin të lidhur me rrjetin e furnizimit me ujë (1,105 lidhje), ndërkohë që përkatësisht në zonat rurale (Puka f), nga rreth 12,000 banorë, vetëm 2.350 ishin të lidhur me rrjetin (523 lidhje). Përkatësisht, konsumi i përgjithshëm ditor në zonat urbane është 142 litra/frymë/ditë, nga të cilat 111 konsumohen për përdorim shtëpiak, ndërkohë që konsumi ditor i përgjithshëm në zonat e tjera rurale është 146 litra/frymë/ditë, nga të cilat 138 konsumohen për përdorim shtëpiak.

Për sa i përket daljeve nga sistemi i ujësjellësit (të cilat vlerësohet të jenë të njëjta si hyrjet), nuk ka ndonjë parashikim për përpunimin e tyre dhe zakonisht derdhen në mënyrë të pakontrolluar, si pjesë e rrjetit të kanalizimit në lumenj, liqene etj. Në zonë aktualisht nuk ka ndonjë stacion për matjen e treguesve të cilësisë së ujit. Megjithatë, sipas Planit të Menaxhimit për Basenin Ujor të Lumin Drin-Bunë, Draft raporti përfundimtar - Qershori (2017), propozohet të ndërtohet një stacion vrojtimi në Liqenin e Pukës.

Në tabelën 1.3.3 paraqitet shkurtimi i marrëdhënia ndërmjet aksit ndaj ujit dhe nivelit të shqetësimit për shëndetin.

Niveli shërbimit	Mënyra e qasjes	Nevojat e plotësuara	Niveli i shqetësimit shëndetësor
Nuk ka qasje (sasia e grumbulluar shpesh nën 5 l/c/d)	Më shumë se 1000m ose 30 minuta totali i kohes se grumbullimit	Konsumi- nuk mund të sigurohet; Higjena- jo e mundshme (në qoftë se nuk praktikohet)	Shumë i lartë
Qasje bazë (Sasia mesatare ka gjasa të tejkalojë 20 l/c/d)	Midis 100 dhe 1000m ose 5 deri 30 minuta totali i kohes së grumbullimit	Konsumi- duhet të sigurohet -higjena, larja e duarve dhe higjena bazë e ushqimit e mundhsme Larja e rrobave/banja personale e vështirë për tu siguruar nëqoftëse nuk kryhet në burim.	i lartë
Qasje e ndërmjetme (Sasia mesatare rreth 50 l/c/d)	Ujë i furnizuar nëpërmjet një cezme në parcelë (ose brenda 100m)	Konsumi- i siguruar, Higjena – e gjithë higjena personale dhe e ushqimit e siguruar.	i ulët



	ose 5 minuta totali i kohës së grumbullimit)	Larja e rrobave/ banja personale duhet gjithashtu të sigurohet,	
Qasje optimale (Sasia mesatare 100 l / c / d dhe më lart)	Ujë i furnizuar nëpërmejt shumë cezmare pa ndërprerje	Konsumi-të gjithë nevojat të plotësuara Higjena- të gjitha nevojat duhet të plotësohen	Shumë i ulët

Tabela 1.3.3: Përbledhja e kërkesës për nivelin e shërbimit të ujit për te promovuar shëndetin<sup>8</sup>

---

<sup>8</sup> Burimi: Howard G. & Bartram J., "sasia e ujit për perdonim familjar, Sherbimi,Niveli dhe Shëndeti", WHO/SDE/WSH/03.02, ©Organizata Botërore e Shëndetësisë 2003,  
[http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/67884/1/WHO\\_SDE\\_WSH\\_03.02.pdf](http://apps.who.int/iris/bitstream/10665/67884/1/WHO_SDE_WSH_03.02.pdf)

## Treguesit 2006-2014

Treguesit		Indicators		Njesia e majes		2006		2007		2008		2009		2010		2011		2012		2013		2014			
1.1 Mbuhimi me Ujësjellës	1.1 Water Coverage	%		39,81		46,98		49,48		49,62		49,62		49,62		52,89		53,10		53,10		54,30		54,30	
1.2 Mbuhimi me Ujësjellës - Urbane	1.2 Water Coverage-Urban	%		39,81		46,98		49,48		49,62		49,62		49,62		52,89		53,10		53,10		54,30		54,30	
1.3 Mbuhimi me Ujësjellës – Rurale	1.3 Water Coverage-Rural	%																							
2.1 Mbuhimi me Kanalizime	2.1 Sewerage Coverage	%		-1,00		-1,00		-1,00		-1,00		-1,00		-1,00		-1,00		-1,00		-1,00		-1,00		-1,00	
3.1 Prodhimi i Ujit (l.f.d.)	3.1 Water Production (lcd)	l/c/d		869,94		691,23		646,93		452,94		242,94		254,24		461,59		336,65		336,65		350,63		350,63	
3.2 Prodhimi i Ujt (m3/lidhje/muaj)	3.2 Water Production (m3 conn. m)	m3/conn/m		66,07		52,68		52,84		36,97		19,81		20,48		37,06		26,86		27,89		27,89		27,89	
5.1 Shijet e Ujt (l.f.d.)	5.1 Water Sale (lcd)	lcd		187,24		207,07		193,27		182,17		164,97		151,31		144,88		140,57		142,02		142,02		142,02	
5.2 Shijet e Ujt (m3/lidhje muaj)	5.2 Water Sale (m3. conn. month)	m3/conn/m		14,22		15,78		15,79		14,87		13,45		12,19		11,63		11,21		11,30		11,30		11,30	
5.3 Shijet e Ujt - Familjare (l.f.d.)	5.3 Household Water Sale (l.c.d.)	l/c/d		142,74		151,31		136,29		131,02		125,03		123,18		116,46		111,78		111,01		111,01		111,01	
7.1 Përqindja e lidhjeve me ujëmës	7.1 Proportion of metered connections	%		13,75		17,81		21,36		24,24		25,86		37,68		49,35		49,17		45,43		45,43		45,43	
21.1 Vazhdimesia e Shërbimit (orë/ditë)	21.1 Continuity of Service Hours day	Orë/ditë		8,76		8,21		8,88		8,25		8,54		8,75		8,92		15,58		21,00		21,00		21,00	

## Treguesit 2006-2014

Treguesit		Indicators		Njesia e majes		2006		2007		2008		2009		2010		2011		2012		2013		2014			
1.1 Mbuhimi me Ujësjellës	1.1 Water Coverage	%		0,00		0,00		19,58		19,58		19,58		19,58		19,58		19,58		19,58		19,58		19,58	
1.2 Mbuhimi me Ujësjellës - Urbane	1.2 Water Coverage-Urban	%																							
1.3 Mbuhimi me Ujësjellës – Rurale	1.3 Water Coverage-Rural	%		0,00		0,00		19,58		19,58		19,58		19,58		19,58		19,58		19,58		19,58		19,58	
2.1 Mbuhimi me Kanalizime	2.1 Sewerage Coverage	%		0,00		0,00		2,08		2,08		2,08		2,08		2,08		2,08		2,08		2,08		2,08	
3.1 Prodhimi i Ujt (l.f.d.)	3.1 Water Production (lcd)	l/c/d		0,00		0,00		210,85		484,35		484,35		484,35		484,35		484,35		484,35		484,35		484,35	
3.2 Prodhimi i Ujt (m3/lidhje/muaj)	3.2 Water Production (m3 conn. m)	m3/conn/m		0,00		0,00		203,49		66,79		66,79		66,79		66,79		66,79		66,79		66,79		66,79	
5.1 Shijet e Ujt (l.f.d.)	5.1 Water Sale (lcd)	lcd		0,00		0,00		241,43		147,76		146,55		146,51		146,61		146,96		146,86		146,86		146,86	
5.2 Shijet e Ujt (m3/lidhje muaj)	5.2 Water Sale (m3. conn. month)	m3/conn/m		0,00		0,00		23,33		20,38		20,21		20,21		20,22		20,30		20,28		20,28		20,28	
5.3 Shijet e Ujt - Familjare (l.f.d.)	5.3 Household Water Sale (l.c.d.)	l/c/d		0,00		0,00		231,42		139,54		138,38		138,38		138,38		138,38		138,38		138,38		138,38	
7.1 Përqindja e lidhjeve me ujëmës	7.1 Proportion of metered connections	%		0,00		0,00		1,16		1,72		1,72		1,72		1,72		1,58		1,58		1,58		1,58	
21.1 Vazhdimesia e Shërbimit (orë/ditë)	21.1 Continuity of Service Hours day	Orë/ditë		0,00		0,00		16,08		15,05		14,91		15,23		15,34		14,92		14,92		14,92		14,92	

Tabela 1.3.4; Treguesit e ujët të ujësjellësit (periudha kohore 2006-2014) (burimi: <http://www.dpuk.gov.al/rub.php?id=345&lang=1>,  
[http://www.dpuk.gov.al/ndermarje\\_info.php?idn=1](http://www.dpuk.gov.al/ndermarje_info.php?idn=1), [http://www.dpuk.gov.al/ndermarje\\_info.php?idn=65](http://www.dpuk.gov.al/ndermarje_info.php?idn=65))



**Të dhënët e agreguara për periudhën 2008-2015**



Data	të dhënët	Bashkia Pukë (UK)						
		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
population living within the jurisdictional area- urban area	popullsia që jeton në zonën e juridikacionit- në qytet	5818,8	5800,0	5800,0		5.455,92	5.359	5.274
population living within the jurisdictional area- rural area	popullsia që jeton në zonën e juridikacionit- në fshat	0,0	0,0	0,0		0,00	0	0
total population living within the jurisdictional area- total	popullsia që jeton në zonën e juridikacionit- total	5818,8	5800,0	5800,0		5.455,92	5.359	5.274
estimated population served by the utility with water supply services- in urban area	popullsia që faktikisht furnizohet me ujë nga shqoeri/a/nj.admnn - në qytet	2865,3	2871,3	2878,0		2.898,00	2.898	2.737
estimated population served by the utility with water supply services- in rural area	popullsia që faktikisht furnizohet me ujë nga shqoeri/a/nj.admnn - në fshat	0,0	0,0	0,0		0,00	0	0
total estimated population served by the utility with water supply services- total	popullsia totale që faktikisht furnizohet me ujë nga shqoeri/a/nj.admnn - total	2865,3	2871,3	2878,0		2.898,00	2.898	2.737
population served by household connections	popullsia që shërbehet me lidhje në banesë	2865,3	2871,3	2878,0		2.898,00	2.898	2.737
population served by standpipe systems	popullsia që shërbehet me çezana publike	0,0	0,0	0,0		0,00	0	0
volume of water produced from gravity-based systems (000 m <sup>3</sup> )	vëllimi i ujit të prodhuar nga sistemi me rjetje të lire (000 m <sup>3</sup> )	639,0	476,0	258,0		360,00	375,0	347,0
volume of water produced from pumped-based systems (000 m <sup>3</sup> )	vëllimi i ujit të prodhuar nga sistemi me ngjyre mekanike (000 m <sup>3</sup> )	45,0	0,0	0,0		0,00	0,0	0,0
volume of water produced from all systems (000 m <sup>3</sup> )	vëllimi total i ujit të prodhuar nga dy llojet e sistemeve (000 m <sup>3</sup> )	684,0	476,0	258,0		360,00	375,0	347,0
volume of water bought from another enterprise (000 m <sup>3</sup> )	vëllimi i ujit të blerë nga shqoeri apo njësi administrative të tjera (000 m <sup>3</sup> )	0,0	0,0	0,0		0,00	0,0	0,0
volume of water sold (wholesale) to another enterprise (000 m <sup>3</sup> )	vëllimi i ujit të shitur me shumicë (000 m <sup>3</sup> )	0,0	0,0	0,0		0,00	0,0	0,0
net volume of system input (000 m <sup>3</sup> )	vëllimi net i ujit në sistemin e shpërndarjes së zonës së shërbimit (000 m <sup>3</sup> )	684,0	476,0	258,0		360,00	375,0	347,0
total length of water pipework (km)	gjalësia totale e trajtë të ujit (km)	23,7	20,3	20,3		20,30	20,3	20,3
total water connections – total	nr. total i lidhjeve i ujit (me, dhe pa matës) - total	1078,7	1073,1	1085,6	1098,8	1.117,00	1.121	1.105
total water connections - urban area	nr. total i lidhjeve të ujt – qytet	1078,7	1073,1	1085,6	1098,8	1.117,00	1.121	1.105
total water connections - rural area	nr. total i lidhjeve të ujt- fshat	0,0	0,0	0,0		0,00	0	0
continuity of service - average no. of hours	vazhdimësia e shërbimit - nr. mesatar i orëve të furnizimit	8,9	8,3	8,5	8,8	15,58	21,0	20,0
chlorine residual no. of samples	nr. testimeve për klorin rrëtës	281,0	338,0	727,0	1412,0	1.080,00	1.080,0	1.080
chlorine residual no. of negative samples	nr. kampionave negative për klorin rrëtës	281,0	336,0	714,0	1360,0	1.080,00	1.080,0	1.080
quantity of chlorine consumed each month (kg)	sasia e klorit që konsumohet në secilin muaj (kg)	53,6	79,7	88,8	109,2	60,00	60,0	60,0
e. coli no. of samples	nr. testimeve për koliform	281,0	336,0	674,0	1290,0	1.080,00	1.080,0	1.080
e. coli no. of negative samples	nr. kampionave negative për koliform	281,0	336,0	564,0	1100,0	1.080,00	1.080,0	990

**Tabela 1.3.5: Treguesit e ujit të ujësjellësit (periudha kohore 2008-2015) (burimi: <http://www.dpuk.gov.al/rrib.php?idr=345&lang=1>, [http://www.dpuk.gov.al/ndermarrje\\_info.php?idn=1](http://www.dpuk.gov.al/ndermarrje_info.php?idn=1))**

**Të dhënët e agreguaras për periudhën 2008-2015**

Data	të dhënët								Puka (Q)
		2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	
population living within the jurisdictional area - urban area	popullisë që jeton në zonën e juridikzonit - në qytet	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0
population living within the jurisdictional area - rural area	popullisë që jeton në zonën e juridikzonit - në fshat	12,000,0	12,000,0	12,000,0	12,000,0	12,000,0	12,000,0	12,000,0	12,000
total population living within the jurisdictional area- total	popullisë që jeton në zonën e juridikzonit- total	12,000,0	12,000,0	12,000,0	12,000,0	12,000,0	12,000,0	12,000	12,000
estimated population served by the utility with water supply services- in urban area	popullisë që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëria/nj.admnn.- në qytet	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0
estimated population served by the utility with water supply services- in rural area	popullisë që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëria/nj.admnn.- në fshat	2,432,3	2,350,0	2,350,0	2,350,0	2,350,0	2,350,0	2,350,0	2,350
total estimated population served by the utility with water supply services, total	popullisë totale që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëria/nj.admnn.- total	2,432,3	2,350,0	2,350,0	2,350,0	2,350,0	2,350,0	2,350,0	2,350
population served by household connections	popullisë që shërbehet me lidhje në banesë	2,000,0	2,000,0	2,000,0	2,000,0	2,000,0	2,000,0	2,000,0	2,000
population served by standpipe systems	popullisë që shërbehet me çezma publike	432,3	350,0	350,0	350,0	350,0	350,0	350,0	350
volume of water produced from gravity-based systems (000 m3)	vëllimi i ujit të produhuar nga sistemet me rrethje të lirë (000 m3)	1,746,0	384,0	384,0	384,0	384,0	384,0	384,0	384,0
volume of water produced from pumped-based systems (000 m3)	vëllimi i ujit të produhuar nga sistemet me ngjyre mekanike (000 m3)	144,0	36,0	36,0	36,0	36,0	36,0	36,0	36,0
volume of water produced from all systems (000 m3)	vëllimi total i ujit të produhuar nga dy llojet e sistemeve (000 m3)	1,890,0	420,0	420,0	420,0	420,0	420,0	420,0	420,0
volume of water bought from another enterprise (000 m3)	vëllimi i ujit të blejë nga shoqëri apo njësi administrative të tjera (000 m3)	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
volume of water sold (wholesale) to another enterprise (000 m3)	vëllimi i ujit të shitur me shumicë (000 m3)	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
net volume of system input (000 m3)	vëllimi neto i ujit në sistemin e shërbimit së zonës së shërbimit (000 m3)	1,890,0	420,0	420,0	420,0	420,0	420,0	420,0	420,0
total length of water pipework (km)	gjatësia totale e rjetit të ujit (km)	78,0	78,0	78,0	77,8	78,0	78,0	78,0	77,3
total water connections - total	nr. total i lidhjeve të ujit (me, dhë pa matës) - total	774,0	524,0	524,0	524,0	523,25	523	523	523
total water connections - urban area	nr. total i lidhjeve të ujit - qytet	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0
total water connections - rural area	nr. total i lidhjeve të ujit - fshat	774,0	524,0	524,0	524,0	523,25	523	523	523
continuity of service - average no. of hours	vazhdimësia e shërbimit - nr. mesatar i orëve të furnizimit	16,1	15,0	14,9	15,2	14,93	14,9	14,9	14,9
chlorine residual no. of samples	nr. testimoneve për klorin mbetës	207,0	245,0	249,0	247,0	202,00	275,0	258	258
chlorine residual no. of negative samples	nr. kampionave negative për klorin mbetës	207,0	245,0	249,0	247,0	202,00	275,0	258	258
quantity of chlorine consumed each month (kg)	sasia e klorit që konsumohet në secilin muaj (kg)	200,0	185,9	178,3	185,0	87,50	127,5	106,3	106,3
e. coli no. of samples	nr. testimoneve për koliform	207,0	245,0	249,0	247,0	202,00	272,0	258	258
e. coli no. of negative samples	nr. kampionave negative për koliform	207,0	245,0	249,0	247,0	202,00	272,0	258	258

*Tabela 1.3.6. Treguesit e ujit të ujësjellësit (periudha kohore 2008-2015) (burimi: <http://www.dpuk.gov.al/rub.php?idr=345&lang=1>, [http://www.dpuk.gov.al/ndermarrie\\_info.php?idn=1](http://www.dpuk.gov.al/ndermarrie_info.php?idn=1), [http://www.dpuk.gov.al/ndermarrie\\_info.php?idn=65](http://www.dpuk.gov.al/ndermarrie_info.php?idn=65))*



Banimi i kufizuar i Bashkisë Pukë (me tendenca të uljes së mëtejshme të popullsisë), aktiviteti bujqësor i kufizuar, aktivitet industrial pothuajse inekzistent, funksionojnë në mënyrë favorizuese, të paktën për sa i përket çështjes së mjaftueshmërisë së burimeve ujore. Megjithatë, ndërkoq që potenciali ujor mund të përmbushur nevojat furnizimit me ujë dhe ujitjes së Bashkisë (hyrjet), mangësitë dhe pamjaftueshmëritë serioze të rrjetit të kanalizimit, por edhe pamundësitë e përpunimit të ujërave të zeza urbane (daljeve), vënë në rrezik aspektet metabolike të zonës së studimit.

Për sa i përket ujërave nëntokësore, nuk ka të dhëna të qarta sasiore. Përveç kësaj, akuiferet nëntokësore shpesh shtrihen përej kufijve të pellgjeve lumore dhe zonave ujëmbledhëse. Gjithashtu, konsiderohet se depozitat e gjera të bakrit ndikojnë në cilësinë e ujërave nëntokësore. Një problem serioz për bashkinë është pamundësia për ti shërbyer të gjithë popullsisë për shkak të infrastrukturës jo të plotë. Aktualisht rrjeti i ujësjellësit ka nevojë për rikonstruksion dhe zgjerim të menjëherëshme për të mbuluar nevojat e qytetarëve.

Ripërdorimi i ujërave të shiut është një praktikë që së pari varet nga kushtet klimatike, njohurinë ekzistuese dhe mentaliteti i banorëve, dhe së dyti kufizohet nga struktura e mjedisit urban.

## Materialet

Materialet përdoren në funksionimin dhe mirëmbajtjen e aktiviteteve, në përmbushjen e nevojave të popullsisë, në ndërtimin e infrastrukturave etj (p.sh. ushqim, ambalazhim, materiale ndërtimi) dhe pas përdorimit të tyre ose depozitohen si rezervë në sistemin urban, ose hidhen si mbetje. Në mjediset urbane moderne fluksi i materialeve lidhet me mirëmbajtjen e aktiviteteve, ndërtimin e infrastrukturës, plotësimin e nevojave të popullsisë. Për shkak të natyrës dhe shumëllojshmërisë të tyre dhe të tregut të lirë, nuk është e mundur që të identifikohen influkset në Bashki, ndërsa flukset dalëse janë më të njohura dhe të identifikueshme (si mbetje, do të shqyrtohen në paragrafin e ardhshëm).

Megjithatë, vihet re se produktiviteti i zonës së studimit nuk është shumë i lartë sot. Për shkak të karakterit malor të zonës, aktiviteti bujqësor dhe industrial që ushtrohet është i kufizuar, kështu që është po ashtu i kufizuar dhe prodhimi i materialeve prej tyre. Përashtimi të vetëm përbën prodhimi i drurit për zjarr, i cili është gjithashtu mjeti kryesor për ngrohjen e banorëve, por pa pasur të dhëna specifike.

Bashkia e Pukës për shkak të reliefit malor të saj, me sipërfaqe toke të kultivuar dhe blektori të kufizuar (kryesisht për qëllime të familjare), paraqet një produktivitet relativisht të ulët në të mira materiale dhe ushqime, të cilat kryesisht konsumohen brenda Bashkisë. Në përgjithësi, vlen të përmendet se 80% e prodhimit bujqësor dhe blektoral përdoret për të plotësuar nevojat e prodhuesve, ndërsa një pjesë shumë e vogël tregtohet. Për shkak të pyjeve të shumta, përashtim përbën prodhimi i druve të zjarrit (nga prerja e pemëve), e cila është mjaft e përhapur. Druri i zjarrit shkon për qëllim ekskluzivisht ngrohjen e banorëve të bashkisë.

## Mbetjet dhe emetimet

Sistemi i menaxhimit të mbetjeve është ai i pari. Mbledhja, depozitimi dhe deponimi i mbetjeve tashmë është në kompetencë të Bashkive. Çdo Bashki është kërkuar që të përcaktohet një vend për depozitim e tyre. Aktualisht në Bashkinë Pukë funksionojnë dy vend-depozitime, josanitare dhe të paorganizuara, sipas Ministrisë së Zhvillimit Urban (<http://mbetjet.zhvillimurban.gov.al>), por edhe të kërkimeve në terren. Njëri gjendet në kufijtë me Bashkitë Fushë-Arrëz, ndërsa i dyti, në perëndim dhe në afërsi të qytetit Pukë. Gjithashtu, në bazë të vizitave në terren, u konstatuan vend depozitime të vogla e të pakontrolluara, të shpërndara në të gjithë territorin e Bashkisë.



Figura 1.3.5a dhe 1.3.5b: Pozicioni i deponimeve në Bashki



Nuk dihen të dhënat e cilësore (zona së cilës i shërben, viti, rrjedhat e mbetjeve etj. të regjistrimeve të ndryshme të mëposhtme (Ministria, INSTAT) dhe prandaj nuk janë të krahasueshme direkt me njëri-tjetrin ose me të dhëna të tjera të ngjashme dhe nuk mund të nxirren konkluzione të sigurta. Është shumë e mundshme që përbërja e mbetjeve të përfshijë dhe lloje të tjera përvç urbane (inerte, të rënda, mbetjet e kulturave etj).



Qarku	Mbetje Urbane (ton)	Mbetje Urbane për banorë (ton)	Mbetje Inerte (ton)
<b>2015</b>			
Shkodër	84.794	0,342	58.743

Tabela 1.3.6: Të dhëna për prodhimin e mbetjeve inerte në nivel Qarku Shkodër (Pukë) (Burimi: <http://www.instat.gov.al/en/themes/environment.aspx> - INSTAT - Vrojtimi vjetore mbi mbetjet urbane)

Qarku	Popullsia	Sasia vjetore (Ton / banorë)	Sasia vjetore (Mb.urbane/ton)	Sasia vjetore (Mb.inerte/ton)
<b>2013</b>				
Shkodër	339,072	0.195	66,453	12,510.5

Tabela 1.3.7: Të dhëna për prodhimin e mbetjeve në nivel Qarku Shkodër (Pukë)(Burimi: [http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Monitorim\\_Mjedisor/Mbetjet.pdf](http://www.mjedisi.gov.al/files/userfiles/Monitorim_Mjedisor/Mbetjet.pdf): «Tabela e sasisë së mbetjeve për vitin 2013», dhe përpunimi i tyre)

Bazuar në të dhënat e INSTAT<sup>9</sup>, ka pasur një rritje të vazhdueshme (pothuajse dyfishim) në sasinë e mbeturinave në nivel Qarku në dhjetëvjeçarin e fundit (2006-2015). Përkatësisht e vazhdueshme është dhe rritja e volumit të inerteve, të cilat janë trefishuar në nivel Qarku ndërmjet viteve 2006 dhe 2015. Megjithatë, meqë Bashkia e Pukës përbën vetëm 5% të popullsisë së përgjithshme të Qarkut, të dhënat e mësipërme mund të mos vlejnë.

Në këtë pikë, një problem për bashkinë janë mbeturinat organike të ngurta, për shkak të natyrës kryesisht rurale dhe ekonomisë lokale të bashkisë. Këto mbeturina, në një masë më të vogël, ngarkojnë ujin dhe nëntokën, ndërsa është e mundshme që ato të shfrytëzohen nëpërmjet kompostimit për prodhimin e plehrave, të dobishme për tu përdorur në kulturat e ndryshme. Dhe në këtë mënyrë, të fillojë procesi i riciklimit në zonën e studimit, ku aktualisht nuk kryhet për asnjë lloj mbetje, ndërsa nuk funksionon asnjë objekt përpunimi.

Sipas të dhënavës së disponuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve ([www.dpuk.gov.al](http://www.dpuk.gov.al)), për rrjetin e kanalizimeve të Bashkisë, në vitin 2015 në zonat urbane të Bashkisë Pukë ka patur vetëm 1.105 lidhjet në rrjetin e kanalizimit, të cilat i shërbjnë 2.620 banorëve nga 5.274 gjithsej. Nga të dhënat e Tabelës rezulton gjithashtu se lidhjet me rrjetin e kanalizimit janë numerikisht të barabarta me lidhjet me rrjetin e ujësjellësit, me hyrjet që arrijnë në 347.000m<sup>3</sup>. Përkatësisht në vitin 2015, në zonat rurale të Bashkisë (Puka f), ka pasur 78 lidhje me rrjetin e kanalizimit, të cilat i shërbën 250 persona 12.000 gjithsej. Lidhjet përkatëse me rrjetin e furnizimit me ujë ishin 523, duke krijuar hyrje prej 420,000m<sup>3</sup>. Si rrjedhojë, duke pasur parasysh se totali i të dhënavës për sistemin për vitin 2015 vlerësohet të jetë 767,000 m<sup>3</sup> për të gjithë Bashkinë (hapësira urbane dhe rurale), rezulton edhe shkalla përkatëse se madhësisë së daljeve.



<sup>9</sup> <http://www.instat.gov.al/en/themes/environment.aspx>

Për sa i përket mbetjeve të lëngëta, aktualisht nuk ka njësi përpunimin e tyre. Edhe pse dihet se mbetjet e lëngëta (sidomos të vendbanimeve rurale) shkarkohen drejtpërdrejt në mjedis (toka dhe rrjeti hidrografik i zonës), nuk ka elementë specifik të presionit të veçantë të ushtruar nga rrjedhjet në cilësinë e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë.



Për emetimet e gazit nuk ka të dhëna të hollësishme për shkak të mungesës së stacionit të regjistrimit. Ndotja e ajrit kryesisht i atribuohet ndikimit të aktiviteve antropogjene. Gjithashtu, djegia e drurit (që është burimi kryesor i ngrohjes për banorët vendas) është përgjegjës për lëshimin e sasive të konsiderueshme të mikrogrimcave dhe ndotësve të gazi, por nuk është e mundur vlerësimi gjithëpërfshirës i ndikimit të tyre.

Fenomeni është gjithashtu i lidhur ngushtë me ndryshimet klimatike. Për këtë arsyе monitorimi i ndotjes së ajrit është i domosdoshëm për të vlerësuar cilësinë e mjedisit urban.

Sipas Bankës Botërore emetimet e CO<sub>2</sub> për fryshtë për vitin 2011 arritën në 1.61 tonë metrikë. Në bazë të popullatës së Bashkisë për vitin 2011, emisionet e dioksidit të karbonit janë vlerësuar në  $11.069 * 1.61 = 17.821,09$  tonë metrikë.

Njësi Administrative	Nivelet PM 2.5	NOx (ton/vit) - 2015	SOx (ton/vit) - 2015	CO2 (ton/vit) - 2013
Pukë	14 µg/m <sup>3</sup>	31-60	1-15	6131.9
Gjegjan	15 µg/m <sup>3</sup>	16-30	1-15	4838.2
Rrapë	15 µg/m <sup>3</sup>	3-15	1-15	2306.9
Qelëz	14 µg/m <sup>3</sup>	16-30	1-15	2993.7
Qerret	15 µg/m <sup>3</sup>	3-15	1-15	2546.6

Tabela 1.3.9: Vlerësimet e ndotjes atmosferike në Bashkinë Pukë (Burimi: të dhëna nga Banka Botërore për të gjithë Shqipërinë dhe përllogaritja e përafërt e tyre sipas N.J.A.)

Ndotja e ajrit ndikon në metabolizmin e rajonit për sa i përket cilësisë së jetës dhe cilësisë së mjedisit. Eliminimi i fenomenit mund të arrihet me një sërë veprimesh në fusha të ndryshme të strukturës së qytetit. Mundësitet që Bashkia mund të shfrytëzojë janë integrimi i teknologjisë dhe promovimi i mjeteve alternative të transportit dhe transportit të materialeve.

Duke pasur parasysh sa më sipër, vlerësohet se mënyra aktuale e menaxhimit të mbetjeve është faktori më i rëndësishëm në përkeqësimin e metabolizmit të Bashkisë. Ekziston një mungesë e fortë e strukturave të posaçme të menaxhimit dhe përpunimit, ku vendet e depozitimit së paligjshëm të mbetjeve përkeqësojnë situatën. Për më tepër, dobësi të bashkisë janë edhe vendet e shumëfishta të hedhjes së mbetjeve të ngurta, të cilat degradojnë mjedisin natyror.

Përmirësimi i efikasitetit në rrjetet e mbetjeve kërkon ndryshimin e modelit të menaxhimit duke rritur riciklimin dhe shfrytëzimin e teknologjisë për të përmirësuar efikasitetin. Një tipar i rëndësishëm i Bashkisë është tendenca për të zvogëluar vëllimin e mbetjeve të gjeneruara.

Bazuar në sa më sipër, vlerësohet se mënyra aktuale e menaxhimit të mbetjeve është faktori më i rëndësishëm në përkeqësimin e Metabolizmit të bashkisë, me presionet



për të ardhmen të tregojnë se do të intensifikohet. Mungesa e objekteve të posaçme të menaxhimit, por edhe të trajtimit, këto flukse shkaktojnë ndotje si të tokës ashtu edhe të sipërfaqes dhe të ujërave nëntokësore. Si rrjedhim, ka mundësi menaxhimi të mbeturinave përmes miratimit të një modeli, i cili do të përfshijë aktivitetet e grumbullimit dhe transportit, magazinimit të përkohshëm, objekte të deponisë, operacione riciklimi dhe impiante, si edhe stacione ngarkimi.

## Konkluzione

Metabolizmi urban përbën një mjet i rëndësishëm për analizën hapësinore dhe programimin e zhvillimit të bashkisë. Megjithatë, studimet gjithëpërfshirëse që janë kryer deri më sot në nivel botëror janë të kufizuara dhe pilote. Dobësi kryesore në zbatimin e modelit, në përgjithësi dhe në veçanti në zonën e studimit, është mungesa e të dhënave dhe statistikave të vazhdueshme dhe analitike. Së fundmi, ka shumë parametra kyç që ndërveprojnë, siç janë rrethanat ekonomike, struktura urbane, shkalla e vetëmaftueshmërisë së komunave, efikasiteti i burimeve dhe qasja, të cilat e bëjnë zbatimin e këtij modeli edhe më të vështirë.

Për shkak të produktivitetit të kufizuar, banimit të kufizuar dhe mungesës së qendrave të mëdha urbane (shumica e tyre janë vendbanime shumë të vogla), hyrjet dhe daljet në sistemin e metabolizmit janë mjaft të kufizuara. Proçeset nuk arrijnë të jenë gjithmonë ciklike, sidomos për sa i përket mbetjeve dhe ujërave të zeza.

Për të vlerësuar sistemin metabolik të Bashkisë së Pukës, përmes seksioneve tematike që u ndanë, u përzgjodhën treguesit më të rëndësishëm, të cilët karakterizojnë parametra të rëndësishme të sistemit dhe nga ana tjeter kanë ndikimin më të madh. Vlerësimi ka lidhje me natyrën cilësore dhe lidhet me tendencat e zhvillimit të këtyre treguesve. Konkretisht, në çdo nënseksion vihen re një numër komponentësh të qytetit, por edhe të rajoneve periferike, të cilat duhet të përmirësohen, në mënyrë që të reduktohet konsumi i burimeve dhe të zbuten fenomenet e ndikimit negativ.

Duke pasur si çështje kryesore përmirësimin e synuar të rrethanave patogjene që ndikojnë në metabolismin për sa i përket cilësisë së jetës dhe cilësisë së mjedisit, propozohen veprimet e mëposhtme për Bashkinë:

- ndryshimi total i modelit të menaxhimit të mbetjeve (të lëngshme dhe të ngurta). Përpunimi (në impiante të përshtatshme) të ujërave të zeza urbane, përhapjen e riciklimit të ambalazhimeve dhe mbetjeve organike të ngurta urbane, në mënyrë që në të ardhmen, deponimi i mbetjeve të kufizohet në ato që taprojnë nga mënyrat alternative të menaxhimit.
- marrja e masa për të parandaluar dhe rehabilituar ndotjen e burimeve ujore (sipërfaqësore dhe nëntokësore).
- shfrytëzimi i Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (p.sh. diellore, biomasa), veçanërisht për plotësimin e nevojave të ngrohjes (me synim reduktimin e ndotjeve atmosferike për shkak të djegies së lëndës së drurit). Gjithashtu, shfrytëzim i BRE për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe shërbimeve të ofruara në



të gjitha vendbanimet dhe veçanërisht për të arritur objektivat kombëtare të Shqipërisë për autonomi energetike me importe enegjie zero në në ardhmen (Plani Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Enerjisë).

- shfrytëzimi i ujërave të shiut (i cili nuk ndodh zakonisht) për mbulimin e nevojave të furnizimit me ujë por edhe të ujitjes (nëpërmjet rezervuarëve etj).
- informimi dhe sensibilizimi i banorëve dhe bizneseve për çështjet e metabolizmit urban, kursimit të ujit dhe mbrojtjes së rezervave të ujit, riciklimit etj.

#### 1.4. Përcaktimi i territorit sipas pesë sistemeve territoriale

Në kuadër të hartimit të strategisë territoriale, territori i Bashkisë ndahet në pesë sistemet: urban, natyror, bujqësor, ujor dhe infrastrukturor. Në veçanti, duke përbledhur regjistrimet analitike dhe rezultatet e fazës A, janë evidentuar zonat më të rëndësishme të sistemeve territoriale të Bashkisë Pukë, duke bërë një vlerësim paraprak.

Në Tabelën më poshtë tregohet niveli, përqindja e mbulimit të secilit sistem, në krahasim me sipërfaqen totale brenda kufijve administrativë të Bashkisë.

SISTEMI TERRITORIAL	PËRQINDJA %
Sistemi natyror	92.4%
Sistemi ujor	1.5%
Sistemi bujqësor	4.4%
Sistemi urban	1.0%
Sistemi infrastrukturor	0.7%

*Tabela 1.4. Përqindja e sistemeve territoriale në Bashkinë Pukë*

Nga tabela rezulton se përqindja më e madhe e territoreve në Bashkinë Pukë mbulohet nga sistemi natyror me 92.4%, ndërkohë që pasojnë sistemi bujqësor me përqindje 4.4%. Pason sistemi ujor me 1.5%, ndërsa sistemi urban dhe sistemi infrastrukturor mbulojnë nën 1% dhe 0.7% të sipërfaqes së Bashkisë.

##### Sistemi natyror

Sistemi natyror i përdorimit të tokës përfshin të gjitha ato përdorime që lidhen me zonat natyrore: pyjet, kullotat, livadhet dhe zonat jo pjellore të reliefit gjysmëmalor.

Në Jug të Bashkisë shtrihet masivi i malit të Tërbunit i cili është elementi më i dalluar sistemit, si për shkak të përmasave ashtu edhe për shkak të vlerave natyrore dhe kulturore që ai mbart.

Zonat pyjore mbulojnë pjesën më të madhe të Bashkisë së Pukës, kryesisht në jug dhe perëndim të qytetit të Pukës. Një tipar i përbashkët i këtyre zonave është se karakteri i



tyre nuk ka ndryshuar, pasi qasja në të kryhet kryesisht duke përdorur shtrigjet dhe monopatet dhe në disa pika të caktuara përmes segmenteve rrugore, të cilat të çojnë në vendbanimet e afërta dhe njësitë administrative të bashkisë.

Gjithashtu, në zonë vihen re edhe kullota, të cilat gjenden në rrëze të vogla rrëth vendbaneve me orientim ekonomik kryesisht për blegtorinë për nevojat e jetesës të banorëve.

### Sistemi ujor

Bashkia përshkohet nga një rrjet i pasur dhe i dendur ujor, ku organet kryesore ujore që e përshkojnë apo kalojnë nga ajo janë lumenjtë Fan i Madh, Gomsiqe, lumi i Gjadrit dhe Gomina. Ky sistem territorial përbën 1.5% të sipërfaqes totale të zonës së studimit. Lumi më i madh i Bashkisë është lumi Fan i Madh. Ai është i vendosur në pjesën juglindore të bashkisë dhe rrjedh në një drejtim nga veriu në jug, lumi i Gjadrit rrjedh nga jugperëndimi i bashkisë në kufi me bashkinë e Mirditës, ndërsa në veri të bashkisë gjendet rrjedha e lumit Gomina. Lumi Fan i Madh kalon përgjatë tokave të kultivuara bujqësore dhe ndodhet në një distancë të sigurt nga vendbanimet.

Për shkak të gjeomorfologjisë së veçantë të Bashkisë së Pukës, në sajë të maleve Munella dhe Tërbun, janë formuar gjatë viteve shumë pellgjeve ujëmbledhës, përmes të cilave ujërat e shiut kanalizohen në pellgje natyrore të vogla por edhe përrrenj (sezonalë ose jo) duke përfunduar në lumenjtë e lartpërmendur. Morfologjia e tokës paraqitet me luhatje të mëdha për shkak të shpateve të pjerrëta malore. Përrrenjtë rrjedhin kryesisht nëpër pyje dhe, në disa raste, nga vendbanimet, p.sh. Kimëz, Mesul, Kaftallë, duke krijuar rreziqe të erozionit të tokës së tyre.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) promovon mbrojtjen e burimeve ujore nga gjërmimi i pakontrolluar e zhavorrit në basenet ujore, hedhja e mbeturinave urbane dhe ndotja nga aktivitetet bujqësore e industriale, përmes përcaktimit të të ashtuquajturit linja blu. Gjithashtu, me prioritet përmendet modernizimi dhe forcimi i infrastrukturës ekzistuese të ujësjellësit dhe ujitjes me synim për të minimizuar humbjet e rrjetit dhe për ta menaxhuar burimet në mënyrë më të qëndrueshme.



### Sistemi bujqësor

Në këtë sistem përfshihen të gjitha kulturat bujqësore brenda kufijve të Bashkisë dhe të gjitha infrastrukturat e tyre mbështetëse, siç janë rrjetet e ujitjes, serat, depot dhe njësitë e mbarështimit të shpesëve/kafshëve. Mund të bëhet dallimi i këtyre zonave në dy nën-kategori: ato që ndodhen në zonat fushore të Bashkisë, si p.sh. përgjatë lumit Fan i Madh dhe Gomina, në zonën e Qerret, Kçirë (Luf, Luf-Plan) në luginën Kaftallë, etj, dhe atyre që gjenden në pjesën më malore të saj. Shumica e kulturave fushore nuk janë të rrethuara, ato kanë të bëjnë me prodhimin e bimëve foragjere dhe vreshtave të vogla dhe janë të ujitura. Në përgjithësi, në Bashki nuk hasen zona që përdorin sera.

Në vendbanimet më veriore dhe në ato me lartësi më të madhe gjenden jo shumë sipërfaqe të kultivuara, të cilat kufizohen nga vegjetacioni natyror dhe nuk janë



lehtësisht të arritshme për shkak të mungesës së infrastrukturës së mjaftueshme rrugore dhe të reliefit të vështirë.

Objektet e blektorisë janë të kufizuara dhe zakonisht janë të vendosura në zonën e banimit.

Theksohet se në kuadër të sistemit bujqësor janë përfshirë edhe banesat individuale të vendosura brenda kulturave bujqësore. Këto janë vendbanime të përherëshme të bujqve. Së fundmi, sqarohet se për shkak të madhësisë, konfigurimit dhe shpërndarjes së tokës bujqësore, shpesh-herë nuk ka rrugë të veçanta për shërbimin e kulturave bujqësore.

### Sistemi urban

Rrjeti urban i Bashkisë Pukë ka si qendër qytetin e Pukës dhe një numër vendbanimesh të tjera, të cilat shtrihen në të gjithë sipërafaqen e njësisë administrative të Rrapës, Gjegjanit, Qerretit dhe Qellëzit, me përashtim të Tërbunit.

Qyteti i Pukës është qendra ekonomike e bashkisë me të njëjtin emër, por edhe e rajonit më të gjerë, pasi ai është një qendër shërbimi. Përveç qytetit të Pukës, ku gjenden shërbime si policia, gjykata, banka, dyqane pakice, restorante, shërbime të ndryshme publike etj., pjesa tjetër e vendbanimeve përbëhet ekskluzivisht nga banesa. Vetëm në vendbanimet më të mëdha ndeshen shërbime të tjera bazë, si kafene, ushqimore, të cilat plotësojnë nevojat e përditshme të popullsisë.

Përdorimet për industrinë janë të kufizuara dhe hasen në zonën në veriperëndim të rrjetit urban në distancë shumë të afërt me të, si për shkak të hapësirës së disponueshme e infrastrukturave, ashtu dhe në shërbim të qasjes në këto njësi për fuqinë punëtore dhe për makineritë e furnizimit.

Në të gjitha vendbanimet e bashkisë ndeshen varreza, zakonisht pranë kufirit të vendbanimeve (në hyrje ose dalje të tyre). Së fundi, në Pukë vlen të përmenden objektet ushtarake të cilat aktualisht janë jashtë funksionit.

### Sistemi infrastrukturor

Ky sistem territorial përfshin infrastrukturën e transportit, infrastrukturën energetike, të telekomunikacionit, furnizimit me ujë dhe menaxhimit të mbetjeve. Ndër më të rëndësishmet konsiderohen rrugët ndër-urbane, rurale dhe hidrocentralet, si për shkak të madhësisë ashtu dhe të rëndësisë përvendin e tyre në planin kombëtar. Ky sistem zë 0.7% të sipërafaqës totale të zonës në studim.

Ruga kryesore që përshkon Bashkinë e Pukës është pjesë e Rrjetit Rrugor Kombëtar (SH 5), që lidh qytetin e Shkodrës në veriperëndim me qytetin e Kukësit në verilindje; e cila në pjesën më të madhe kalon përmes peizazheve natyrore. Aksi rrugor shtetëror SH 30, i cili drejtohet nga veriu në jug, fillon nga njësia administrative Rrapë, kalon nëpër Gjegjan dhe përfundon në jug në bashkinë e Mirditës.

Vlen të përmendet se në përgjithësi ka një lidhje të pamjaftueshme ndërmjet vendbanimeve të ndryshme, që ka si rezultat rëndimin më të madh të rrugëve



shtetërore SH5 dhe SH30, pasi nëpërmjet tyre bëhet lidhja rrugore e njësive të ndryshme administrative. Megjithatë, ngarkesa e tyre e trafikut është relativisht e vogël.

Për sa i përket infrastrukturave të tjera, u regjistruan tre hidrocentrale në fshatrat Kabash dhe Qelëz dhe në njësinë administrative të Gjegjanit, ndërsa diga e Komanit shtrihet në kufijtë e Bashkisë me Bashkinë Vau i Dejës, një nënstacion elektrik brenda qytetit të Pukës, stacione dhe antena të telekomunikacionit, infrastrukturë të transmetimit të energjisë elektrike, të tilla si transformator dhe kabinë elektrike, të cilat gjenden jashtë zonave të banuara dhe 2 zona aktive të hedhjes së mbeturinave, të rrethuara nga zona natyrore. Shumica e objekteve të mësipërme, siç kemi parë, janë kryesisht brenda sistemit fizik.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) njeh nevojën e përforcimit të menjëhershëm të rrjetit të infrastrukturës rrugore në të gjithë territorin Shqiptar dhe për këtë arsy propozon shtim të investimeve në këtë fushë duke vënë disa projekte specifike si prioritet të parë.

## 1.5. Identifikimi i nevojave, potenciali dhe kufizimet

Bazuar në gjetjet e analizës (faza A); karakteristikat kryesore të zonës së studimit, çështjet kryesore të identikuara në diskutimin e parë publik, dhe programet e menduara e që po përpunohen dhe projektet që ndikojnë në zonën e studimit, kemi paraqitur analizën SWOT për secilin nga pesë sistemet territoriale, si më poshtë:

- Përparësitë krahasuese, faktorët e dobishëm endogenë (Përparësitë)
- Mangësitë, probleme të qenësishme (Mangësitë).
- Mundësitë e jashtme dhe perspektivat (Mundësitë).
- Kërcënimet ekzogjene të origjinës dhe kërcënimet (Kërcënimet).

Analiza SWOT është bazë për planifikimin e strategjisë së zhvillimit territorial. Në bazë të analizës SWOT, strategja i jep prioritet:

- Shfrytëzimit të përparësive të brendshme (S) për:
  - Përdorimin efektiv të mundësive (O) që ofron mjeti i jashtëm.
  - Përballimit të kërcëimeve të jashtme (T).
- Përballimit të dobësive të brendshme (W) dhe veçanërisht të atyre që:
  - Pengojnë shfrytëzimin e mundësive të jashtme (O).
  - Rrisin kërcënimet e jashtme (T).



Efekti pozitiv - faktorë përfocues	Efekti negativ - faktorë pengues	Efekti pozitiv - faktorë përfocues	Efekti negativ - faktorë pengues
PIKA TË FORTA	PIKA TË DOBËTA	MUNDËSI - PERSPEKTIVA	RREZIQUE
<b>Mjedisi natyror dhe kulturor</b>			<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Fatkeqësi natyrore për shkak të ndryshimeve klimatike.</li> <li>■ Presione intensive për mjedisin dhe ndryshime të peizazhit për shkak të turizmit, mbipopullimit - aktiviteteve në zonat e njësime, tejkalim të mundësive, ndërtimi i hidrocentralave</li> <li>■ Zvogëlim i sasisë - degradim i cilësisë së ujit për shkak të mbingarkimit - mbipërdorimit dhe shfrytëzimit iracional në aktivitetet ekonomike (ujitja, prodhimi i energjisë, minierat, zhvillimi urban etj.).</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Shumëlojshmëri gjemorologjike (male të larta, rrashnalta të vogla me sipërfaqe të kultivuara dhe kullota, rezervuare artificiale dhe liqene, lugina të ngushta, lumenej dhe ujëvara, shpella, etj) - mjedis i pastër dhe i qetë.</li> <li>■ Rrjet i pasur hidrografik dhe akufërë nëntokësore.</li> <li>■ Depozita të konsiderueshme të burimeve minerale.</li> <li>■ Zona të shumta me vegetacion të pyllëzuar.</li> <li>■ Kushte të favorshme territoriale dhe klimatike për prodhimin e produkteve bujqësore dhe bletarisë.</li> <li>■ Ekzistencë e monumenteve të shpallura të natyrës - planifikim i integrimit të zonave të reja dhe të elementeve në sistemin</li> </ul>			<ul style="list-style-type: none"> <li>■ Mirëmbajje dhe mbrojtje e pamjaftueshme e monumenteve kulturore.</li> <li>■ Mungesë lidhjeje dhe promovimi të mjedisit kulturor dhe natyror.</li> <li>■ Mungesë - pamjaftueshmëri sistemesh menaxhimi të mbeturinave të lëngëta dhe të ngurta - hedhje e shpërndarë dhe e pakontrolluar e produkteve të mbeturinave dhe mbetjeve nga shkatërrimet e ndërtuesave.</li> <li>■ Kushnë të favorshme territoriale dhe klimatike për prodhimin e produkteve bujqësore dhe bletarisë.</li> <li>■ Ekzistencë e monumenteve të shpallura të natyrës - planifikim i integrimit të zonave të reja dhe të elementeve në sistemin</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ Shpallje e monumenteve të reja natyrore dhe kulturore.</li> <li>■ Zbatim i planeve të menaxhimit për zonat e mbrojtura.</li> <li>■ Promovim i turizmit alternativ në nivel qëndror e rajonal dhe sigurimi i stimujve për të mbëshitetur sipërmarrjen përkatëse.</li> <li>■ Ndërhyrje të integruaratë menaxhimit të trashëgimisë kulturore.</li> <li>■ Krijimi i korridoreve të gjelbërtë përgjatë lumenit Drin (përshtkon razonini nga perëndimi deri në Lindje - lidhje Liqenin e Shkodrës dhe Kosovën) dhe lumenit Fan i Madh.</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ kombëtar të mbrojtjes.</li> <li>▪ Trashëgimi e pasur historike dhe arkitektonike dhe ndërtesa të mirënjoitura (kisha, xhami, këshjella, etj) të periudhave të ndryshme historike.</li> <li>▪ Ekzistencë e monumenteve të deklaruara kulturore.</li> </ul>	<p><b>M j e d i s i S o c i a l</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Kohezion social - lidhje të fortë familjare.</li> <li>▪ Mungesë e grupeve sociale të marginalizuar - kriminale.</li> <li>▪ Plotësimi i nevojave ekonomike familjare nga vëtprodhimi i ushqimit (kryesisht në fshatra).</li> <li>▪ Identitet i forte social i lidhur me traditën dhe zakonet e forta.</li> <li>▪ Reduktim i populsisë gjatë dekadave të fundit.</li> <li>▪ Evolucion negativ në strukturën e piramidës së moshës.</li> <li>▪ Tendenca braktisjeje në fshatra të largëta, kryesisht nga të rinjët.</li> <li>▪ Pabarazi midis qyteteve dhe fshatrave në aspektin e infrastrukturës dhe shërbimeve sociale të ofruara.</li> <li>▪ Mungesë personeli të kualifikuar dhe të trajnuar.</li> <li>▪ Intensitet i fenomeneve të përjashtimit dhe pabarazisë sociale dhe të punësimit (p.sh. personat me aftësi të kufizuara, gratë).</li> <li>▪ Rrija e indekseve të plakjes dhe varesej.</li> <li>▪ Forcimi i tendencës për të braktisur vendbanimet nga moshat prodhuese.</li> </ul>
--	---





## Ekonomia

<ul style="list-style-type: none"><li>Fqinjësi me qendrën urbane të Shkodrës, si dhe dy zona të bashkëpunimit ndërkuifit: (a) Kukës-Prishtinë, ku përfshihet aeroporti dhe (b) Shkodër-Podgoricë, e cila përfshin portin i Shëngjinit.</li><li>Produktet pastra dhe të ndryshme bujqësore / gastronomike.</li><li>Aktivizim i kompanive të industrisë nxjerriše - specializimi i kapaciteteve lokale.</li><li>Njohje relative e rajonit për produktet bujqësore lokale (bimët medicinale, marmalata etj.).</li><li>Përvojë dhe specializim në aktivitetet primare (p.sh. fruta, kërpudha, bimë medicinale).</li><li>Toka të mjafueshme dhe të lira dhe kosto të ulëta të punës për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore dhe blektorale.</li><li>Ekzistenca e burimeve që mund</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Ekonomi i të vogla familjare të destinuara kryesisht për konsumin e brendshëm dhe familjar.</li><li>Një pjesë e të ardhurave të rezidentëve bazohet në assistencën financiare të të afërmve që punojnë jashtë dhe brenda vendit.</li><li>Mungesa e lidhjes midis sektorëve të prodhimit.</li><li>Rritje e kërkuesave për infrastrukturën urbane për shakat shpërndarjes së madhe të ndërtesave dhe qasjes së vështirë.</li><li>Papuniësia e lartë - Normë e reduktuar e punësimit në mesin e të rinjve.</li><li>Copëzimi i pronës rurale, mungesa e mekanizmit të mjeteve moderne të prodhimit dhe korrijes, mungesë standardizimi promovimi të produkteve.</li><li>Infrastrukturë e</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>Kërkkesë në rritje përfunduese alternative të turizmit dhe për prodhimet bujqësore dhe blektorale me cilësi në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare.</li><li>Konsolidim i elementeve historike, arkitektonike dhe kulturore - karakteristikeve geomorfologjike dhe fizike për zhvillimin e ekonomisë së turizmit dhe kryesisht atij alternativ.</li><li>Zbatimi i PKS për zonën Alpine (zhvillimi i poleve Komani dhe itinerarit vozitës përgjatë Lumin të Drinit).</li><li>Papësira të rëndësishme për stimulimin dhe transformimin e aktivitetit rural (p.sh. prodhimin e produkteve tradicionale dhe me origjinë lokale).</li><li>Përmirësimi dhe zhvillimi i shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).</li><li>Vështirësi përshtatjeje e Konkurrencë nga rajonet fqinje me turizëm tashmë të zhvilluar malor.</li><li>Rritje e interesit për turizmin bregdetar si një vend ashtu edhe jashtë vendit.</li><li>Parundësia gjetjeje të burimeve të mjafueshme financiare.</li><li>Vonesë të ndryshimeve të nevojshme strukturore në prodhimin bujqësor.</li><li>Indeks i lartë migrimi i personave që i përkasin moshave produktive.</li><li>Rrezik i mënjamimit të Bashkisë pasi nga ajo nuk kalonjë akse kryesore të zhvillimit dhe transportit të nivelit kombëtar - anashkalim për shkak të preferencës përfrrugën E-851 ose këshimet përmes Ligjen të Komanit.</li><li>Vështirësi përshtatjeje e</li></ul>
--	--	---

<p>të krijojnë kushte të favorshme për zhvillimin e turizmit kulturor, agroturizmit dhe mjekekësi.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Ekzistanca e kushteve bazë për diversifikimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të përgjegjdhura në sektorin primar (specializim, burime, kooperativa, etj.).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>pamjaftueshmë turistike (hotelet, rrugët turistike, tabelat, etj.).</li> <li>Identiteti i paqartë turistik / promovim problematik (marketingu).</li> <li>Sezonalitet i fortë, me qëndrim shumë të shkurtër të turistëve.</li> <li>Personeli i pa kualifikuar.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkisë në kuadër të hapësirës së përbashkët evropiane.</li> <li>Stimulim - zhvillimi i industrisë minerare për shfrytëzimin e minraleve (prioritet PPK).</li> <li>Zhvillim i korridoreve për biçikleta përgjatë rrugës SH5 Vau i Dejës-Pukë-Fushë Arreza (drejtimi L-P) si edhe përgjatë rrugës SH30 Pukë-Gjegjani-Rreshen (V-A) (prioritet nën PPK).</li> <li>Zgjerimi i Zonës Ekonomike të Përbashkët në Ballkan.</li> <li>Rritja e investimeve të huaja direkte.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Formacion i vëçanta banimi.</li> <li>Zbatim i projekteve të rigjenerimit urban - Interesi i vazdueshëm i bashkisë.</li> <li>Hartimi i PPV.</li> <li>Ndërtim i përshtatshëm me peizazhin (në vija të përgjithshme).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Mirëmbajtje dhe braktisje jo e plotë apo eficiencë e ulët e energetike e stokut të ndërtesave.</li> <li>Urbanizim i ulët - shpërndarje e madhe e ndërtesave dhe e popullsisë.</li> <li>Mungesë e hapësirave të organizuara të përbashkëta</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Investime në përmirësimin e mjesdit urban - rrinovime rezidenciale.</li> <li>Zhvillim urban i organizuar bazuar në projektimin bioklimatik.</li> <li>Programe të përmirësimit të energjisë për ndërtesat ekzistuese.</li> <li>Promovim i shtimit të</li> </ul>



<p>në fshatra.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Qasje e pamjaftueshme e disa fshatrave në infrastrukturë urbane të kënaqshme (energji elektrike, furnizim me uje, kanalizim).</li> <li>▪ Braktisje e vendbanimeve më të vogla dhe më të largëta - reduktim dhe degradim i cilësisë së organizimit hapësinor dhe stokut të ndërtesës.</li> </ul>	<p>hapësirës së gjelbër.</p> <p><b>Q asja d he Infrastruktura</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përshkohet nga një aks i rëndësishëm të infrastrukturës së transportit (SH5).</li> <li>▪ Infrastrukturë e rëndësishme për prodhimin dhe transportin e energjisë (hidrocentralat, nënstationet e energjisë, linjat e transmetimit të energjisë të tensionit të lartë).</li> </ul>	<p>▪ Distanca të konsiderueshme kohore të Bashkisë nga qendrat e rëndësishme të aktivitetit ekonomik dhe shpërndarës të transportit.</p> <p>▪ Mungesë lidhjesh midis vendbanimeve të ndryshme me njëri-tjetrin dhe me selinë e Bashkisë.</p> <p>▪ Mungesë lidhjesh të drejtërdrejtë të pjesës veri-perëndimore (Koman)</p>	<p>▪ Ndërtim - përmirësim i rrugëve që lidh bashkinë me fqinjët dhe kryesish të zonën alpine.</p> <p>▪ Fqinjësi me vijën hekurudhere të propozuar që kalon në bashkinë fqinje të Mirditës.</p> <p>▪ Investime në infrastrukturën për qasje brenda dhe jashtë bashkisë.</p> <p>▪ Investime - stimuj për zhvillimin e parqeve eolike</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Ndërtim - përmirësim i rrugëve që kalojnë përmes Bashkisë.</li> <li>▪ Pamundësi mirëmbajjeje të një niveli të lartë të sigurisë rrugore për shkak të faktorëve gjeologjikë dhe mjedisore.</li> <li>▪ Mungesë e investimeve në infrastrukturën e mbrojtjes së mjedisit.</li> </ul>
---	---	--	---



	<p>me pjesën tjeter të Bashkisë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>■ Rrjetë të pamjftueshme të infrastrukturës teknike urbane dhe cilësi e dobët e atyre ekzistuese (kryesisht në fshatra).</li> <li>■ Infrastrukturë e pamjftueshme rurale (punime për rikuperimin e tokës, mekanizimi etj.).</li> <li>■ Mungesë të sistemit të organizuar të menaxhimit të mbeturinave.</li> <li>■ Situatë e pamjftueshëm e infrastrukturës shëndetësore (mungesë e teknologjisë, ngrohjes etj.).</li> </ul>



## 1.6. Vizioni i Zhvillimit dhe Strategjia Territoriale

### 1.6.1. Vizioni i zhvillimit

Duke marrë parasysh faktet reale, si edhe kërkesat që ata kërkojnë, siç edhe u pasqyruan dhe u vlerësuan në Fazën A' të studimit, përfshirë dhe analizën e mëparshme SWOT, përcaktohet vizioni i zhvillimit të Bashkisë për vitin 2032. Vizioni i Zhvillimit të Bashkisë ka për qëllim të trajtojë dhe përballojë dobësitë dhe rreziqet e evidentuara në bashki; të shfrytëzojë avantazhet natyrale dhe të përsituara; si dhe mundësitë e paraqitura për zhvillim. Vizioni i zhvillimit të Bashkisë Pukë për vitin 2032 formulohet si më poshtë:

*"Bashkia Pukë, me mijedisin e pasur natyrore dhe peizazhet e paprekura të një bukurie mahnitëse, do të jetë një qendër malore e formave alternative të turizmit që do të shfrytëzojnë burimet natyrore. Do të jetë gjithashtu një qendër zhvillimi pilot në sektorin bujqësor dhe agro-blegtorisë, me theks të veçantë në produktet e certifikuara vendase".*

Propozohet zhvillimi i qëndrueshëm i territorit të Bashkisë, bazuar në dy shtylla kryesore:

Nga njëra anë, promovimi i formave alternative të turizmit përmes mbrojtjes, menaxhimit të duhur dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore, duke përmirësuar qasjen në Bashki përmes sigurimit të infrastrukturave efikase të transportit, si dhe përmes aktiviteteve të përshtatshme të promovimit dhe marketingut. Më konkretisht, propozohet forcimi i identitetit të Bashkisë me fokus mijedisin e pasur natyrore dhe elementët e veçantë dallues.

Nga ana tjetër, zhvillimi i qëndrueshëm i sektorit agro-blegotoral dhe bujqësor, me theks prodhimin e specializuar të produkteve cilësore vendore dhe përpunimin e tyre. Gjithashtu synohet edhe promovimi i formave standarde të kultivimeve bujqësore, përmes: promovimit të fermave kolektive, shfrytëzimit të hapësirës bujqësore, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, trajnimit të përshtatshëm të punonjësve, si dhe veçanërisht menaxhimin efikas të ujitjes dhe tokave të kultovuara.

### 1.6.2. Strategjia dhe Objektivat e Zhvillimit

Parimet kryesore udhëzuese për zbatimin e strategjisë së vizionit dhe zhvillimit të Bashkisë Pukë renditen më poshtë me emërtimin Objektivat Strategjike, ku për secilin janë paraqitur parametrat e veçantë që do të realizojnë zbatueshmërinë e tyre.

**Objktivi Strategjik 1:** Përtëritje ekonomike e rajonit përmes promovimit të formave alternative të turizmit.

Objktivi i parë strategjik synon shfrytëzimin e bukurive dhe veçantive natyrore malore në Bashkinë Pukë, me qëllim promovimin e formave alternative të turizmit.



Bashkia Pukë karakterizohet nga një peisazh të thyer natyror, ku bëjnë pjesë mali i Krabit në pjesën veriore, Mali i Munellës në pjesën jug perëndimore, Mali i Rditës në pjesën jugore, Mali Tërbon në pjesën qendore, si dhe luginat e lumenjve Drin, Fani i Madh, Gomsiqe e Gjadër. Këto pasuri paraqesin potencial të lartë ekonomik, me mundësi promovimin dhe zhvillimin e zonës në nivel ndërkombëtar. Përmes shfrytëzimit të kësaj bukurie të veçantë natyrore propozohet promovimi me projekte konkrete dhe veprime specifike për zhvillimin e formave alternative të turizmit. Veprimet e propozuara sipas këtij objektivi duhet të kenë karakter integrues dhe ndërhyrja të ketë rezultate të dukshme në cilësinë e jetës së banorëve dhe në zhvillimin e turizmit.

Në kuadër të zhvillimit të formave alternative të turizmit, propozohet zhvillimi i turizmit malor duke promovuar aktivitete si: ngjitje në mal, eksplorim shpellash, ski, çiklizëm, hipizëm, gjuajtje me hark, kalim kanioni, etj. Gjithashtu mund të zhvillohen aktivitete në lumenj e liqene, të tilla si: noti, lëvizje me canoe apo kajak, si dhe aktivitete ajrore të tilla si rrëshqitje me litar (flying fox, zipline), parashutizëm etj.

Përveç llojeve të turizmit që janë të lidhura ngushtë me mjedisin natyror, propozohet paralelisht edhe turizmi sportiv. Me turizmin sportiv do të krijohen infrastruktura sportive dhe turistike, në mënyrë që të jetë e mundur përgatitja e përshtashme e sportistëve individualë dhe ekipeve, sidomos gjatë periudhës së verës ku klima e freskët dhe e shëndetshme e Pukës favorizon stërvitjet e vështira të sportistëve. Përveç kësaj, objektet sportive e turistike do të mund të përdoren nga turistët e rastësishëm gjatë gjithë vitit.

Gjithashtu, propozohet zhvillimi i ekoturizmit si një formë turizmi e cila kombinon aktivitetet turistike në natyrë, kryesisht në zona me vlera ekologjikishe apo zona të mbrojtura natyrore, duke përfshirë aktivitete me karakter shkencor dhe edukativ (p.sh. turizëm për vëzhgimin e ekosistemeve, të florës dhe faunës).

Parakusht për zhvillimet e sipër-përmendura është përmirësimi i infrastrukturës, veçanërisht i asaj të transportit, me qëllim për tu siguruar nevojat përkatëse të banorëve të Bashkisë, por që të mund të ketë lidhje efektive me bashkitë fqinje dhe pjesën tjeter të vendit; si dhe përmirësimi i shërbimeve në zonën e Bashkisë (për shembull, ushqimi social, mikpritja etj.). Përmirësimi i infrastrukturës së Bashkisë do të rrisë cilësinë e standardit të jetesës së banorëve si dhe mirëqenien e tyre. Në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës propozohet edhe zbatimi i projekteve të vogla infrastrukturore, si: kriimi i akomodimit turistik, kriimi i rrugëve për këmbësorë, kriimi i parqeve për aktivitete, ndërtimi i godinave prej druri në zonat natyrore për qëllime turistike/shërimesh, kriimi i objekteve sportive, organizimi i aktivitatave sportive, muzeve, sistemimi i sheshevë dhe i hapësirave publike, rinovimi i ndërtesave, etj. Të gjitha këto pritet të kontribuojnë në ndryshimin e nivelit të migrimit në Bashki, kryesisht për shkak të zvogëlimit të aktivitatave prodhuase, dhe në vazhdimin e krijimit të kushteve më të favorshme për zhvillimin e aktivitatave të reja ekonomike.

Për më tepër, duhet të përmirësohet infrastruktura tekniko-sociale e Bashkisë, në mënyrë që banorët të mund të jetojnë në një mjedis të qëndrueshëm dhe të përmirësuar, i cili do të jetë tèrheqës, do të ndihmojë në reduktimin dhe zhdukjen e problemeve të migrimit drejt qendrave të tjera urbane dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së saj. Për më tepër, theksi do të jepet për promovimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit natyror, përmes mbrojtjes dhe respektimit të burimeve natyrore, si edhe kënaqjen e nevojës për menaxhimin efektiv të mbeturinave të lëngshme dhe të ngurta, sidomos nëse zhvillimi turistik çon në një rritje të konsiderueshme të tyre në lidhje me ato ekzistuese.

Për të zbatuar qëllimin e mësipërm strategjik duhet të miratohen veprimet e nevojshme të reklamimit, promovimit dhe marketingut në rajon më gjërë.

### **Objektivi strategjik 2: Rivitalizimi ekonomik i rajonit përmes zhvillimit të sektorit bujqësor.**

Ky objektiv do të arrihet përmes menaxhimit të integruar të sektorit të agro-blegtorisë me theks forcimin e aktiviteteve bujqësore në lidhje me prodhimin e produkteve cilësore vendase dhe promovimin e tyre përmes institucioneve përkatëse kolektive; si dhe përforcimin e sektorëve të përpunimit të produkteve bujqësore e blegtoriale. Paralelisht është propozuar edhe promovimi i turizmit rural nëpërmjet krijimit të proceseve standarde të prodhimit dhe krijimit të infrastrukturës së nevojshme. Kjo rritje ekonomike pritet të kontribuojë dhe në rigjenerimin përkatës të popullsisë, në fazën e parë me mbajtje të popullsisë dhe ndalim të migrimit të saj, dhe së dyti me rritjen e mëtejshme të saj.

Bujqësia dhe blegtoria janë burimet kryesore ekonomike vendase, por kryesisht për qëllime vetë-konsumimi. Hapësirat për përmirësim në këto fusha janë të mëdha, pasi praktikat që po ndiqen sot nuk sjellin maksimumin në prodhim dhe në përfitim ekonomik. Në këtë kontekst, propozohet organizimi i prodhimit agro - blegtoral duke përdorur metoda ekologjikisht miqësore, në mënyrë që mos të shkaktohen dëme të parikuperueshme në mjedis, si për shkak të keqpërdorimit të burimeve natyrore, ose për shkak të ndotjes dhe dëmtimit të tyre. Për shkak të ekzistencës së produkteve të veçanta vendase (fruta, fruta pylli, bimë mjekësore dhe aromatike, etj.) sugjerohet organizimi i përshtatshëm - forcimi i sektorit të bujqësisë dhe promovimi i tyre përmes institucioneve kolektive të përshtatshme.

Sektori agro-ushqimor duhet të veprojë më i organizuar, duke forcuar prodhimin e produkteve tradicionale, duke aplikuar sisteme të çertifikimit të cilësisë dhe duke përdorur metoda të reklamimit dhe promovimit të produkteve.

Të ardhurat e banorëve vendas pritet të rriten, me theksin kryesor drejt sektorit të agroushqimit, i cili duhet të veprojë në mënyrë më të organizuar, duke shtuar prodhimin e produkteve të njobura tradicionale, duke aplikuar sisteme të çertifikimit të cilësisë dhe duke përdorur metoda reklamimi dhe prezantimi të produkteve.

Promovimi i organizimeve kolektive bujqësore (p.sh. kooperativave) do të ndihmonë finansiarisht fermerët e mesëm në shumë mënyra: në sigurimin e lëndës së parë (farave, plehrave, etj.), në rritjen e çmimeve të shitjes, në krijimin e kushteve standarde të kulturave (duke marrë edhe trajnimin e duhur shkencor), në prodhimin e produkteve cilësore, certifikimin e produkteve vendase, duke mundësuar tregimin e produkteve në tregje të mëdha të jashtme pa konkurruar me fermerët e tjera. Gjithashtu, duke krijuar partneritete të forta dhe me infrastrukturën e duhur (objekte magazinimi, ruajtje dhe përpunimi të produkteve bujqësore dhe blegtoriale) do të krijohen kushte për stimulimin e sektorit përkatës të ekonomisë me rezultat të drejtpërdrejtë krijimin e mundësive dhe vendeve të punës në Bashki.

Në sektorin primar bën pjesë edhe prodhimi blegtoral dhe për të cilin propozohet modernizimi i tij.

Në Bashkinë e Pukës sektori i përpunimit është pothuajse jo-ekzistent dhe kryesisht mbështet konsumin e brendshëm të produkteve. Propozohet kombinim i sektorit primar nëpërmjet zhvillimit të infrastrukturës së duhur për përpunimin dhe standardizimin e produkteve vendase cilësore, procese të cilat do të ndihmojnë në njojjen e këtyre produkteve, do të zgjerojë perspektivën profesionale të banorëve përmes prodhimit të produkteve të reja tërheqëse në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe do të kontribuojë në ringjalljen ekonomike të zonës.

Përveç zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë, propozohet ti jepet shtysë agroturizmit i cili lidhet me këta sektorë përmes adoptimit të proceseve standarde të prodhimit (të cilat do të përthihin më shumë interes), ashtu edhe përmes krijimit të infrastrukturës së nevojshme (krijimi i fermave bujqësore ose blegtoriale të pajisura me infrastrukturën e përshtatshme për zhvillimin e agroturizmit). Qëllimi do të jetë përmirësimi i të ardhurave të të punësuarve në këto sektorë, si nga veprimtaritë paralele të turizmit ashtu edhe nga shfrytëzimi i produkteve të tyre, pa i transformuar ato ndërkohë në sipërmarrës turistikë. Krijimi i investimeve të reja prodhuese që shfrytëzojnë burimet në rajon, si dhe përmirësimi dhe modernizimi i atyre ekzistuese për të prodhuar produkte të reja të kërkua nga tregu, do të ringjallë ekonominë vendase dhe do të nxise kërkësen drejt turizmit. Së fundi, trajnimi i vazhdueshëm i të punësuarve përmes krijimit të institucioneve/organizmave të formimit profesional dhe arsimor në sektorin e bujqësisë, do të ofrojë njojuri aktuale profesionale dhe informacion dhe informim bashkëkohor për fermerët në mënyrë që të fitojnë dhe të përmirësojnë aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të përballuar me sukses kërkësat e profesionit bujqësor. Në këtë mënyrë trajnimi do të japë një kontribut të vërtetë në rindërtimin e zonave rurale dhe në zhvillimin e integruar të sektorit bujqësor të ekonomisë.

Forcimi i sektorëve të mësipërm do të bazohet në mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin racional të burimeve natyrore, në mënyrë të veçantë të burimeve ujore, përmes krijimit të rrjeteve të ujitjes dhe mbrojtjes së ujëmbajtësve nëntokësorë nga burimet e ndotjes (mbetjet urbane, mbeturinat nxjerrëse, nga aktivitetet blegtoriale/bujqësore).

Së fundi, bazuar në hartat e PPK-së, zona e Pukës paraqitet një zonë me rezerva minerale bakri dhe jo metalike. Propozohet të ndërmerren veprimet e nevojshme për shfrytëzimin e burimeve minerale dhe minierave aktive përmes menaxhimit nga ana e Bashkisë të përfitimeve përkatëse të tyre.

Për të arritur këtë objektiv strategjik, propozohet adoptimi i veprimeve të nevojshme promovuese, reklamuese në territorin më gjërë. Strategja e zhvillimit të turizmit në Bashki propozohet të bazohet në promovimin e të dhënave specifike vendase nëpërmjet kanaleve të përshtatshme (internetit, materialeve të shtypura, shënimeve, etj.), si edhe në shërbimin e drejtpërdrejtë të qytetarit për gjetjen e informacionit përkatës si për rajonin ashtu edhe për infrastrukturën.

Bazuar në dy objektivat strategjike të mësipërme, rivitalizimi ekonomik i zonës propozohet të mbështetet në forcimin e sektorit të industrisë së turizmit, i cili do të bazohet në mjedisin natyror dhe në aktivitetin prodhues dhe do të jetë "pika" e fortë Bashkisë për fluksin e kapitaleve, shtyrë gjithmonë për një zhvillim të qëndrueshëm përmes respektimit të mjedisit. Për të arritur këto objektiva është i nevojshëm ndërtimi dhe përfundimi i infrastrukturës teknike, për përmirësimin e arritshmërisë së produkteve dhe të njerëzve në selinë e bashkisë, por edhe në qendra më të vogla administrative në gjithë territorin e Bashkisë, si edhe në polet turistike e qendrat urbane rajonale, por edhe të infrastrukturës tjeter në sektorët e ushqimit, kohës së lirë dhe mikpritjes që do të çojnë në një rimëkëmbje të zonës. Në nivel Bashkie, është veçanërisht problematike lëvizja dhe transportimi i njerëzve dhe i produkteve nga zonat e largëta të Bashkisë në ato më qendrore. Në këtë mënyrë, në nivel rajonal, komunikimi i Bashkisë bëhet kryesisht nga qendrat urbane të veriut.

Përveç infrastrukturës së transportit, për të mbështetur aktivitetet e reja profesionale dhe nevojnë në rritje për shërbimet publike, furnizimi me ujë dhe me energji elektrike duhet të mbulojë nevojat e ardhshme të Bashkisë. Në të njëjtën kohë, meqenëse komunikimet telefonike janë kryesisht të bazuara në telefoninë celulare, telefonia fiksë dhe interneti janë gjithashtu prioritetë të rëndësishme për Bashkinë. Në nivel urban dhe jo-urban, është e domosdoshme krijimi ose rindërtimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve, si atyre të transportit, ujit, kullimit dhe vaditjes, ashtu edhe të energjisë elektrike dhe telefonisë. Zhvillimi i infrastrukturës bazohet në sigurinë e qytetarëve dhe mbrojtjen e mjedisit.

### **Objktivi Strategjik 3: Menaxhimi i qëndrueshëm i mjedisit.**

Objktivi strategjik i referohet mbrojtjes dhe përdorimit racional të sistemeve të tokës dhe ujit, mbrojtjes së habitateve dhe ekosistemeve, rrjites dhe shfrytëzimit të peizazheve natyrore dhe monumenteve natyrore (liqene, kanione, burime dhe shpella) në mënyrë që të ruhet mjediseti i pastër natyror, i cili do të jetë një burim i rëndësishëm natyror për mikpritjen e formave të ndryshme alternative të turizmit (ekoturizëm, ngjitje në mal, alpinizëm etj).

Bashkia e Pukës ka peizazhe të cilat ruajnë në një nivel të lartë karakteristikat e tyre të veçanta natyrore dhe ekologjike, me florë e faunë të pasur dhe interesante. Kështu, peizazhi ka vlera të larta ekologjike, estetike dhe shkencore që duhen mbrojtur.

Bazuar në përcaktimet e legjislacionin kombëtar, Bashkia Pukë aktualisht nuk ka Zona të Mbrojtjes Absolute. Megjithatë, me këtë studim u konsiderua e domosdoshme shpallja e disa monumente të mjedisit natyrore me synim për t'i mbrojtur dhe promovuar ato. Kështu, propozohet të shpallen si monumente natyrore Mali i Munellës, si dhe Shpella e Zanave, Shpella e Shqelit dhe Shpella e Kolikës. Këto zona do të menaxhohen me qëllim mbrojtjen e biodiversitetit dhe habitateve të tyre. Për zonat e tjera për të cilat nuk ka status mbrojtjeje, menaxhimi do të synojë mbrojtjen e burimeve natyrore (ujë, tokë, ajër).

Në këtë kontekst, propozohet zhvillimi i zonave me bukuri të veçantë natyrore (toka pyjore, liqene, kanione, lumenj, burime, shpella, etj.) përmes aktivitete të buta ekonomike (turizëm, sporte dhe rekreacion) përreth të cilave do të zhvillohen vetëm infrastrukturat e nevojshme që do t'i shërbejnë këtyre veprimitarive të cilat do të janë në përputhje me peizazhin.

Së fundi, mund të përmendim edhe çështjen e prerjes së pakontrolluar, e cila mund të jetë një aktivitet i madh prodhues i Bashkisë, por në të ardhmen do të degradojë ndjeshëm peizazhin pyjor nëse nuk bëhen paraprakisht përshtatjet e nevojshme. Bashkia është një nga bashkitë më pak të populluara në vend. Ky fakt justifikon ruajtjen e mjedisit natyrore kryesisht të pandryshuar nga ndërhyrjet njerëzore, me veti fiziko-kimike të mira në ujëra, tokë dhe ajër, dhe me nivele të ulëta të zhurmës. Si rrjedhim, duhet të ekzistojnë rregulloret përkatëse mjedisore për mbrojtjen e mjedisit natyrore dhe burimeve të tij, por gjithashtu edhe për përballimin e rreziqeve natyrore dhe teknike që ndikojnë negativisht në cilësinë e tokës dhe mjedisit natyrore në përgjithësi.

#### **Objktivi Strategjik 4: Zhvillimi i komuniteteve të qëndrueshme.**

Me formimin e komuniteteve të qëndrueshme, synohet përmirësimi i cilësinë e jetës së qytetarëve dhe promovimi i identitetit të fortë të Bashkisë (brand name) për turizmin malor, produktet bujqësore cilësore dhe burimet e pasura natyrore në një ambient të pastër natyrore.

Në Bashki ekzistojnë - me përjashtim të qytetit të Pukës - komplekse banimi me qasje të ulët në infrastrukturën bazë sociale, si arsimi dhe kujdesi shëndetësor. Mungesa e vendeve të punës krijon ç'ekuilibra shoqërore, duke hasur dallime të mëdha kryesisht përfemrat. Qëndrueshmëria e komuniteteve të largëta është në rrezik nga mungesa ose mosfunkcionimi i infrastrukturës teknike të tilla si rrugët, furnizimi me ujë dhe kanalizimet, ujitalja, energjia elektrike dhe telekomunikacioni.

Ky objektiv synon përmirësimin e kushteve të jetesës së banorëve si të selisë së bashkisë ashtu edhe të çdo kompleksi banimi, sado larg të jetë ajo nga qendra më e rëndësishme urbane (Pukë) ose qendrat e vogla administrative të banimit të bashkisë



(Gjegjan). Mjaftueshmëria e mallrave, pastërtia dhe higjiena e vendbanimeve, qasja në arsim dhe kujdesin shëndetësor, rritja dhe përmirësimi i produktivitetit, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, restaurimi i hapësirës së përbashkët publike do të çojnë në zhvillimin e komuniteteve të qëndrueshme të cilat do të ruajnë identitetin e tyre dhe ekuivalencën me shtetin.

Përveç kësaj, siç kemi parë dhe më lart, duhet të ketë zhvillim edhe në infrastruktura të tjera teknike. Bashkia duhet të shfrytëzojë sasinë e bollshme të ujit, për shkak të pranisë së burimeve të bollshme natyrore dhe prezencës së një numri të konsiderueshëm digash hidroelektrike, për të përmirësuar nivelin e jetesës së banorëve.

Në kuadër të këtij objektivi, i rëndësishëm është krijimi i mundësive për pjesëmarrje të gjithë qytetarëve në aktivitete ekonomike, përmes informimit dhe formimit profesional të gjithë profesionistëve, përmes kultivimit të bashkëpunimit dhe solidaritetit si të organeve prodhuase, ashtu edhe të gjithë qytetarëve me njëri-tjetrin, për të siguruar zhvillimin ekonomik në bashki me përfitime për të gjithë qytetarët, por edhe promovimin e veprave të nevojshme të infrastrukturës dhe shërbimeve sociale. Kështu, propozohet që të krijohen mundësi të përshtatshme për të gjithë qytetarët që të janë në gjendje të marrin pjesë në aktivitetet ekonomike në rajonin e Bashkisë. Do të duhet të ketë përgjithësia e banorët trajnime dhe informacione të duhura profesionale për teknologjitetë e reja dhe veprimet e mundshme inovative, në mënyrë që ata të janë aktivë në çdo mundësi ekonomike që prezantojnë, por gjithashtu t'u jepet mundësia që vet ata të zhvillojnë këto mundësi. Krahas promovimit të infrastrukturës së duhur, sociale dhe teknike, me synim përmirësimin e cilësisë së jetës dhe kushteve të jetesës të banorëve, kultivimi i ndjenjës së solidaritetit dhe pjesëmarrjes aktive të të gjithë qytetarëve në veprimet e përbashkëta për të trajtuar çdo problem dhe për forcimin e zhvillimit ekonomik të rajonit, është një faktor shumë i rëndësishëm në formësimin e komuniteteve të qëndrueshme dhe natyrisht varet edhe nga faktorë të tjerë që lidhen me edukimin e qytetarëve dhe në mënyrë të veçantë të të rinjve, por edhe nga mentaliteti që kultivohet dhe promovohet.

#### 1.6.3. Parimet dhe politikat kryesore për çdo sistem

Për të arritur objektivat strategjike, që formësojnë strategjinë e zhvillimit dhe vizionin për Bashkinë Pukë, janë përcaktuar disa akse konkrete prioritetesh e politikash, si më poshtë.

**OBJEKTIV STRATEGJIK 1:** Përtëritje ekonomike e rajonit nëpërmjet promovimit të formave alternative të turizmit.

Ky objektiv do të arrihet duke shfrytëzuar bukurinë e veçantë natyrore të malësive dhe pasurinë kulturore të zonës, me qëllim promovimin e formave alternative të turizmit.



**Aksi Prioritar 1:** Shtim i investimeve ndaj Turizmit Alternativ - mbështetje e sipërmarrjes që ka lidhje me aktivitetet e turizmit të kohës së lirë në rajon.

Zhvillimi turistik i rajonit bazohet kryesisht në mjedisin e pasur natyror, në klimën e veçantë dhe pasurinë kulturore të Bashkisë. Politikat dhe ndërhyrjet propozohen si më poshtë:

- Krijimi i infrastrukturës së re të turizmit alternativ, bazuar në resurset njerëzore dhe natyrore që Bashkia disponon (turizmi malor, turizmi sportiv, ekoturizmi etj.).
- Përmirësim, modernizim ose zgjerim i infrastrukturës ekzistuese të turizmit (akomodimi, restorantet, korridore rrugësh dhe monopatesh me shenja, qendra informacioni, shtigje, shtigje për biçikleta, kioska etj.) dhe shërbimet e ofruara (restorantet, mikpritja etj.).
- Përthithja dhe inkurajimi i investimeve në fushën e turizmit sportiv, duke krijuar hotele dhe qendra të përshtatshme trajnuese, në mënyrë që të mikpritet dhe të akomodohen për përgatitjen e sportistëve, të cilët do të mund kenë mundësinë të kalojnë disa fazë të trajnimit dhe përgatitjes së tyre në këtë zonë.
- Përthithja dhe inkurajimi i investimeve në sektorin e turizmit mjekësor për ujërat termale, me krijimin e hotelevë dhe infrastrukturës së përshtatshme shëndetësore, si edhe qasjes së personave me aftësi të kufizuara në zonat që kombinojnë bukurinë natyrore dhe klimën e mirë.
- Përthithja dhe inkurajimi i investimeve në turizmin malor që do të ketë lidhje me sportet alternative si ski, vizita në shpella, alpinizëm, çiklizëm, hipizëm, gjuajtje me hark, kalim kanionesh, rafting, canoe, flzing fox, zipline, parashutizëm etj. me krijimin e shërbimeve të hapësirave akomoduese dhe atyre argëtuese.
- Zhvillimi i agroturizmit, me krijimin e fermave model të vizitueshme të cilat arrijnë ekonomitë e shkallës dhe përshtaten në mënyrë fleksibile ndaj kushteve të tregut dhe kërkesës.
- Krijimi i rrjeteve të rrugëve për ecje në këmbë, shtigjeve për biçikleta dhe monopateve midis zonave të pyllëzuara.
- Përthithja dhe inkurajimi i investimeve në fushën e aktiviteteve sportive (Liqeni i Komanit, Porti i Levrushkut).

**Aksi Prioritar 2:** Forcimi i aktivitetit turistik përmes shfrytëzimit të pasurisë kulturore dhe forcimit të mjedisit urban të Bashkisë.

- Promovimi i përdorimit të butë turistik të burimeve kulturore, qoftë vende arkeologjike ose gjeologjike, ndërtesa historike e tradicionale, kisha, xhami etj.
- Përdorim dhe shfrytëzim i butë turistik i resurseve kulturore, si për rajone arkeologjike ose gjeologjike, ose për ndërtesa historike, apo ndërtesa tradicionale, kisha, xhami etj.
- Krijim i infrastrukturës për muze - panaire për produkte bujqësore, eksposita folklorike dhe të trashëgimisë kulturore.
- Krijim i rrugëve për ecje në këmbë që lidhin monumentet e mirënjohura kulturore me njëri-tjetrin (itenerare këmbësore).

- Zbatimi i programeve të riprojektimit të vendbanimeve dhe lagjeve që pritet të marrin karakter ndërajonal dhe të janë një atraksion turistik ose grumbullojnë infrastrukturën e zhvillimit turistik (hotele, restorante etj.).

#### **Aksi Prioritar 3: Trajnimi i Komunitetit Vendas.**

- Ndërgjegjësimi i komunitetit vendas lidhur me çështjet e zhvillimit të turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit natyror.
- Specializimi dhe trajnimi i burimeve njerëzore në fushën e turizmit malor.
- Trajnimi i grupeve të ndjeshme sociale (gra, minoritete) në lidhje me profesionet që lidhen me turizmin, trashëgiminë kulturore, kulturën dhe traditat e vendit.

#### **Aksi Prioritar 4: Veprime promovimi - reklamimi - prezantimi i produkteve turistike të Bashkisë.**

- Promovimi i produkteve turistike (monumente natyrore, monumente kulturore, etj.) në internet dhe në media të tjera reklamuese-promovuese (fletë të printuara, shenja, aplikime elektronike, aplikacione të GIS etj)
- Zhvillimi i veprimeve të përbashkëta, sinergjisë dhe bashkëpunimit me bashkitë fqinje për promovimin e aktiviteteve turistike dhe përmirësimin e rolit të Bashkisë së Pukës.
- Vendorsje e pika informuese (info-point) për shpërndarjen e broshurave dhe dhënien e informacionit në lidhje me organizimet turistike në zonë, iteneraret e ndryshme dhe pikat e interesit.
- Krijimi i broshurave për atraksionet turistike në gjuhë të ndryshme.
- Informimi i faqes së internetit të Bashkisë lidhur me vendet dhe monumentet kulturore.

#### **OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: Rígjenerimi ekonomik i rajonit përmes zhvillimit të sektorit bujqësor.**

Ky objektiv do të arrihet përmes menaxhimit të integruar të sektorit agro - blegtoral me theks forcimin e aktiviteteve bujqësore në lidhje me prodhimin e produkteve cilësore lokale dhe promovimin e tyre përmes institucioneve përkatëse kolektive dhe paralelisht forcimin e sektorëve të përpunimit dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtoriale. Në të njëjtën kohë, propozohet promovimi i agroturizmit përmes zbatimit të projekteve pilot në lidhje me prodhimin, si dhe krijimi i infrastrukturës së nevojshme mbështetëse.

#### **Aksi prioritar 5: Modernizimi dhe forcimi i prodhimit primar.**

Përforcimi i prodhimit primar përfshin përmirësimin cilësor të procesit të prodhimit dhe produktit final, zvogëlimin e kostove të prodhimit, rritjen e konkurrueshmërisë dhe tregtueshmërinë e produkteve, si dhe rritjen e të ardhurave të gjeneruara. Politikat dhe ndërhyrjet përkatëse janë si më poshtë:



- Specializimi dhe intensifikimi i prodhimit të produkteve bujqësore që konkurrojnë në tregjet e brendshme dhe të jashtme përmes iniciativave të reja të investimeve.
- Kthim tek kulturat alternative organike me bimë që prodhojnë produkte me vlera të larta ushqyese dhe farmaceutike.
- Organizimi i prodhuesve bujqësorë dhe blegtoralë në baza bashkëpunuese dhe biznesi për të mbështetur dhe promovuar prodhimin e tyre, duke kërkuar dhe pretenduar ndihmë financiare, duke shpërndarë njohuri mbi praktikat e prodhimit modern.
- Operimi i formave bashkëpunuese të organizimit të prodhuesve me ekonomi të shkallës dhe përfitime kumulative (zgjidhja e përbashkët e problemeve, etj.).
- Ruajtja dhe rritja e varieteteve lokale (bimë medicinale, fruta pylli, bimë medicinale, etj.).
- Modernizimi i prodhimit të blegtorisë, forcimi i kapitalit blegtoral dhe specializimi i tij, krijimi i zonave të përshtatshme për kullotje dhe kultivim të bimëve për përdorimin e tyre në blegtori dhe menaxhim të qëndrueshëm të mbeturinave nëpërmjet kompostimit me krimba toke.
- Modernizimi i sistemeve të ujitjes, duke respektuar ruajtjen dhe balancimin e burimeve ujore, duke rritur projektet e menaxhimit të ujit, p.sh. duke krijuar rezervuarë të vegjël.
- Promovim i prodhimeve nga bizneset vendase në ekspozita dhe panaire kombëtare e ndërkombëtare, evenete kulturore, ekspozita produktesh etj.
- Zhvillim i fermave organike (krijimi i fermave bujqësore ose blegtorale të pajisura me infrastrukturën përkatëse të turizmit, kohës së lirë, ushqimit, akomodimit) për zhvillimin e agroturizmit bazuar në produktet vendore bujqësore dhe blegtorale.
- Mbështetje dhe trajnim i prodhuesve nga institucionet shkencore e kërkimore (p.sh. eksplorim i kulturave të reja efikase, cilësisë së tokës, përdorimi i qëndrueshëm i ujit, masat për përmirësimin e cilësisë së produktit).
- Ofrim stimujsh, sidomos për fermerët e rinj, me qëllim për të lehtësuar nismat fillestare të tyre dhe përshtatjen struktuore të fermave.
- Rindërtim i mullinjve për të mbështetur njësitë administrative rurale me qëllim funksionimin e qëndrueshmëm të tyre.
- Projekte konsolidimi në parcelat shumë të vogla të shpërndara, përqëndrimin e tyre në të njëjtën zonë dhe bashkimin e parcelave të vogla të shumë pronarëve, në mënyrë që toka e kultivuar të jetë më e shfrytëzueshme.

#### Aksi prioritar 6: Mbrojtje dhe përdorim i qëndrueshëm i tokës bujqësore

- Mbrojtja e tokës bujqësore me planifikim të përshtatshëm për të shhangur lokalizimin e veprimitarive të papërshtatshme rezidenciale, industriale.
- Minimizim i përdorimit të plehrave kimike dhe pesticideve, përdorimi kronik i të cilave ndikon jo vetëm në ndotjen e burimeve ujore, por edhe në uljen e cilësisë së tokës, të cilat bëhen gjithmonë e më pak produktive.
- Menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore nën Boshtin Prioritar 11, për të mbrojtur pjellorinë e tokës.



- Përforcimi i tokës me përmirësues toke që do rezultojnë nga kompostimi natyral ose kompostimi i mbeturinave të kafshëve dhe llumit nga impiantet e trajtimit të ujërave të zeza.

#### **Aksi prioritar 7: Modernizimi dhe nxitje e prodhimit sekondar.**

Forcimi i prodhimit sekondar duhet të përqëndrohet si në trajtimin dhe përpunimin e produkteve primare ashtu edhe në mbështetjen e prodhimit primar, si edhe në zhvillimin e industrive tradicionale në rajon. Në veçanti, propozohet:

- Forcimi i përpunimit të produkteve primare me krijimin e njësive të përpunimit (bimëve medicinale, bimëve aromatike, fruta pylli, gështenjat, arrat, produktet e qumështit, etj), standardizimit dhe paketimit.
- Krijimi i objekteve moderne të therjes për të siguruar cilësinë e mishit dhe, rrjedhimisht, shëndetin e njeriut.
- Zbatimi i standardeve të standardizuara të cilësisë dhe çertifikimi i produkteve të përpunuara në lidhje me origjinën, mënyrën e prodhimit dhe përbërësit e tyre.

#### **OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: Menaxhimi i qëndrueshëm i mjedisit.**

Qëllimi strategjik ka të bëjë me mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional e sistemeve të tokës dhe ujit, me mbrojtjen e habitateve dhe ekosistemeve, promovimin dhe zhvillimin e peizazheve dhe monumenteve natyrore (ligenet, kanionet, burimet dhe shpellat), në mënyrë që të ruhet i pastër mjedisit natyror, i cili do të jetë një burim i rëndësishëm për mbajtjen e një shumëlojshmërie formash alternative të turizmit (ekoturizmit, turizmit për ecje me guidë, natyralistëve, ngjitje në mal, alpinizëm, etj).

#### **Aksi prioritar 8: Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore.**

Politikat dhe projektet që mbështesin mbrojtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore kanë të bëjnë me:

- Përcaktimin e zonave të mbrojtura natyrore (p.sh. Mali i Munellës, Shpella e Zanave, Shpella e Shqelit dhe Shpella e Kolikës si monumente natyrore etj.).
- Mbrojtja e biodiversitetit dhe habitateve nëpërmjet organizimit të duhur hapësinor të aktiviteteve të lejuara.
- Përcaktim i zonave me vlerë të lartë ekologjike dhe estetike për qëllimin e përdorimit të tyre turistik, duke ruajtur cilësinë e tyre të lartë ekologjike.
- Zbatimi i restaurimeve të nevojshme në zonat e privuara, aty ku kërkohet, për shembull, në vende jo të organizuara ku hidhen mbetjet pa kriter.
- Rritje e ndërgjegjësimit mjedorëve, në mënyrë që, fillimisht dhe para së gjithash të kuptojnë nevojën për grumbullimin e organizuar dhe hedhjen e mbeturinave në vende të organizuara (vend-depozitime) dhe në të ardhmen të marrin pjesë në programet e riciklimit të produkteve inerte, plastike, qelqi, metali, letër, por edhe atyre organike komunale të ngurta.
- Bashkëpunim ndërbashkiakë në çështje të menaxhimit të burimeve natyrore, me qëllim që të ketë një menaxhim të integruar dhe të qëndrueshëm, pasi është pranuar

nga të gjithë se mjedisit dhe burimet natyrore nuk ndërpriten apo përshkohen nga kufijtë administrativë.

#### Aksi Prioritar 9: Mbrojtja dhe forcimi i Biodiversitetit.

Për të mbrojtur florën dhe faunën vendase, është e nevojshme të mbrohen habitatet natyrore që ato përbajnë si tokën, ujërat dhe stabiliteti ekologjik. Propozohet:

- Marrja e masave për të adresuar presionet mjedisore të krijuara në veçanti nga aktiviteti njerëzor.
- Përfshirja e ekosistemeve të reja në rrjetin e zonave të mbrojtura ku stehojnë lloje endemike të florës dhe faunës, të rrezikuara në zonë.
- Marrja e masave për mbrojtjen e florës dhe faunës vendase.

#### Aksi prioritar 10: Mbrojtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i ekosistemeve pyjore.

Propozohet:

- Përfundim i plotë dhe zbatim i planeve të menaxhimit të pyjeve në zonat pyjore të mbrojtura (kushte, monitorimi i mbrojtjes etj.)
- Ripyllëzimi - krijimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës pyjore, si dhe mbrojtja nga zjarri.
- Instalimi i sistemeve bashkëkohore të parandalimit të zjarrit me sensorë dhe sistem monitorimi nga Bashkia.
- Marrja e masave për mbrojtjen kundër rreziqeve natyrore (siç është erozioni që ndikon negativisht në rigjenerimin natyror të pyjeve) nëpërmjet punimeve të përshtatshme hidrike të malit (p.sh. hartimi i rrjedhave me bariera mbajtëse).
- Monitorimi i evolucionit të pyjeve me kalimin e kohës përmes imazheve të përshtatshme satelitore dhe sistemeve të informacionit gjeografik (GIS).
- Marrja e masave për mbrojtjen e sipërfaqeve pyjore nga kullotja.

#### Aksi prioritar 11: Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore.

Vlerat ekologjike, estetike dhe ekonomike e liqeneve, lumenjve, burimeve dhe kanioneve tek të cilat shkaktohen probleme të ndotjes kryesishët për shkak të derdhjes së ujërave të zeza urbane dhe mbeturinave industriale, kërkojnë domosdoshmërisht politikat e mëposhtme:

- Trajtimi i qëndrueshëm i ujërave të zeza për vendbanimet me më shumë se 2,000 banorë.
- Ndërtimi i gropave septike për atë pjesë të vendbanimeve që nuk mbulohet nga rrjeti i kanalizimeve.
- Përdorimi racional i burimeve ujore, nga njëra anë, nëpërmjet projekteve të përshtatshme për rikuperimin e tokës për ujitje të kursimit të ujit, dhe nga ana tjetër, përmes aplikimit të praktikave bujqësore që synojnë reduktimin e përdorimit të ujit.
- Ndërtimi i rezervuarëve për ruajtjen e ujit, me qëllim reduktimin e përdorimit të ujit nga burime sipërfaqësore ose nëntokësore.



- Promovimi i praktikave të kultivimit (bujqësia organike) për të ndihmuar në uljen e përdorimit të inputeve (plehrave, pesticideve) dhe ndotjen e ujërave nëntokësore.
- Zhvillimi i bashkëpunimit me bashkitë fqinje dhe Drejtori në Ujërave të Rajonit për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve ujore ndërkunale (lumenjve, liqeneve dhe ujërave nëntokësore) përmes hartimit të një plani dhe programesh të përshtatshme për zbatimin e masave specifike.

#### **Aksi prioritar 12: Sensibilizimi mjedisor i komunitetit vendas.**

Parametër katalistik për mbrojtjen e mjedisit natyror është trajnimi i duhur dhe informimi i popullsisë vendase mbi çështjet e mbrojtjes dhe menaxhimit. Propozohet:

- Krijimi i Qendrave të informimit dhe ndërgjegjësimit mjedisor.
- Zbatimi i programeve të edukimit mjedisor në shkolla, duke filluar me shkollën 9-vjeçare dhe fillore.
- Organizimi i veprimeve për ndërgjegjësimin e qytetarëve për çështje që kanë lidhje me menaxhimin e burimeve ujore, hedhjen e mbeturinave, menaxhimin e ujërave të zeza dhe rreziqeve që krijohen për shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga format e pakontrolluara të ndotjes.

#### **Objektivi strategjik 4: Zhvillimi i komuniteteve të qëndrueshme.**

Me formimin e komuniteteve të qëndrueshme, synohet përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve dhe promovimi i identitetit të fortë të markës së Bashkisë (brand name) për turizmin malor, produktet bujqësore cilësore dhe burimet e pasura natyrore në një ambient të pastër natyror. Për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mirëqenien e komunitetit vendas, prioritet u jepet akseve të mëposhtëm:

#### **Aksi Prioritar 13: Zgjerimi dhe përmirësimi i infrastrukturës sociale në të gjithë vendin sipas nevojës.**


Në veçanti, rekomandohet:

- Ndërtimi i shkollave të reja, objekteve të mirëqenies sociale, qendrave kulturore etj. në varësi të nevojave dhe madhësive të parashikuara të popullsisë.
- Forcimi i zonave të gjelbra urbane, krijimi i rrjeteve të gjelbra, ndërtimi i terreneve sportive, aty ku janë shënuar mungesa.
- Sigurimi i qasjes së pandërprerë në objektet e trajnimit për të gjithë nxënësit.

#### **Aksi Prioritar 14: Përmirësim / modernizim i rrjeteve të shërbimeve urbane në qytet dhe në vendbanimet e tjera, përmirësimi i infrastrukturës teknike mjedisore.**

Nevojitet një qasje e integruar e cila do të optimizojë efikasitetin e rrjetit, do të sigurojë shpërndarje të balancuar dhe do të të zvogëlojë ndikimin në mjedis. Në mënyrë të veçantë, propozohet:

- Projektimi dhe ndërtimi i rrjeteve të furnizimit me ujë për të plotësuar nevojat e tanishme dhe të ardhshme të të gjitha vendbanimet e bashkisë dhe për të siguruar 24 orë furnizim me ujë.
- Projektimi dhe ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve, aty ku është ekonomikisht dhe teknikisht i lejueshëm. Në vendbanimet e zonës së studimit të cilat do të shërbehen nga gropë septicë është thelbësore mirëmbajtja dhe hidroizolimi i duhur.
- Projektimi dhe ndërtimi i veprave për kullimin e ujërave të shiut, në bazë të intensitetit dhe kohëzgjatjes së reshjeve, frekuencën e zgjatjes së një përblyjeje dhe shkallën e mbledhjes së ujërave. Është e nevojshme të merren parasysh fenomenet ekstreme të motit të ndodhura në vitet e fundit, si rezultat i ndryshimeve klimatike globale dhe në rast të munguesës së të dhënave për reshjet, propozohet përdorimi i metodave të pacaktuara (fuzzy logic), me qëllim vlerësimin e mundësisë së mbledhjes së ujërave të shiut.
- Ndërtimi i sistemeve moderne të trajtimit të ujërave të zeza, të përshtatshme për shërbimin e vendbanimeve me popullsi të vogël.
- Veçanërisht, për sa i përket menaxhimit të mbetjeve, janë të nevojshme këto hapa: të mbylljet hendeku midis Plani Kombëtar për Menaxhimin e Mbetjeve në Shqipëri dhe menaxhimit të mbetjeve në nivel bashkiak; kryerjen e studimeve të menaxhimit të mbetjeve në nivel rajonal (për secilin rajon), për shkak se menaxhimi i mbetjeve duhet të janë i decentralizuar por edhe strategjik. Ekzistenza e një landfill-i sanitari për çdo qytet apo bashki nuk cilësohet ekonomikisht e qëndrueshme, për shkak të morfoliqisë terrenit. Një landfill mund të mbulojë disa bashki dhe, nga ana tjetër, menaxhimi i mbetjeve duhet të decentralizohet sepse nuk është ekonomikisht i qëndrueshëm transporti i mbetjeve larg nga burimi i tyre të prodhimit.
- Studimet Rajonale të Menaxhimi të Mbetjeve do të vlerësojnë sasitë e prodhimit të mbeturinave nga të dhëna të besueshme dhe do të zbatojnë objektivat strategjike të Planit Kombëtar të Mbetjeve për landfill-et, riciklimin dhe kompostimin. Për këtë arsy, do të përcaktojnë numrin dhe vendndodhjen e landfill-eve të nevojshme që do të ndërtohen dhe do të përcaktojë objektivat për parandalimin e mbetjeve, minimizimin e mbetjeve, riciklimin dhe kompostimin e tyre. Është theksuar se bashkitë duhet të bashkëpunojnë në procesin e Studimit Rajonal të Menaxhimit të Mbetjeve për disa arsy: ky studim rajonal duhet të pranohet nga shoqëria, duke mbuluar në mënyrë të qëndrueshme nevojat e të gjitha qyteteve për administrimin e mbetjeve; dhe studimi rajonal do të zbatohet duke ndërtuar të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të mirën e bashkive dhe komuniteteve vendase. Prandaj, është propozuar një ndryshim i bazës ligjore në mënyrë që bashkitë të mund të formojnë ndërmarrjet bashkiakë për menaxhimin e mbetjeve në nivel vendor.
- Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe vetëdijes mjedisore, në mënyrë që të bëjë qytetarët të marrin pjesë në programet e riciklimit të produkteve plastike, të qelqit, metalit, letrës dhe mbetjeve të ndërtimit, si dhe mbeturinave organike



urbane (biosolide), me qëllim për të minimizuar mbetjet që do të hidhen në landfill-in e ardhshëm.

- Përmirësim/modernizim i rrjetit energjetik.
- Përmirësim/modernizim i rrjetit të telekomunikacioneve.

#### **Aksi prioritar 15: Përmirësimi / modernizimi i infrastrukturës dhe sistemeve të transportit.**

Lëvizje e qëndrueshme do të thotë transport pasagjerësh dhe mallrash të shpejtë, të sigurt dhe efikas, përbushjen e të gjitha nevojave të transportit, zvogëlimin e izolimit të vendbanimeve të largëta dhe minimizimin e kostove të jashtme (rreziqe mjedisore, aksidente, etj). Konsiderohen të nevojshme:

- Modernizimi i rrjetit rrugor kryesor përmes asfaltimit, ndërtimit, përmirësimit të karakteristikave gjeometrike dhe mirëmbajtjes.
- Ndërtimi i seksioneve të reja të rrugëve për qasje të lehtë në dhe nga vendbanimet më të largëta të bashkisë.
- Ndërtimi dhe përmirësimi i infrastrukturave rrugore që shërbejnë për lidhjen e njësive veriore të banimit me selinë e Bashkisë.

#### **Aksi prioritar 16: Mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit të banimit/ndërtimit.**

- Përmirësimi estetik i ndërtesave ose nëpërmjet homogenitetit ose restaurimit të hapësirave dhe ndërtesave të braktisura.
- Ruajtja e një ambienti të pastër urban me menaxhim të duhur të mbeturinave (nga furnizimi dhe asgjësimi i kazanëve deri tek asgjësimi i tyre përfundimtar).
- Zbatimi i programeve të rigjenerimit në lagjet/seksionet me veçori të veçanta.
- Promovimi i mobilitetit urban të qëndrueshëm (shëtitoret e këmbësorëve, shtigjet e bicikletave, infrastruktura për personat me aftësi të kufizuara etj.).
- Restaurimi i hapësirave të lira.

#### **Aksi prioritar 17: E-qeverisja dhe përmirësimi i infrastrukturës elektronike.**

E-qeveria i referohet futjes së teknologjisë së informacionit në administratën publike me qëllim që korresponanca, menaxhimi dhe arkivimi i dokumenteve të bëhet tashmë në mënyrë elektronike. Nëpërmjet këtij procesi, synohen të minimizohen kostot e dërgimit dhe pranimit të shkresave ndërmjet organeve qeveritare, dhe si rrjedhim të luftohet burokracia, të rritet transparenca, ndërkohë që qytetarët dhe bizneset do të shërbehen në mënyrë më të shpejtë e të plotë, sidomos vendbanimet e largëta. Për këtë qëllim, është propozuar:

- Të zhvillohet infrastruktura për lidhjen e përgjithshme me linjat e internetit dhe telefonisë fiskse, për të gjitha vendbanimet e Bashkisë.
- Të forcohet infrastruktura materialo-teknike në lidhje me shërbimet e Bashkisë dhe të Prefekturës.
- Të krijohet logjistika e përshtatshme për tu realizuar qeverisja elektronike.
- Trajnim i stafit të Bashkisë për përdorimin e software-it të ri.

- Të krijohet, në çdo qendër të ish-komunave një zyrë bashkiakë për shërbimin e gjithë qytetarëve, edhe të atyre në zonat më të largëta, të cilët do të kenë akses në sistemet e qeverisjes elektronike, pavarësisht nga mosha e tyre dhe niveli arsimor.

#### 1.6.4. Parashikime demografike

Në këtë pjesë paraqesim të dhënat e popullsisë për Bashkinë Pukë, për periudhën nga viti 2001 deri në vitin 2011 (regjistrimi i fundit). Në veçanti, tabelat e mëposhtme tregojnë ndryshimet në numrin e popullsisë gjatë kalimit të kohës, të cilat konfirmojnë një rënie të madhe të popullsisë, siç paraqiten në figurat 1 dhe 2 më poshtë. Nga të dhënat e tabelave, por dhe nga pamjet grafike dallohet në mënyrë karakteristike prirja e dallueshme e rëties së popullsisë për të gjithë bashkinë Pukë dhe rajonin përreth. Kjo ulje drastike e popullsisë shpjegoitet me problemet akute në ekonomi, mungesa e infrastrukturës së përshtatshme dhe e fondeve për investime si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel bashkie, fakte që kontribuan në rritjen e normës së migrimit dhe emigrimit të qytetarëve drejt vendeve fqinje apo drejt qendrave kryesore urbane të vendit në kërkim të kushteve më të mira të jetesës dhe gjetjes së vendeve të punës.

Më konkretisht, Tabela 1.6.4.1 tregon një rënie të madhe të popullsisë në bashkinë e Pukës, si dhe në njësitë administrative përbërëse, në vitin 2011 krahasuar me vitin 2001.

Bashkia e Pukës regjistroi një rënie prej -43.35% në regjistrimin e popullsisë të vitit 2011 në krahasim me regjistrimin e vitit 2001. Për sa i përket njësive bashkiake, Qerreti ka shënuar rënien më të madhe të popullsisë në krahasim me njësitë e tjera bashkiake të Bashkisë së Pukës, në shifrën e -60.96%, pasuar me Gjegjanin i cili ka shënuar një reduktim me -51.10%, me pas Rrapë me -45.79%, Qelëz me -36.90%, dhe Pukë me -21.38%. Për sa i përket Qarkut të Shkodrës, në të cilin përfshihet kjo Bashki, vihet re një rënie prej -11.86%. Si rrjedhim, është e qartë se Bashkia e Pukës ka regjistruar një shkallë më të lartë ndryshimi nga ajo e Qarkut të Shkodrës me 31.49%.

Sipas të dhënavëve të INSTAT, për sa i përket parashikimeve për popullsinë në një thelli si prej 20 vjetësh, shumica e qarqeve parashikohet të përballen me një rënie të niveleve të lindjeve. Së bashku me rritjen e vdekjeve në të gjithë Shqipërinë, pritet të përballet me një rënie natyrore të popullsisë në të ardhmen.

Në rajonin e Shkodrës, pavarësisht nivelit të mirë të shtimit natyror, reduktimi i vazhdueshëm i popullsisë parashikohet se ka ndodhur për shkak të migrimit apo emigrimit (dominimi i njërit faktor apo tjetrin varet nga supozimet në lidhje me shkallën e migrimit dhe vendet e reja preferuara).



Njësi administrative	Census 2001	Census 2011	Ndryshimi (%) 2001-2011
GJEGJAN	5,820	2,846	-51,10
PUKË	4,588	3,607	-21,38
QELËZ	2,791	1,761	-36,90
QERRET	3,837	1,498	-60,96
RRAPË	2,503	1,357	-45,79
Bashkia PUKË	19,539	11,069	-43,35
Qarku SHKODËR	255,898	225,548	-11,86

Tabela 1.6.4.1. Ndryshime të popullsisë së Bashkisë Pukë (2001 & 2011) (Burimi: INSTAT)




Figura 1.6.4.1: Zhvillimi i popullsisë së Bashkisë Pukë (2001 & 2011) (burimi: INSTAT)




Figura 1.6.4.2: Zhvillimi i popullsisë në njësitë administrative të Bashkisë Pukë (burimi: INSTAT)



Sipas INSTAT-it, ulja e normës së migrimit ndërkontrolluar për vetëm 1/3 në të gjitha rajonet, nga 1990 në 2031, e kombinuar me një rënje të butë të fertilitetit, çon në një reduktim të popullsisë deri në 40% në shumicën e rajoneve.

Më poshtë paraqitet një tabelë në nivel rajonal për Lezhën, ku përfshihet edhe bashkia që po studiohet, me evoluimin e popullsisë në një thellësi prej 20 vjetësh përmes tre (3) skenarëve.

	2011	Skenari 2031					
		high - conc.	high - deconc.	constant - conc.	constant - deconc.	low - conc.	low - deconc.
		MMMH C	MMMH D	MMMC C	MMMC D	MMML C	MMML D
Totali i popullsisë	225.548	185.120	200.076	188.816	200.102	192.356	199.569
Raporti i popullsisë 2031 me popullsinë 2011		0,82	0,89	0,84	0,89	0,85	0,88
% Popullsia e Shqipërisë	8	7	7	7	7	7	7

Tabela 1.6.4.2: Parashikime të popullsisë në thellësi të 20 vjeçarit për Qarku Shkodër (burimi: INSTAT)

Shënim:

HC = migrimi i brendshëm i lartë dhe i përgendruar në hapësirë,

HD = migrimi i brendshëm i larië dhe i dekoncentruar në hapësirë,

CC = migrimi i brendshëm konstant dhe i përgendruar në hapësirë,

LC = migrimi i brendshëm i ulët dhe i përgendruar në hapësirë

LD = migrimi i brendshëm i ulët dhe i dekoncentruar në hapësirë

Sipas tabelës së mësipërme, Qarku i Shkodrës mund të ballafaqohet me rënje të popullsisë prej 11.52% në 14.72% në skenarin optimist, nga 11.28% në 16.29% në skenarin e mesëm dhe 11.29% në 17, 92% në skenarin e pafavorshëm.

Përkundër faktit se si në rajon ashtu edhe në bashkinë nën studim, regjistrohet një rënje e popullsisë gjatë viteve (sipas të dhënave të INSTAT-it), konsiderohet e nevojshme të merret parasysh mundësia e rritjes së vogël dhe graduale e popullsisë dhe në thelb të simulohet skenari më i keq.

Për simulimin e skenarit më të keq, fillimisht u krye reduktim i të dhënave të popullsisë, me qëllim për të simluar shifrat e popullsisë në vitin aktual (2017), duke marrë parasysh dy versionet A dhe B.

- Në Versionin A, u krye vlerësimi i popullsisë, duke marrë parasysh ndërtuesat. Në veçanti, u regjistrua numri i ndërtueseve të banuara, në territorin e bashkisë, për ish njësitë bashkiakë. Numri i ndërtueseve u shumëzua me numrin e personave për familje (sipas të dhënave të INSTAT-it për Njësi Bashkiakë). Banesat kolektive (ndërtesa me më shumë se 2 kate) janë llogaritur veçmas për qytetin, në mënyrë që të ketë më shumë saktësë përllogaritja.
- Në Versionin B, popullsia u vlerësua duke marrë parasysh nxënësit. Kështu, në bazë të të dhënave të analizës (faza A), u regjistruan nxënësit e shkollave nëntë

vjepare të Bashkisë, sipas njësive bashkiake. U supozua se këta nxënës përbëjnë 10% të popullsisë dhe për rrjedhojë o përllogarit popullsia për çdo Njësi bashkiake.

Versionet A dhe B janë përdorur për shkak se të dhënat e regjistrimit të INSTAT ndryshojnë nga të dhënat e regjistrat civil dhe me qëllim për të pasur një qasje më realiste bazuar në të dhënat e analizës. Në vazhdim të sa më sipër, tabelat e mëposhtme tregojnë shifrat e popullsisë, pas reduktimit të tyre, për vitin referues 2017.

Njësitë administrative	Versionin A	Versionin B
	Popullsia 2017	Popullsia 2017
<b>GJEGJAN</b>	3,386	2,260
<b>PUKË</b>	3,385	4,030
<b>QELËZ</b>	3,078	820
<b>QERRET</b>	2,779	2,860
<b>RRAPË</b>	2,021	2,230
<b>Bashkia PUKË</b>	<b>14,649</b>	<b>12,200</b>

Tabela 1.6.4.4: Të dhëna të popullsisë për bashkinë Pukë, bazuar në versionin A dhe B, viti 2017

Për të simluar skenarin më të keq, duke marrë parasysh si vit reference 2017, u përdor formula e interesit kompleks për parashikimin e evolucionit të popullsisë në të ardhmen. Mbulimi i skenarit më të keq konsiderohet i nevojshëm, pasi zhvillimi i popullsisë do të përcaktojë nevojat e tanishme dhe të ardhshme për strehim. Si rrjedhim, parashikimi për një kërkesë më të lartë në të ardhmen do të mbulojë një kërkesë të vogël të mundshme, ndërsa e kundërtë nuk mund të ndodhë pasi do të shkaktojë probleme serioze.

Duke kombinuar rezultatet e metodës së komponentëve kryesore për projekzionet e popullsisë që treguan ulje të popullsisë (sipas të dhënave të INSTAT) dhe dëshirën për mbulimin e skenarit më të keq parashikohet një rritje vjetore prej +0.5% për njësitë më të vogla bashkiake. Përashtim përbëjnë njësitë administrative për të cilat arrihet një normë rritjeje më e lartë të barabartë me +1.0%. Kjo i atribuohet faktit se këto Njësi Bashkiake kanë popullsi më të madhe dhe diferencohen ekonomikisht dhe shoqërisht në raport me të tjera, pasi janë qendrat ekonomike të bashkisë nën studim. Më konkretisht, grumbullojnë përdorime të ndryshme dhe aktivitete ekonomike (punëtori profesional, dyqane zanatçinjsh, dyqane, ofrim shërbimesh etj.) krahasuar me njësitë administrative të tjera që kanë kryesisht karakter rural.

Formula e interesit kompleks është dhënë nga ekuacioni matematikor në vijim:



$$E_v = E_o \cdot (1 + \rho)^v$$

Ku:

$E_v$ : popullsia e parashikuar

$E_o$ : popullsia e vlerësuar bazuar në dy versionet A dhe B

$\rho$ : rritja vjetore e popullsisë

$v$ : vitet për të cilat do të kryhet parashikimi

Referohet se parashikimet e projeksioneve të popullsisë bëhen çdo pesë vjet duke filluar nga viti bazë 2017, pas trajtimit të të dhënave të popullsisë në bazë të versioneve A dhe B, me parashikimin e parë për vitin 2022 dhe më pas në një shtrirje prej 15 vjetësh, dmth deri në vitin 2032. Si rrjedhim parashikimi i popullsisë sipas tipit të interesit kompleks do të realizohet bazuar në vitin referencë 2017 (gjendja aktuale) fillimisht për vitin 2022 (faza A) dhe më pas në thellësi prej 15 vjetësh 2032 (Faza B).

Nga tabela 1.6.4.4 e këtij seksioni janë marrë vlerat e popullsisë së Njësisë Bashkiake, që përbëjnë zonën e studimit për vitin bazë 2017. Më poshtë paraqiten analitikisht përllogaritjet për bashkinë nënstudim. Nga zbatimi i formulës së interesit kompleks rezulton:

### Versioni A

#### Njësia Administrative Gjegjan

$E_o = 3.386$  banorë

$\rho = 0,5\%$

$v_1 = 2022-2017 = 5$  (faza A')

$v_2 = 2032-2017 = 15$  (faza B')

$$E_{2022} = 3.386 \cdot \left(1 + \frac{0,5}{100}\right)^5 = 3.471,50 \approx 3.472$$

$$E_{2032} = 3.386 \cdot \left(1 + \frac{0,5}{100}\right)^{15} = 3.741,18 \approx 3.741$$

#### Njësia Administrative Pukë

$E_o = 3.385$  banorë

$\rho = 1,0\%$

$v_1 = 2022-2017 = 5$  (faza A')

$v_2 = 2032-2017 = 15$  (faza B')



$$E_{2022} = 3.385 \cdot \left(1 + \frac{1.0}{100}\right)^5 = 3.557,67 \approx 3.558$$

$$E_{2032} = 3.385 \cdot \left(1 + \frac{1.0}{100}\right)^{15} = 4.130,34 \approx 4.130$$

### Njësia Administrative Qelëz

$E_0 = 3.078$  banorë

$\rho = 0,5\%$

$v_1 = 2022-2017 = 5$  (faza A')

$v_2 = 2032-2017 = 15$  (faza B')

$$E_{2022} = 3.078 \cdot \left(1 + \frac{0.5}{100}\right)^5 = 3.155,72 \approx 3.156$$

$$E_{2032} = 3.078 \cdot \left(1 + \frac{0.5}{100}\right)^{15} = 3.400,87 \approx 3.401$$

### Njësia Administrative Qerret

$E_0 = 2.779$  banorë

$\rho = 0,5\%$

$v_1 = 2022-2017 = 5$  (faza A')

$v_2 = 2032-2017 = 15$  (faza B')

$$E_{2022} = 2.779 \cdot \left(1 + \frac{0.5}{100}\right)^5 = 2.849,17 \approx 2.849$$

$$E_{2032} = 2.779 \cdot \left(1 + \frac{0.5}{100}\right)^{15} = 3.070,50 \approx 3.071$$

### Njësia Administrative Rrapë

$E_0 = 2.021$  banorë

$\rho = 0,5\%$

$v_1 = 2022-2017 = 5$  (faza A')

$v_2 = 2032-2017 = 15$  (faza B')

$$E_{2022} = 2.021 \cdot \left(1 + \frac{0.5}{100}\right)^5 = 2.072,03 \approx 2.072$$

$$E_{2032} = 2.021 \cdot \left(1 + \frac{0.5}{100}\right)^{15} = 2.232,99 \approx 2.233$$



E njëjtë procedurë ndiqet për gjetjen e popullsisë edhe për versionin B. Rezultatet e parashikimit të popullsisë së njësive administrative nga zbatimi i formulës komplekse janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Njësitë administrative	Popullsia 2017	Parashikimi 2022	Parashikimi 2032	Rritja vjetore e popullsisë (%)
<b>Versionin A</b>				
<b>GJEGJAN</b>	3,386	3,472	3,741	0.5%
<b>PUKË</b>	3,385	3,558	4,130	1.0%
<b>QELËZ</b>	3,078	3,156	3,401	0.5%
<b>QERRET</b>	2,779	2,849	3,071	0.5%
<b>RRAPË</b>	2,021	2,072	2,233	0.5%
<b>Bashkia PUKË</b>	<b>14,649</b>	<b>15,106</b>	<b>16,576</b>	
<b>Versionin B</b>				
<b>GJEGJAN</b>	2,260	2,317	2,497	0.5%
<b>PUKË</b>	4,030	4,236	4,917	1.0%
<b>QELËZ</b>	820	841	906	0.5%
<b>QERRET</b>	2,860	2,932	3,160	0.5%
<b>RRAPË</b>	2,230	2,286	2,464	0.5%
<b>Bashkia PUKË</b>	<b>12,200</b>	<b>12,612</b>	<b>13,944</b>	

Tabela 1.6.4.5: Parashikimi i popullsisë për Bashkinë e Pukës sipas tipit të interesit kompleks

p: rritja vjetore e popullsisë (0.5% dhe 1%)

Kështu vërejmë se ka dy parashikime të popullsisë për vitin 2032, me versionin A popullsia do të arrijë në 16,576 persona dhe me versionin B popullsia e bashkisë do të jetë 13,944 banorë. Për shkak se ekziston një diferencë në mes të dy skenarëve, ne llogarisim mesataren e dy rezultateve. Kështu, për vitin 2032 për bashkinë e Pukës, propozohet që të krijohet një infrastrukturë sociale për një popullsi prej 15,260 banorësh.

## 1.6.5. Rezervat e strehimit

Në këtë kapitull trajtohet gjendja aktuale e banimeve në Bashkinë Pukë dhe në njësitë administrative përbërëse. Fillimisht është bërë një analizë e stokut të banesave në Bashkinë e Pukës dhe janë identifikuar nevojat e ardhshme për strehim, sipas parashikimeve të rritjes të popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh ashtu siç është bërë në pjesën e mëparshme.

Për shkak të mungesës së të dhënave për situatën e strehimit në Bashkinë Pukë, për vitin 2017, janë presupozuar të sakta të dhënat e inventarit të studimit të INSTAT-it për vitin 2011 (popullsia dhe strehimi) për analizimin e mëtejshëm të stokut të banesave. Më konkretisht:



- Përsa i përket godinave të banimit, konsiderohet se në tërësi stoku i banesave mbetet i qëndrueshëm nga viti 2011 deri në vitin 2017.
- Përsa i përket përqindjes të anëtarëve për familje, konsiderohet të jetë e qëndrueshme nga viti 2011 deri në vitin 2017.

Në vazhdim të supozimeve te mësipërmë vazhdojmë me analizën e stokut të banesave.

Bazuar në të dhënat e analizës, 42.84% e të gjitha banesave janë të pabanuara. Më konkretisht, në Njësitë Administrative Qerret gjenden pjesa më e madhe e banesave të pabanuara prej 62.22%, e ndjekur nga Qelëz me 52.39%, Rrapë me 49.65%, Gjegjan me 44.28% dhe Pukë me 17.07%.

	Statusi i banimit të banesës			
	Gjithsej	Banesë e banuar nga persona me vendbanim të zakonshëm	Banesë e destinuar për qëllime dytësore apo sezonale	Banesë e pabanuar ose e banuar nga persona që nuk përfshihen në census
<b>Bashkia PUKË</b>	4,197	2,376	41	1,780
<b>PUKË</b>	1,055	866	16	173
<b>GJEGJAN</b>	1,040	579	5	456
<b>RRAPË</b>	570	287	9	274
<b>QELËZ</b>	670	319	2	349
<b>QERRET</b>	862	325	9	528

Tabela 1.6.5.1: Banesat e zakonshme sipas statusit të banimit (burimi: INSTAT)

Në Bashkinë Pukë nga 4.197 banesa (konvencionale) të listuara: 2.376 banesa janë kryesore, 41 janë dytesore ose sezonale, ndërsa 1780 banesa janë bosh. Më konkretisht, në Gjegjan nga 1,040 banesa të regjistruara, 579 banesa janë kryesore, 5 banesa janë dytësore ose sezonale, ndërsa 456 banesa janë bosh. Në Pukë nga 1.055 banesa të regjistruara 866 banesa janë kryesore, 16 banesa janë dytësore ose sezonale, ndërsa 173 janë bosh. Në Qelëz nga 670 banesa të regjistruara 319 banesa janë kryesore, 2 banesa janë dytësore ose sezonale, ndërsa 349 janë bosh. Në Qerret nga 862 banesa të regjistruara 325 banesa janë kryesore, 9 banesa janë dytësore ose sezonale, ndërsa 528 janë bosh. Në Rrapë nga 570 banesa të regjistruara 287 banesa janë kryesore, 9 banesa janë dytësore ose sezonale, ndërsa 274 janë bosh.

Numri i madh i banesave të zbrazëta në Bashkinë Pukë vjen ndoshta për shkak të faktit se një pjesë e madhe e popullsisë në dekadat e fundit është zhvendosur në qendrat e mëdha urbane të vendit dhe jashtë vendit, në kërkim të kushteve më të mira të jetesës.

Në lidhje me ekonomitë familjare, pas analizës së kryer gjatë fazës së parë të studimit, vërehet se në shumicën dërmuese të njësive ekonomike familjare jeton një familje e vetme. Më konkretisht, në bashkinë Pukë, 83.28% (2,056) e njësive ekonomike

familjare përbëhen nga një bërthamë familjare, pasuar nga njësitë ekonomike familjare me dy (2) ose më shumë bërthama me një përqindje prej 8.47% (209). Përkatësisht, e njëjtë situatë vërehet edhe në Njësitë Administrative të saj.

	Lloji i NjEF-së				
	Gjithsej	NjEF-të pa bërthamë familjare	NjEF-të me një bërthamë familjare	NjEF-të me dy ose më shumë bërthama familjare	NjEF-të me bërthamë jo të vlefshme
<b>GJEGJAN</b>	2846	124	2274	324	124
<b>PUKË</b>	3603	77	3176	340	10
<b>QELËZ</b>	1761	46	1327	293	95
<b>QERRET</b>	1498	20	1224	229	25
<b>RRAPË</b>	1357	41	1124	129	63

Tabela 1.6.5.2: Numri i anëtarëve dhe lloji i NjEF (Burimi: INSTAT)

Nga tabelat e mësipërme rezultojnë raportet e popullsisë dhe banesave në bashkinë Pukë dhe Njësitë Administrative përbërëse, si dhe raporti i popullsisë sipas llojit të njësitë ekonomike familjare. Bashkisë Pukë i korrespondojnë 2.60 banorë për banesë, ndërsa çdo njësie ekonomike familjare i korrespondojnë 4.55 banorë. Më konkretisht, për Gjegjanin korrespondojnë 2.73 banorë për banesë dhe 4.91 për familje, Pukë 3.26 banorë për banesë dhe 3.92 për familje, Qelëz 2.63 banorë për banesë dhe 5.52 për familje, Qerret 1.74 banorë për banesë dhe 4.60 për familje, dhe në fund Rrapë 2.38 banorë për banesë dhe 4.73 për familje. Në të gjitha Njësitë Administrative duket se ka banesa të mjaftueshme për të plotësuar nevojat për strehim. Megjithatë duhet të merret parasysh, banimi i dy ose më shumë familjeve në një njësi ekonomike familjare, ndoshta për shkak të kushteve të vështira ekonomike, pasi në rastin e rimëkëmbjes të ekonomisë, shumë familje kërkojnë banesë të pavarur.

## RESULTATET KRAHASUESE TË POPULLSISË - STREHIMIT

Kjo pjesë paraqet rezultatet krahasuese bazuar në skenarët e analizuar më sipër, në lidhje me zhvillimin e popullsisë dhe gjendjen e strehimit në Bashkinë Pukë. Përveç kësaj, norma vjetore e rritjes së popullsisë llogaritet në mënyrë që të mbulojë mjaftueshmërinë e banesave në një periudhë prej 15 vjetësh nga viti bazë që është viti 2017. Përsë i përket situatës të strehimit, siç u përmend më lart, janë marrë parasysh të dhënat e përfituar nga inventari i studimit të INSTAT 2011 pasi nuk ka të dhëna për vitin 2017. Raportohet gjithashtu se për nevojat e analizës si më poshtë u trajtuan të dhënat e popullsisë në raport me përqindjen e anëtarëve për njësi ekonomike familjare në mënyrë që të rezultojë përafërsisht numri i njësive ekonomike familjare për vitin 2017.



Për gjetjen e popullsisë për mbulimin e nevojave të strehmit në bashkinë e studimit, u përdorën 2 (dy) skenarë të ndryshimit të popullsisë (p). Skenari i parë ndjek modelin e evolucionit të popullsisë INSTAT, me një rënie të popullsisë prej -0.5%, ndërsa skenari i dytë është skenari më i keq me rritjen vjetore të popullsisë prej 0.5%, 0.8% ose 1%. Tabelat e mëposhtme tregojnë rezultatet krahasuese të popullsisë-strehimit, sipas skenarëve të përmendur më lartë për bashkinë e studimit dhe Njësitë Administrative që e përbëjnë atë, bazuar në Versionet A dhe B, analizuar më parë.

### Versioni A

	2011	Skenari 2031					
		high - conc.	high - deconc.	constant - conc.	constant - deconc.	low - conc.	low - deconc.
		MMMHC	MMMHD	MMMC	MMMC	MMMLC	MMMLD
<b>Totali Popullsia e përgjithshme</b>	225.548	185.120	200.076	188.816	200.102	192.356	199.569
<b>Të gjitha banesat</b>				70.397			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,20	2,63	2,84	2,68	2,84	2,73	2,83
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF				4,00			
<b>Totali i NjEF-së</b>	54.429	46.280	50.019	47.204	50.026	48.089	49.892
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	0,77	0,66	0,71	0,67	0,71	0,68	0,71
<b>Bashkia PUKË</b>							
	2017	Projekcion 2022		Projekcion 2032		p	
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me -0.5)</b>	14.649	14.286		13.588		-0.5%	
<b>Të gjitha banesat</b>		4.251					
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,45	3,36		3,20			
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		4,48					
<b>Totali i NjEF-së</b>	3.270	3.189		3.033			
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	0,77	0,75		0,71			
<b>Bashkia PUKË</b>							
	2017	Projekcion 2022		Projekcion 2032		p	
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0.5)</b>	14.649	15.019		15.787		0,5%	
<b>Të gjitha banesat</b>		4.251					
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,45	3,53		3,71			
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		4,48					
<b>Totali i NjEF-së</b>	3.270	3.352		3.524			
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	0,77	0,79		0,83			
<b>Bashkia PUKË</b>							
	2017	Projekcion 2022		Projekcion 2032		p	
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0.5)</b>	14.649	16.008		19.115		1,79%	



Të gjitha banesat	4.251			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3.45	3.77	4.50	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		4.48		
Totali i NjEF-së	3.270	3.573	4.267	
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	0,77	0,84	1,00	

*Tabela 1.6.5.3: Rezultatet krahasuese të popullsisë -banesave me përqindje ndryshimi të popullsisë (-0.5% dhe 0.5%), gjetja e popullsisë për të mbuluar strehimin për bashkinë Pukë, versioni A*

Tabela 1.6.5.3 paraqet të dhëna për Pukën në nivel qarku dhe bashkie. Në nivel qarku (Shkodër), sipas studimit të INSTAT, popullsia mund të ulet nga 11,28% deri 17,92%. Duke pasur parasysh mjaftueshmërinë e strehimit ekzistues, vlerësohet se në vitin 2011 kemi një raport 1(një) banesë për 3.08 banorë, ndërsa për një periudhë 20 vjeçare ky raport parashikohet të arrijë nga 2,84 deri në 2,63 banorë për banesë. Kjo do të thotë se do të ketë një rritje të banesave bosh në të gjithë qarkun.

Përveç kësaj, në bazë të mesatares të anëtarëve për familje (4,00 banorë / njësi ekonomike familjare), llogaritet evolucioni i njësive ekonomike familjare dhe rrjedhimisht raporti ndërmjet banesave dhe njësive ekonomike familjare në një periudhë prej 20 vjetësh. Tabela tregon se në vitin 2011, rreth 77% e banesave në qark përdoreshin për qëllime banimi. Kjo përqindje mund të arrijë nga 71% deri në 66% në 20 vjet, duke shënuar një rënje prej -6% dhe -11% respektivisht.

Më konkretisht, në lidhje me bashkinë Pukë, u krijuan dy skenarë. Skenari i parë ndjek modelin e rritjes të popullsisë sipas studimit të INSTAT-it, me një normë të reduktimit të popullsisë prej -0.5%, ndërsa skenari i dytë është skenari më i keq në të cilin parashikohet rritja vjetore e popullsisë prej 0.5%, 0.8% ose 1%. Duke simluar modelin e zhvillimit të popullsisë në nivel bashkie, u konstatua se përqindja e banesave që përdoren sot është 77% dhe mund të reduktohet në 71%, duke shënuar një ndryshim prej -6% në 15 vjet. Përkundrazi, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përqindja e përdorimit të banesave pritet të rritet nga 77% në 83%, duke shënuar një rritje prej 6%.

Megjithëse, sipas skenarit më të keq, vërehet një rritje e përdorimit te banesave, ekziston një përqindje baneshash prej 17%, që mbeten e pashfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 1,79% për bashkinë Pukë.

Në përputhje me modelin e mësipërm, janë bërë llogaritjet për Njësitë Administrative që përbëjnë bashkinë Pukë. Tabelat e mëposhtme tregojnë përqindjen e ritmit të ndryshimit të popullsisë që kërkohet për të mbuluar banesat, për Njësitë Administrative që përbëjnë bashkinë Pukë sipas versionit A.



<b>GJEGJAN</b>				
	<b>2017</b>	<b>Projekcion 2022</b>	<b>Projekcion 2032</b>	<b>p</b>
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0.5)</b>	3.386	3.880	5.094	<b>2,76%</b>
Të gjitha banesat		1.041		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,25	3,73	4,89	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		4,91		
Totali i NjEF-së	690	790	1.037	
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	<b>0,66</b>	<b>0,76</b>	<b>1,00</b>	
<b>PUKË</b>				
	<b>2017</b>	<b>Projekcion 2022</b>	<b>Projekcion 2032</b>	<b>p</b>
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0.5)</b>	3.385	3.677	4.340	<b>1,67%</b>
Të gjitha banesat		1.107		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,06	3,32	3,92	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		3,92		
Totali i NjEF-së	864	938	1.107	
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	<b>0,78</b>	<b>0,85</b>	<b>1,00</b>	
<b>QELEZ</b>				
	<b>2017</b>	<b>Projekcion 2022</b>	<b>Projekcion 2032</b>	<b>p</b>
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0.5)</b>	3.078	3.272	3.697	<b>1,23%</b>
Të gjitha banesat		670		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	4,59	4,88	5,52	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		5,52		
Totali i NjEF-së	558	593	670	
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	<b>0,83</b>	<b>0,88</b>	<b>1,00</b>	
<b>QERRET</b>				
	<b>2017</b>	<b>Projekcion 2022</b>	<b>Projekcion 2032</b>	<b>p</b>
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0.5)</b>	2.779	3.130	3.972	<b>2,41%</b>
Të gjitha banesat		863		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,22	3,63	4,60	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		4,60		
Totali i NjEF-së	604	681	864	
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	<b>0,70</b>	<b>0,79</b>	<b>1,00</b>	
<b>RRAPË</b>				
	<b>2017</b>	<b>Projekcion 2022</b>	<b>Projekcion 2032</b>	<b>p</b>
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0.5)</b>	2.021	2.226	2.700	<b>1,95%</b>
Të gjitha banesat		570		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,55	3,91	4,74	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		4,73		



Totali i NjEF-së	427	471	571
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	0,75	0,83	1,00

p: rritja vjetore e popullsisë

Tabela 1.6.5.4: Rezultatet krahasuese të popullsisë -banesave me ritmin e duhur të ndryshimit, gjetja e popullsisë për të mbuluar strehimin në Njesitë Administrative të bashkisë Pukë, versioni A

Për Njësinë Administrative Gjegjan, duke simluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura që sot është 66% mund të reduktohet në 61%, duke shënuar një ndryshim prej -5% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 66% në 71%, duke shënuar një rritje prej 5%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje baneshash prej 29%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 2,76% për Njësinë Administrative Gjegjan.

Për Njësinë Administrative Pukë, duke simluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura, që sot është 78%, mund të reduktohet në 72%, duke shënuar një ndryshim prej -6% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 78% në 84%, duke shënuar një rritje prej 6%. Dhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje baneshash prej 16%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 1,67% për Njësinë Administrative Pukë.

Vërehet se në Pukë, përqindja e banesave të përdorura, është shumë e lartë në krahasim me pjesën tjeter të Njësive Administrative, me rezultat rritjen e popullsisë prej 1.67%, duke sjellë popullimin e banesave ekzistuese kryesisht për banim. Duke qenë se qyteti i Pukës është qendra e bashkisë, kjo rritje mund të ndodhë brenda një periudhe rreth 15 vjeçare duke zbatuar investimet e planifikuara në vend dhe me zhvillimin e sektorit të turizmit dhe të bujqësisë.

Prandaj, çështja e mjaftueshmërisë të banesave në Pukë duhet të shqyrtohet me kujdes, pasi një rikuperim i mundshëm ekonomik i bashkisë do të sjellë tërheqjen e aktiviteteve sipërmarrëse dhe, për pasojë, të banorëve të Pukës. Gjithashtu, duhet të merret parasysh qëndrimi i dy ose më shumë familjeve në një njësi ekonomike familjare, ndoshta për shkak të kushteve të vështira ekonomike, shumë prej të cilave, në rastin e rimëkëmbjes ekonomike, mund të kërkojnë një banesë të pavarur.

Për Njësinë Administrative Qelëz, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura sot që është 83% mund të reduktohet në 77%, duke shënuar një ndryshim prej -6% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 83% në 90%, duke shënuar një rritje prej 7%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje baneshash prej 10%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 1,23% për Njësinë Administrative Qelëz.

Për Njësinë Administrative Qerret, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura sot që është 70% mund të reduktohet në 65%, duke shënuar një ndryshim prej -5% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 70% në 75%, duke shënuar një rritje prej 5%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një perqindje baneshash prej 25%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 2,41% për Njësinë Administrative Qerret.

Për Njësinë Administrative Rrapë, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura sot që është 75% mund të reduktohet në 70 %, duke shënuar një ndryshim prej -5% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë përdorimi i banesave pritet të rritet nga 75% në 81%, duke shënuar një rritje prej 6%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një perqindje baneshash prej 19%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut në lidhje me mjatushmërinë e strehimit, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, u përllogarit ritmi i ndryshimit të popullsisë në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 1,95% për Njësinë Administrative Rrapë.

## Versioni B

	2011	Skenari 2031					
		high - conc.	high - deconc.	constant - conc.	constant - deconc.	low - conc.	low - deconc.
		MMMH C	MMMH D	MMMC C	MMMC D	MMML C	MMML D
Totali Popullsia e përgjithshme	225.548	185.120	200.076	188.816	200.102	192.356	199.569
Të gjitha banesat				70.397			
Raport i të gjitha vendbanimeve	3,20	2,63	2,84	2,68	2,84	2,73	2,83

për popullsi							
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF				4,00			
Totali i NjEF-së	54.429	46.280	50.019	47.204	50.026	48.089	49.892
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	0,77	0,66	0,71	0,67	0,71	0,68	0,71
<b>Bashkia PUKË</b>							
	2017	Projekcion 2022	Projekcion 2032	p			
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me -0,5)</b>	12.200	11.898	11.316	-0,5%			
Të gjitha banesat		4.251					
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	2,87	2,80	2,66				
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		4,48					
Totali i NjEF-së	2.723	2.656	2.526				
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	<b>0,64</b>	<b>0,62</b>	<b>0,59</b>				
<b>Bashkia PUKË</b>							
	2017	Projekcion 2022	Projekcion 2032	p			
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0,5)</b>	12.200	12.508	13.148	0,5%			
Të gjitha banesat		4.251					
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	2,87	2,94	3,09				
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		4,48					
Totali i NjEF-së	2.723	2.792	2.935				
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	<b>0,64</b>	<b>0,66</b>	<b>0,69</b>				
<b>Bashkia PUKË</b>							
	2017	Projekcion 2022	Projekcion 2032	p			
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0,5)</b>	12.200	14.157	19.063	<b>3,02%</b>			
Të gjitha banesat		4.251					
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	2,87	3,33	4,48				
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		4,48					
Totali i NjEF-së	2.723	3.160	<b>4.255</b>				
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	<b>0,64</b>	<b>0,74</b>	<b>1,00</b>				

*Tabela 1.6.5.5: Rezultatet krahasuese të popullsise-banesave me ritem të ndryshimit të popullsisë (-0,5% dhe 0,5%), gjetja e një popullsie për të mbuluar strehimin për Bashkinën Pukë, versioni B.*

Për Bashkinë Pukë, sipas Skenarit B, u krijuan dy variante. Varianti i parë ndjek modelin e popullsisë të studimit të INSTAT-it, me një normë të reduktimit të popullsisë prej -0,5%, ndërsa varianti i dytë, është skenari më i keq, në të cilin parashikohet një rritje vjetore e popullsisë prej 0,5%. Duke simuluar evolucionin demografik të popullsisë në nivel bashkiak, u konstatua se përqindja e banesave të përdorura që sot është 64% mund të reduktohet në 59%, duke shënuar një ndryshim prej -5% brënda një periudhe prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 64% në



69%, duke shënuar një rritje prej 5%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një përqindje baneshash prej 31%, të cilat mbeten të pashfrytëzuara. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në kushtet e mjaftushmërisë së banesave bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë u llogarit në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 3,02% për bashkinë Pukë.

Në përputhje me modelin e mësipërm, janë bërë llogaritjet për Njësitë Administrative që formojnë bashkinë në studim. Tabelat e mëposhtme tregojnë shkallën e normës së ndryshimit të popullsisë që kërkohet për të populuar banesat, për Njësitë Administrative që përbëjnë bashkinë Pukë, sipas versionit B.

GJEGJAN				
	2017	Projekcion 2022	Projekcion 2032	p
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0.5)</b>	2.260	2.966	5.110	<b>5,59%</b>
Të gjitha banesat		1.041		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	2,17	2,85	4,91	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		4,91		
Totali i NjEF-së	460	604	1.041	
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	<b>0,44</b>	<b>0,58</b>	<b>1,00</b>	
PUKË				
	2017	Projekcion 2022	Projekcion 2032	p
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0.5)</b>	4.030	4.132	4.343	<b>0,50%</b>
Të gjitha banesat		1.107		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,64	3,73	3,92	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		3,92		
Totali i NjEF-së	1.028	1.054	1.108	
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	<b>0,93</b>	<b>0,95</b>	<b>1,00</b>	
QELEZ				
	2017	Projekcion 2022	Projekcion 2032	p
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0.5)</b>	820	1.029	1.621	<b>4,65%</b>
Të gjitha banesat		670		
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	1,22	1,54	2,42	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF		5,52		
Totali i NjEF-së	149	186	294	
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	<b>0,22</b>	<b>0,28</b>	<b>0,44</b>	
QERRET				
	2017	Projekcion 2022	Projekcion 2032	p
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0.5)</b>	2.860	3.190	3.970	<b>2,21%</b>



Të gjitha banesat	863			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,31	3,70	4,60	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF	4,60			
Totali i NjEF-së	622	694	863	
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	0,72	0,80	1,00	
<b>RRAPE</b>				
	2017	Projekcion 2022	Projekcion 2032	p
<b>Totali Popullsia e përgjithshme (projekcion me 0.5)</b>	2.230	2.375	2.695	<b>1,27%</b>
Të gjitha banesat	570			
Raporti i të gjitha vendbanimeve për popullsi	3,91	4,17	4,73	
Raporti i tanishëm i anëtarëve të NjEF në NjEF	4,73			
Totali i NjEF-së	471	502	570	
Raporti i të gjitha banesave për NjEF	0,83	0,88	1,00	

p: rritja vjetore e popullsisë

*Tabela 1.6.5.6: Rezultatet krahasuese popullsi- banesa sipas normës se kërkuar të ndryshimit, gjetja popullsie për t'i populuar banesat në bashkine Pukë, versioni B*

Për Njësinë Administrative Gjegjan, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, është gjetur se sot përdoren rrëth 44% e banesave të cilat mund të reduktohen në 41%, duke shënuar një ndryshim prej -3% në një periudhë prej 15 vjetësh. Përkundrazi, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 44% në 48%, duke shënuar një rritje prej 4%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një sasi prej 52%, qe mbetet e pashtfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në aspektin e mjaftushmërisë së banesave, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë është llogaritur në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 5.59% për Njësinë Administrative Gjegjan.

Për Njësinë Administrative Pukë, duke simuluar modelin e evolucionit të popullsisë, është gjetur se sot përdoren rrëth 93% e banesave të cilat mund të reduktohen në 86% duke shënuar një ndryshim prej -7% në një periudhë prej 15 vjetësh. Përkundrazi, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 93% në 100%, duke shënuar një rritje prej 7%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, ekziston një sasi prej 52%, qe mbetet e pashtfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në aspektin e mjaftushmërisë së banesave, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë është llogaritur në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 0.5% për Njësinë Administrative Pukë.



Është vërejtur se në Pukë, përqindja e banesave të përdorura është shumë e lartë në krahasim me pjesën tjeter të Njësive Administrative, me një rritje të popullsisë prej 0.5% që sjell si rezultat popullimin e banesave ekzistuese të përdorura për qëllime banimi. Duke qenë se qyteti i Pukës është qendra e bashkisë, kjo rritje mund të ndodhë brenda një periudhe rreth 15 vjeçare, me zbatimin e investimeve të planifikuara në zonë dhe zhvillimin e sektorit të turizmit dhe atij bujqësor.

Prandaj, çështja e mjaftueshmërisë e banesave në Pukë duhet të shqyrtohet me kujdes, pasi rimëkëmbja e mundshme ekonomike e bashkisë pritet të tërheqë në mënyrë të vazhdueshme bizneset dhe banorët. Gjithashtu, duhet të merret parasysh banimi i dy ose më shumë familjeve në një njësi ekonomike familjare, ndoshta për shkak të kushteve të vështira ekonomike, dhe në rastin e rimëkëmbjes ekonomike shumë familje mund të kërkojnë një banesë të pavarur.

Në Njësinë Administrative Qelëz, duke simluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e strehimit që përdoret sot është 22% dhe mund të reduktohet në 21%, duke shënuar një ndryshim prej -1% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 22% në 24%, duke shënuar një rritje prej 2%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, megjithatë, ekziston një përqindje strehimi prej 76%, e cila mbetet e pashfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në aspektin e mjaftushmërisë së banesave, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë është llogaritur në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 4.65% për Qelëz.

Në Njësinë Administrative Qerret, duke simluar modelin e evolucionit të popullsisë, është gjetur se përqindja e banesave të përdorura sot është 72% dhe mund të reduktohet në 67% me një ndryshim prej -5% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 72% në 78%, duke shënuar një rritje prej 6%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, megjithatë, ekziston një përqindje strehimi prej 22%, e cila mbetet e pashfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në aspektin e mjaftushmërisë së banesave, bazuar në rritjen e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë është llogaritur në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 2,21% për Qerret.

Në Njësinë Administrative Rrapë, duke simluar modelin e evolucionit të popullsisë, u konstatua se përqindja e banesave që përdoren sot është 83% dhe mund të reduktohet në 77%, duke shënuar një ndryshim prej -6% në një periudhë prej 15 vjetësh. Në të kundërt, sipas skenarit më të keq, i cili parashikon rritjen e popullsisë, përdorimi i banesave pritet të rritet nga 83% në 89%, duke shënuar një rritje prej 6%. Edhe pse, sipas skenarit më të keq, ka një rritje në përdorimin e banesave, megjithatë, ka një përqindje të strehimit prej 11%, e cila mbetet e pashfrytëzuar. Për të bërë një vlerësim të plotë të riskut, në aspektin e mjaftushmërisë së banesave bazuar në rritjen



e popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, norma e ndryshimit të popullsisë u llogarit në mënyrë që të ketë mbulim total të strehimit në një periudhë prej 15 vjetësh, që është 1,27% për Njësinë Administrative Rrapë.

## KONKLUZIONE

Popullsia në qarkun e Shkodër dhe në bashkinë Pukë parashikohet të bjerë ndjeshëm gjatë një periudhë 20-vjeçare (bazuar në të dhënat e INSTAT-it), për shkak të rënies së lindjeve dhe rënies natyrore të popullsisë, si dhe për shkak të migrimit dhe emigrimit drejt qendrave të mëdha ekonomike. Përkundër rënies së madhe të parashikuar në një periudhë prej 20 vjetësh, u gjykua e nevojshme të simulohej një skenar më i keq, me përdorimin e formulës së përbërë për të parashikuar evolucionin e popullsisë në të ardhmen. Mbulimi i skenarit më të keq konsiderohet i nevojshëm, pasi parashikimi për një kërkësë më të lartë në të ardhmen do të mbulojë një kërkësë të vogël të mundshme, ndërsa nuk mund të ndodhë e kundërtë pasi do të krijojë probleme serioze.

Më konkretisht, është parashikuar se në qarkun e Shkodër popullsia gjatë 20 viteve të ardhshme të reduktohet nga 11,28% në 17,92%. Sipas gjendjes ekzistuese të strehimit në qark, shikohet se ka mjaftueshmëri të banesave boshe prej 24,15% të numrit të përgjithshëm të banesave. Ky fakt tregon se përqindja e banesave bosh do të rritet. Në të kundërt, gjatë 20 viteve të fundit është vërejtur një shtim i ndërtimeve për qëllime banimi në qarkun e Shkodër, i cili, i kombinuar me rënien e madhe të popullsisë, ka rritur situatën ekzistuese të strehimit. Megjithatë, në bashkinë Pukë, ngritja e ndërtesave të banimit nuk ndjek modelin e qarkut, pasi gjatë 20 viteve të fundit është vërejtur se ka rënje në krahasim me 20 vitet e mëparshme, ndoshta për shkak të pakësimit të numrit të popullsisë.

Për bashkinë Pukë, janë marrë parasysh të dy (2) versionet, A dhe B, për të simuluar popullsinë në vitin aktual (2017). Në Versionin A, siç u përmend më lart, popullsia ndryshon duke marrë parasysh ndërtesat ekzistuese, ndërsa në Versionin B, popullsia ndryshon duke marrë parasysh nxënësit e shkollave 9-vjeçare në vitin 2017.

Më konkretisht, u simulua një model i evolucionit të popullsisë, në një periudhë prej 15 vjetësh nga viti bazë (2017), me një normë vjetore të ndryshimit prej -0.5% në mënyrë që të jenë në përputhje me të dhënat e INSTAT dhe një skenar më i keq, sipas formulës së përbërë, në mënyrë që të analizohet mjaftueshmëria e strehimit në rastin e rritjes së popullsisë me një normë ndryshimi prej 0.5%. Në të dyja rastet, dhe në veçanti në rastin e skenarit më të keq, i cili paraqet interesin më të madh në aspektin e analizës së nevojave për strehim të ardhshëm, vërehet se mjaftueshmëria e banesave për familje në Versionin A është 17% për Bashkinë, ndërsa në Versionin B, është 31%.

Përveç kësaj, për vlerësimin e përgjithshëm të riskut dhe kuptimin më të mirë të nevojave për strehim në të ardhmen, u llogarit shkalla e evolucionit të popullsisë në një periudhë prej 15 vjetësh, në mënyrë që të sigurohet plotësia e banimit në nivel



bashkie. Për bashkinë Pukë, norma e ndryshimit të popullsisë duhet të jetë 1.79% në Versionin A dhe 3.02% në Versionin B. Siç mund të shihet, shkalla e ndryshimit, e llogaritur për bashkinë në studim, është mjaft e madhe dhe nuk është në përputhje me zhvillimet aktuale të popullsisë në Shqipëri. Në nivelin e Njësive Administrative të bashkisë në studim, është ndjekur i njëjtë model në pothuajse të gjitha Njësitë Administrative të bashkisë Pukë.

Përsa i përket **Bashkisë Pukë**, sipas **Versionit A**, shkalla e ndryshimit të popullsisë me qëllim mbushjen e ndërtesave të përdorura për banim duhet të jetë **2.76%** për Gjegjanin, **1.67%** për Pukën, **1.23 %** për Qelezën, **2.41%** për Qerretin dhe **1.95%** për Rape. Sipas versionit B, shkalla e ndryshimit të popullsisë me qëllim mbushjen e ndërtesave të përdorura për banim duhet të jetë **5.59%** për Gjegjanin, **4.65%** për Qelezën, **2.21 %** për Qerretin dhe **1.27%** për Rrapën.

Përjashtim bën Njësia Administrative Pukë, ku, sipas metodologjisë dhe analizës së mëparshme, shkalla e ndryshimit të popullsisë, për të pasur plotësi në ndërtesat e përdorura për qëllime banimi, duhet të jetë 0.5%, shkallë rritje që Njësia Administrative mund të ketë me zbatimin e investimeve të planifikuara gjatë viteve të ardhshme; të cilat do të përmirësojnë infrastrukturën e zonës, do të zhvillojnë sektorin e turizmit dhe të bujqësisë, dhe do të tërheqin biznese dhe banorë të rinj në zonë.

Në përfundim, sipas të dhënave të përpunuara të popullsisë, të dhënave të INSTAT-it për situatën e strehimit si dhe metodologjisë dhe analizave të përdorura në sektionet e mësipërme në lidhje me evoluimin e popullsisë në krahasim me banesat ekzistuese, në periudhë 15 vjet, vihet re se sipas versionit A nuk ka nevojë të ndërtohen ndërtesa te reja për qëllime banimi për të mbular nevojat për strehim të ardhshëm.

Sipas **Versionit B**, vihet re se nuk ka nevojë për ndërtimin e banesave të reja për të mbuluar nevojat për strehim në të ardhmen, me përjashtim të Njësisë Administrative Pukë, ku bashkia duhet të marrë parasysh me kujdes probabilitetin e rritjes së popullsisë me një ritëm më shumë se **0.50%** për Pukën, për të shmangur problemet e mjaftueshmërisë së banesave në vitet e ardhshme.

Gjithashtu, duhet të merret parasysh data e ndërtimit të banesave dhe gjendja e tyre, që janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në mjaftueshmërinë dhe cilësinë e banesave dhe që veprojnë negativisht me kalimin e kohës.

#### 1.6.6. Parashikimet financiare

Për të bërë një parashikim të planeve të investimeve sipas prioriteteve përkatëse, po analizojmë se si kanë lëvizur investimet e brendëshme dhe të huaja direkte në Shqipëri, në vitet e fundit. Në veçanti, në nivel vendi, niveli i investimeve të huaja direkte, ka regjistruar në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012, një rritje të konsiderueshme prej 41.90% (pas një rritjeje prej 5.62% në vitin e mëparshëm 2011). Në veçanti, vlera e investimet e huaja direkte në vitin 2013 arriti në 944.76 milionë €

ose rreth 10% të PBB. Sipas statistikave të fundit të publikuara nga Banka e Shqipërisë, shuma e investimeve të huaja direkte (FDI stock) në Shqipëri në vitin 2013 arriti në 4,2 miliardë €, duke shënuar një rritje prej 8% në krahasim me vitin 2012, ndërsa për të njëjtën periudhë fluksi i investimeve të huaja direkte arriti në 944.76 milionë €, duke shënuar një rritje rreth 42% krahasuar me vitin 2012.

Investimet e Huaja Direkte (Stock) në Shqipëri 2003-2013, në milion €											
	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012*	2013*
IHD (Stock)	382,33	614,22	865	1.056,98	1.829,58	2.061,15	2.261,44	2.435,97	3.399,90	3.892,90	4.187,51
Transf. % vitin e mëparshëm		61%	41%	22%	73%	13%	10%	8%	40%	15%	8%

Tabela 1.6.6.1: Investime të Huaja direkte (Stock) në Shqipëri 2003-2013, në milionë €, Burimi:  
Banka e Shqipërisë

Flukset hyrëse të investimeve të huaja direkte në Shqipëri 2003-2013, në milion €											
	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013**	semestri i parë 2014
Flukset hyrëse IHD	278,4	212,56	258,6	481,13	665,15	716,91	793,33	630,35	665,78	944,76	379,99
Transf. % vitin e mëparshëm		-24%	22%	86%	38%	8%	11%	-21%	6%	42%	

Tabela 1.6.6.2: Fluksi i Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri 2003-2013, në milionë €, Burimi:  
Banka e Shqipërisë

Vlen të përmendet se gjatë 10 viteve të fundit shuma e përgjithshme e stoqeve të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) u rrit me shpejtësi. Nga 382,33 milionë euro në vitin 2003, ajo ishte parashikuar në 4,2 miliardë euro në vitin 2013. Norma e rritjes së IHD në Shqipëri, edhe pse në rritje kjo shifër luhatet sepse është varësi e kushteve ekonomike ndërkombëtare dhe vendore.

Greqia është investitori kryesor i huaj në Shqipëri, duke zënë një pozicion të qëndrueshëm të parë nga 2007 në 2013, me përvjashtim të vitit 2011.

Në bazë të shifrave të rishikuara për vitin 2013, Greqia zoteron 26% të të gjitha IHD stock në Shqipëri. Për të njëjtën periudhë, vende të tjera me përqindje të konsiderueshme të stokut total të IHD janë Kanadaja (19%), Italia (12%), Austria (10%), Holanda (9%) dhe Turqia (9%) dhe më pas vinë Gjermania, Qipro, Zvicra dhe Franca.

Pjesa më e madhe e stokut të IHD në Shqipëri kanë të bëjnë me transportin, magazinimin dhe komunikacionin (27%), ndërmjetësimin financiar (20%), minierat dhe guroret (18%). Me një përqindje më të ulët paraqiten sektorët e industrive të tjera



(9%), të industrisë (8%), pasuri të patundshme (7%), ndërtim (3%), shitje me shumicë (3%), hotele dhe restorante (2%), ndërkokë që të gjithë sektorët e tjerë kalojnë pak ose nuk kalojnë shifrën prej 1% secila. Për sa i përket sektorit të investimeve, i cili parashikohet të jetë prezent në periudhën e ardhshme, dhe në veçanti gjatë pesë viteve të ardhshme, mendojmë se do të përqendrohet:

1. Në programet evropiane (p.sh. Balkan Med etj) që pritet të realizohen në gjatë kësaj dekade, si:
  - IPA II (2014-2020)
  - Shqipëria – kontributi finanziar në kuadër të IPA II
  - Interreg IPA CBC “Italy – Albania – Monstenegro” 2014-2020
  - Interreg V-B "Mediterranean (MED)" Programme 2014-2020
2. Në programin e investimeve publike të cilat parashikohen të kryhen nga pushteti vendor.
3. Në investimet direkte të reja që parashikohen se do të zbatohen në periudhën e ardhshme, nëpërmjet financimeve të tjera (p.sh. Banka Botërore, BEI, BERZH, investimet greko-shqiptare, investimet italiane-shqiptare etj.) dhe së fundi
4. Në investimet e pushtetit vendor (Bashkia Pukë) si rrjedhim i të ardhurave të veta, përmes formave të ndyshme të parashikuara ligjore dhe të reciprocitetit.

Për këtë qëllim, ne analizojmë veprimet e mësipërme në mënyrë që të njohim fushat e veprimit në të cilat bashkitë e zonës së studimit mund të përqendrohen.

## A. Programe evropiane që do të zbatohen në periudhën e ardhshme programore

### A.1 IPA II (2014-2020)

Instrumenti i Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA) është instrumenti me të cilin BE mbështet reformat në "vendet e zgjerimit" me ndihmë financiare dhe teknike. Fondet e IPA forcojnë aftësitë e vendeve përgjatë gjithë procesit të pranimit, me rezultat zhvillime pozitive në rajon. Për periudhën 2007-2013, IPA kishte një buxhet prej rreth 11.5 miliardë euro, pasardhësi i tij, IPA II, do të mbështetet në rezultatet e arritura tashmë duke kushtuar 11.7 miliardë euro për periudhën 2014-2020.

Përfituesit e sotëm janë Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Serbia dhe Turqia.

Fondet e para-aderimit në BE shërbejnë si investime të mira për rrugëtim pozitiv, si për vendet e zgjerimit ashtu edhe për vetë BE-në. Ato ndihmojnë përfituesit të ndërmarrin reforma politike dhe ekonomike, duke i përgatitur ata për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi në BE. Këto reforma duhet të ofrojnë tek qytetarët e tyre mundësi më të mira dhe të lejojnë zhvillimin e standardeve të barabarta me ato që gjëzojmë si qytetarë të BE-së. Fondet e para-aderimit ndihmojnë, gjithashtu që BE të arrijë objektivat e saj për sa i përket rimëkëmbjes së një ekonomie të qëndrueshme, furnizimin energjetik, transportet, mjedisin dhe ndryshimet klimatike, etj.

IPA II përcakton një kuadër të ri për ndihmën e para-anëtarësimit për periudhën 2014-2020. Risia më e rëndësishme e IPA II është fokusi i saj strategjik. Dokumentet e Strategjisë për çdo vend janë dokumentet specifike të planifikimit strategjik që janë përgatitur për secilin përfitues gjatë periudhës 7-vjeçare. Ato do të sigurojnë autonomi më të madhe nga përfituesit përmes integrimit të programeve të tyre reformuese dhe të zhvillimit. Një dokument strategjik shumëkombësh do të shqyrtojë prioritetet për bashkëpunimin rajonal ose bashkëpunimin territorial.

Mekanizmi IPA II synon reformat brenda zonave të paracaktuara. Këta sektorë mbulojnë fusha të lidhura ngushtë me strategjinë e zgjerimit, të tilla si demokracia dhe qeverisja, shteti i së drejtës apo zhvillimi dhe konkurenca. Kjo qasje sektoriale promovon reforma strukturore që do të ndihmojë transformimin e një sektori të caktuar dhe përshtatjen e tij me standarde të BE. Kështu mund të bëhet një kalim efektiv, i qëndrueshëm dhe me fokus në rezultate.

IPA II gjithashtu lejon një përdorim më sistematik të mbështetjes sektoriale të buxhetit. Së fundmi, i jep më shumë rëndësi matjes së performancës: vlerësimi i treguesve nga përfituesit do të ndihmojë për të vlerësuar deri në çfarë mase janë arritur rezultatet e pritshme.

#### Shqipëria – kontributi finanziar në kuadër të IPA II


Shpërndarja e financimit 2014-2020: 649.4 milionë euro. Fushat prioritare për financim gjatë kësaj periudhe janë: demokracia dhe qeverisja, shteti i së drejtës dhe të drejtat themelore, veprimi për mjedisin dhe klimën, transporti, konkurenca dhe inovacioni, arsimi, punësimi dhe politikat sociale, bujqësia dhe zhvillimi rural, rajonal dhe bashkëpunimi territorial.

#### A2. Programi "Interreg IPA CBC Italy – Albania – Montenegro" 2014-2020

Programi "Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal i Zi" është një program tre-palësh CBC bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA) gjatë periudhës së programimit 2014-2020. Programi është hartuar në kuadër të strategjisë evropiane për zhvillim të maturuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm (Europa 2020). Ai synon të ndihmojë vendet pjesëmarrëse për të arritur objektivat e tyre kombëtare për vitin 2020, promovimin e bashkëpunimit ndërkufitar në të gjithë Mesdheun, në kuadër të ndihmës integruese të Shqipërisë dhe Malit të Zi për në Bashkimin Evropian. Programi është në përputhje me Strategjinë e gjerë makro-rajionale të BE për rajonin e Adriatikut dhe Jonit (EUSAIR) dhe ndihmon zonat e Adriatikut-Jonit, të Italisë, të Shqipërisë dhe Malit të Zi të arrijnë zhvillimin bazuar në katër akset e EUSAIR, zhvillimin blu, lidhjen e zonës, cilësinë e mjedisit dhe turizmin e qëndrueshëm.

Zona përfituese e programit mbulon një total prej 66.365 km<sup>2</sup> dhe një popullsi prej 7,805,809 banorësh, dhe përfshin:

Italia	Rajoni PUGLIA: provinca e Bari, BAT Barletta-Andria-Trani, Brindisi, Foggia, Lecce, Taranto RAJONE MOLISE: provincat e Campobasso dhe Isernia
--------	---



Shqipëria	Të gjithë vendin
Mali I Zi	Të gjithë vendin

Buxheti i përgjithshëm i Programit arrin shumën prej 92,707,558.00 €.

Programi bashkë financohet nga instrumenti ndihmës i para anëtarësimit (IPA) me 85% dhe kërkohet pjesë në bashkë-financimin shtetëror prej 15%. Objktivi kryesor i programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mal të Zi është forcimi i bashkëpunimit në rajonin e programi për trajtimin e sfidave të përbashkëta me qëllim forcimin dhe integrimin e zhvillimit territorial. Qëllimi i tij është për tu mundësuar autoritetet e rajonale dhe lokale, nga rajone të përzgjedhura, të ndajnë njohuritë dhe përvojën, të zhvillojnë dhe të zbatojnë veprime pilot, të testojnë realizueshmërinë e politikave të reja, produkteve dhe shërbimeve, dhe mbështetje të investimeve në fusha të interesit. Me zbatimin e programit do të shtohet numri i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, do të përmirësohet atraktiviteti i të mirave natyrore dhe kulturore me ofertën e shtuar të produkteve dhe shërbimeve të reja risi, do të përmirësohet mbrojtja e mjedisit, do të përmirësohet mënyra e menaxhimi të ujrale, do të ketë parandalim të fenomeneve bregdetare në pjesën e brendshme dhe mbrojtje të biodiversitetit; do të ketë rritje të qasjes ndërkufitarë nëpërmjet shërbimeve dhe objekteve të transportit të qëndrueshëm, efikas dhe cilësor.

### A3. Programi Interreg V-B "Mediterranean (MED)" Programme

Programi MED është një nga instrumentet për zbatimin e politikës së kohezionit të BE. Me këtë politikë, BE synon zhvillimin harmonik duke forcuar kohezionin ekonomik, social dhe territorial dhe duke inkurajuar zhvillimin në rajonet e BE dhe vendeve pjesëmarrëse. Programi është një vazhdim i programit ndërkombëtar të bashkëpunimit MED 2007-2013, i cili ka financuar 150 projekte për bashkëpunim në fushën e inovacionit, mjedisit, transportin detar dhe qeverisjen Mesdhetare. Udhëzimet e përgjithshme për vitet në vazhdim janë përcaktuar në strategjinë "Bashkimi Evropian 2020" me synim që BE të transformohet në një ekonomi të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse duke ofruar nivele të larta të punësimit, produktivitetit dhe kohezionit social.

Strategjia "Evropa 2020" së bashku me Axhendën Territoriale 2020, përbën kuadrin e përgjithshëm strategjik për politikën e kohezionit të BE për periudhën 2014-2020 dhe, si rrjedhim, për programin e MED. Programi ndërkombëtar MED mbështet shkëmbimin e përvojave, njohurive dhe përmirësimin e politikave publike midis autoritetet e kombëtare, rajonale dhe lokale dhe organeve tjera territoriale të rajoneve të përzgjedhura të rajonit MED. Përfshin 57 rajone nga 10 vende të ndryshme të BE dhe 3 vende kandidate. Financohet nga Fondi Rajonal Europian për Zhvillim (ERDF) me € 224.322.525 ERDF për periudhën kohore 2014-2020.

Për të gjithë sektorin e bashkëpunimit zbatohet një normë bashkëfinancimi prej 85% të ERDF.



Programi i kushton vëmendje të veçantë katër llojeve të sektorëve që përfaqësojnë sfida të rëndësishme për shkak të burimeve të tyre, të potentialit të tyre të zhvillimit ose vështirësisë financiare. Ato janë:

- Zona bregdetare me një nivel të lartë tërheqës, me përqëndrim të konsiderueshëm të veprimatrive dhe brishtësi të burimeve natyrore e kulturore.
- Zona urbane, si qendra inovacioni dhe aktivitete socio-ekonomike të cilat përballen me sfida të forta në lidhje me ndotjen e mjedisit dhe emetimin e gazeve serë.
- Ishujt që mbulojnë 4% të Mesdheut dhe përfaqësojnë një dimension të madh ekonomik, mjedisor dhe kulturor të rajonit të MED. Të dyja janë të vendosura në udhëkryqin e akseve kryesore të komunikimit dhe në një situatë izolimi gjeografik.
- Zona rurale dhe të largëta të karakterizuara nga aktivitete rurale dhe dendësi të ulët të popullsisë. Zhvillimi i tyre pengohet nga izolimi gjeografik dhe/ose ndryshimet demografike dhe mjedisore. Kjo zonë karakterizon dhe bashkinë e Pukës.

Objektivi kryesor i programit MED është që të kontribuojë në zhvillimin afatgjatë të rajonit të Mesdheut dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar midis rajoneve dhe vendeve të përfshira.

#### **B. Investimet nga Plani i Investimeve Publike që parashikohen të kryhen**

Nga të dhënat e disponueshme nga vitet e kaluara, vërehet se një pjesë e madhe e të ardhurave buxhetore të bashkisë janë drejtuar drejt investimeve në infrastrukturë, veçanërisht në fushat e arsimit, bujqësisë, pastrimit, ambienteve sportive të shkollave dhe mirëmbajtjes së rrjetit rrugor, me qëllim përmirësimin e këtyre shërbimeve në dobi të e qytetarëve.

Në Bashkinë e Pukës të ardhurat e periudhës së fundit 2016-2017 janë si më poshtë:

Llojet e të ardhurave	Viti 2016	% 2016	Viti 2017	% 2017
Financime	155,090,226.00	71.65%	178,482,000.00	56.86%
Të ardhura nga Bashkia	51,207,000.00	23.66%	37,500,000.00	11.95%
U transferuan nga viti i kaluar	10,171,572.00	4.70%	97,903,228.00	31.19%
<b>Totali</b>	<b>216,468,798.00</b>	<b>100%</b>	<b>313,885,228.00</b>	<b>100%</b>

*Tabela 1.6.6.3: Të ardhurat e Bashkisë për çdo tip të ardhurash në vitet 2016-2017*

Siq mund të shohim, të ardhurat nga 216.47 milionë ALL në vitin 2016 arriten në 313.89 milionë ALL në 2017. Siq shihet në tabelën e mësipërme, pjesa më e madhe e të shumicës së të ardhurave vjen nga subvencione nga qeveria e përgjithshme dhe



fonde të ndryshme, ndërsa pjesa tjeter vjen kryesisht nga të ardhurat e bashkisë. Shifrat e mësipërme janë paraqitur edhe në grafikun më poshtë, duke treguar ecurinë e të ardhurave në vitet përkatëse.




Figura 1.6.6.1: Të ardhurat e Bashkisë në vitet 2016-2017

Në vazhdim paraqiten shpenzimet e bashkisë për të njëjtën periudhë kohore. Kategoritë kryesore të shpenzimeve lidhen me listën e pagave, sigurimet shoqërore, kostot operative, investimet dhe transporte të ndryshme.

Llojet e shpenzimeve	Viti 2016	% 2016	Viti 2017	% 2017
Pagat	105.471.300,00	48,72%	121.511.000,00	38,71%
Sigurimet Shoqërore	17.134.402,00	7,92%	20.879.000,00	6,65%
Operative	52.141.096,00	24,09%	43.897.867,00	13,99%
Investimet	34.586.000,00	15,98%	120.394.157,00	38,36%
Transferimet	7.136.000,00	3,30%	7.203.204,00	2,29%
<b>Totali</b>	<b>216.468.798,00</b>	100,00%	<b>313.885.228,00</b>	100,00%

Tabela 1.6.6.4: Shpenzimet e Bashkisë në vitet 2016-2017

Nga shifrat e tabelës së mësipërme konstatohet se shpenzimet e përgjithshme në vitin 2016 arritën në 216,47 milionë ALL, ndërsa në vitin 2017 ato u rritën në 313,89 milionë ALL. Pjesa më e madhe e shpenzimeve lidhet me listën e pagave, e cila në vitin 486 ishte 48,72% në vitin 2016 dhe ka rënë në 38,71% në 2017. Në vijim ndjekin investimet, shpenzimet operative dhe sigurimet shoqërore. Këto shifra janë paraqitur edhe në diagramin e mëposhtëm, i cili paraqet rrjedhën e shpenzimeve në vitet përkatëse.






Figura 1.6.6.2: Shpenzimet e Bashkisë në vitet 2016-2017

Duke pasur parasysh sa më sipër, përpinqet për prezantimin e të ardhurave, të shpenzimeve dhe investimeve të planifikuara për 15 vitet e ardhshme (2018-2032), me qëllim për të demonstruar situatën ekonomike të bashkisë dhe potencialin e saj për investime.

Parashikimet për të ardhurat e Bashkisë së Pukës (Tabela 1.6.6.3, Figura 1.6.6.3) janë të bazuara në ndryshimin mes viteve 2016 - 2017 dhe supozimin e ngritur se deri në vitin 2032 do të shënohet rritje prej 1.5% në vit. Kështu, për vitin 2018 të ardhurat e përgjithshme të vitit parashikohen në 318.59 milionë ALL dhe pritet të arrijnë në 392.430.000 ALL në vitin 2032.




Figura 1.6.6.3: Të ardhurat e Bashkisë për çdo tip të ardhurash në 15 vjeçarin 2018-2032





	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032
Finansme	181 159 230,00	183 876 618,45	186 634 767,73	189 434 289,24	192 275 803,58	195 159 940,64	198 087 339,74	201 058 649,84	204 074 529,59	207 135 647,53	210 242 382,25	213 396 322,48	216 597 267,32	219 846 226,33	223 143 919,72
Té ardhura e Bashkisë															
U transferuan nga viti i kahar	38 062 500,00	38 533 331,50	39 216 939,06	39 801 133,15	40 388 150,15	41 004 122,40	41 619 164,23	42 243 472,00	42 877 124,06	43 520 260,94	44 173 005,15	44 835 681,43	45 508 216,65	46 180 839,90	46 833 702,50
Totali	318 593 506,42	323 372 469,02	328 277 995,15	333 146 340,08	343 215 688,21	348 363 923,53	353 589 382,38	358 893 223,12	364 276 621,47	369 740 770,79	375 286,35	380 916,185,59	386 629 928,31	392 429 377,29	

Tabela 1.6.5: Të ardhurash për çdo tip të ardhurash në 15 vjeçarin 2018-2032 (parashikimi)

	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032
Pagat	123 333 665,00	125 183 669,98	127 061 425,02	128 967 346,40	130 901 856,50	132 855 384,44	134 658 365,21	136 881 240,69	138 934 459,30	141 016 476,19	143 133 751,31	145 280 759,63	147 459 971,03	149 671 870,59	151 916 949,65
Sigurnimet Shqiptore	21 192 185,00	21 510 067,78	21 832 218,79	22 160 209,57	22 492 612,72	22 830 001 91	23 112 451,94	23 520 038,72	23 872 839,30	24 220 931,89	24 594 995,66	24 963 311 80	25 337 761,48	25 717 827,90	26 103 595,32
Operativë	44 556 335,01	45 224 860,03	45 903 150,23	46 591 595,98	47 290 469,92	47 999 826,97	48 719 824,38	49 450 621,74	50 192 381,07	50 945 266,79	51 709 445,79	52 485 087,47	53 272 363,79	54 071 449,24	54 882 520,98
Transferimet	7 311 252,06	7 420 320,84	7 532 234,65	7 645 218,17	7 759 886,45	7 876 294,89	7 994 439,32	8 114 355,91	8 236 071,24	8 359 612,31	8 485 086,50	8 612 281,60	8 741 465,82	8 872 587,81	9 005 676,62
Shpenzimet totale (me përfshitum të investimeve)	196 393 437,01	199 339 338,62	202 229 429,70	205 364 370,13	208 444 835,68	211 571 588,22	214 745,000,84	217 966,257,05	221 235 750,91	224 554,287,17	227 922 601,48	231 241 440,50	234 811 562,11	238 333 735,54	241 908 741,58
Investimet	77 490 078,50	78 652 229,68	79 832 216,12	81 029 699,36	82 245 144,65	83 478 822,03	84 731 004,36	86 001 969,42	87 291 998,96	88 601 378,95	89 910 399,63	91 279 155,63	92 648 545,96	94 038 274,15	95 448 848,26
Totali i shpenzimeve dhe investimeve	273 483 515,57	277 991 168,40	282 161 644,82	286 394 069,50	290 689 980,54	295 050 330,25	299 476,005,20	303 968 226,48	308 527 749,87	313 155 686,12	317 853 001,11	322 620 196,13	327 460 108,07	332 212 009,69	337 357 589,84

Tabela 1.6.6: Shpenzimet e Bashkisë për çdo tip të ardhurash në 15 vjeçarin 2018-2032 (parashikimi)

Në vazhdim paraqiten parashikimet për shpenzimet bashkiake për 15 vitet e ardhshme (Tabela 1.6.6.4, Figura 1.6.6.4). Nga të dhënrat për vitet 2016 dhe 2017, rritja e shpenzimeve do të jetë rreth 1.5% në vit, duke u bazuar në supozimet e paraqitura deri në vitin e fundit të referencës që është 2032, pasi më parë janë zbritur investimet. Për sa i përket investimeve të parashikuara për vitin 2018, kemi marrë mesatarin e viteve 2016 dhe 2017, për shkak të diferencës së madhe që paraqitet mes tyre. Kështu, për vitin 2018 shpenzimet e përgjithshme të vitit pritet të arrijnë në 196.39 milionë ALL dhe pritet të arrijnë 337.36 milionë ALL në vitin 2032.




Figura 1.6.6.4: Shpenzimet e Bashkisë për periudhën kohore prej 15 vjetesh 2018-2032

Duke marrë parasysh të gjitha sa më sipër, dhe për të demonstruar totalin e investimeve në Bashki, bëhet përpjekje për parashikim të tyre për 15 vitet e ardhshme 2018-2032 (Tabela 1.6.6.5, Figura 1.6.6.5 dhe 1.6.6.6). Merret mesatarja e viteve 2016 dhe 2017 për shkak të diferencës së madhe ndërmjet tyre, dhe supozohet se rritja e investimeve të parashikuara do të jetë në nivelin 1.5% në vit, bazuar në supozimet, deri në vitin e fundit të referencës 2032. Investimi total pritet të tejkalojë një total prej 1.29 miliardë ALL.



	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030	2031	2032
Totali i të ardhurave	318 593 565,42	323 372 409,02	328 222 965,15	333 145 340,08	338 143 535,18	343 215 688,21	348 361 923,53	353 569 392,38	359 893 223,12	364 276 621,47	369 740 770,79	375 286 882,35	380 916 165,59	385 629 928,37	392 429 377,29
Totali i shpenzimeve (nuk përfshihen investimet)	196 393 437,07	199 339 338,62	202 329 428,70	205 354 370,13	208 444 835,68	211 571 508,22	214 745 080,84	217 966 257,05	221 235 759,91	224 554 287,17	227 922 601,48	231 341 440,50	234 811 562,11	238 333 735,54	241 808 741,58
Rezultati neto pozitiv	122 200 059,36	124 033 070,40	125 893 566,45	127 781 959,95	129 698 699,50	131 644 179,99	133 618 842,69	135 623 125,33	137 657 472,21	139 722 334,29	141 818 169,31	143 945 441,85	146 104 623,47	148 296 192,83	150 520 635,72
Investime	77 490 078,50	78 652 429,68	79 832 216,12	81 029 699,36	82 245 144,85	83 478 822,03	84 731 004,35	85 001 969,42	87 291 998,96	88 601 378,95	89 930 399,63	91 279 355,63	92 648 545,96	94 038 274,15	95 448 848,26

Tabela 1.6.7: Të ardhura – Shpenzime dhe investime të Bashkisë Pukë për 15 vjetet 2018-2032




Figura 1.6.5: Të ardhura – Shpenzime dhe investime të Bashkisë Pukë për 15 vjetet 2018-2032




Figura 1.6.6.6: Investime të parashikuara për 15 vitet e ardhshme

### C. Investimet e reja të drejtpërdrejta që do të realizohen në periudhën e ardhshme kohore, përmes rrugëve të tjera

Përveç investimeve që vijnë nga programet evropiane të financimit dhe programi i investimeve publike të Shqipërisë, parashikohen investime që nuk mund të përcaktohen sot dhe rrjedhin nga investimet e huaja direkte, përmes marrëdhënieve ndërkufitare, pjesë e të cilave do të zhvillohen edhe në bashkinë Mirditës.

Qeveria vendos në dispozicion të njësive administrative Fondin e Zhvillimit Rajonal (FZHR). Ky fond u krijuat në nëntor 2009 me ligjin nr. 10190 dhe që nga viti 2010 ka qenë përdorur për të mbështetur investimet në nivel rajonal dhe lokal. Qasja në financimin nga Fondi është e administruar nga një grant i dhënë sistemit konkurruese (grantet konkurruese). Projektet vlerësohen mbi bazën e një rrjeti të vlerësimit, duke përdorur tregues të ndryshëm dhe rezultatet e tyre përkatëse, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre për prioritetet strategjike të zhvillimit të Njësive Administrative. Një nga kriteret e vlerësimit është prania e bashkëfinancimit nga Bashkia. Ky nuk është një kusht i domosdoshëm pasi mungesa e mundësisë për bashkë-financim nuk është arsy e mjaftueshme për të përjashtuar financimin e një projekti nga ana e FZHR, por prania e tyre është sigurisht një element në avantazhues. Sugjerohet, për këtë arsy, të përdoren fondet lokale, relativisht të pakta, për të bashkëfinancuar projektet që do i paraqiten për shqyrtim Fondit të Zhvillimit Rajonal. Qeveria vendos në dispozicion të njësive administrative Fondin e Zhvillimit Rajonal (FZHR). Ky fond u krijuat në nëntor 2009 me ligjin nr. 10190 dhe që nga viti 2010 ka qenë përdorur për të mbështetur investimet në nivel rajonal dhe lokal. Qasja në financimin nga Fondi është e administruar nga një grant i dhënë sistemit konkurruese (grantet konkurruese). Projektet vlerësohen mbi bazën e një rrjeti të vlerësimit, duke përdorur tregues të ndryshëm dhe rezultatet e tyre përkatëse, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre për



prioritetet strategjike të zhvillimit të Njësive Administrative. Një nga kriteret e vlerësimit është prania e bashkëfinancimit nga Bashkia. Ky nuk është një kusht i domosdoshëm pasi mungesa e mundësisë për bashkë-financim nuk është arsy e mjaftueshme për të përjashtuar financimin e një projekti nga ana e FZHR, por prania e tyre është sigurisht një element në avantazhues. Për këtë arsy sygjerohet të përdoren fondet vendase, të cilat janë relativisht të pakta, për të bashkëfinancuar projektet që do i paraqiten për shqyrtim Fondit të Zhvillimit Rajonal.

### **Ç. Investime të bashkive të rajonit të studimit që do të vijnë nga vetë të ardhurat, përmes formës së përfitimit**

Investimet mund të rrjedhin edhe nga rritja e të ardhurave hyrëse të bashkisë përmes tarifave që mund të kontribuojnë në zhvillimin e ekonomisë vendase, rritjen e punësimit dhe përmirësimin e infrastrukturës totale të zonës. Rritja e investimeve të kësaj kategorie lidhet veçanërisht me politikat që do të zbatohen nga ana e Bashkisë dhe për çdo rast plotësojnë investimet e përgjithshme të saj, duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës.

#### **Konkluzione**

Duke analizuar të gjithë kategorinë e investimeve në Bashkinë Pukë, është e kuptueshme se gjatë 15 viteve të ardhshme priten investime që do tejkalojnë shifrën prej 2.27 miliardë ALL dhe kryesisht do të vijnë nga investimet përmes:

1. Programeve evropiane të periudhës së tanishme dhe në të ardhmen.
2. Programit të investimeve publike.
3. Investimeve të huaja dhe rrugëve të tjera (p.sh. Banka Botërore, Banka Evropiane e Investimeve, investimet italo-shqiptare etj).
4. Nga të ardhurat e veta, nëpërmjet formës së reciprocitetit apo partneritetit privat- publik.

Këto investime, të cilat pritet të ndikojnë në ndryshimin vendimtar të paisazhit të rajonit, kryesisht pritet që të fokusohen:

- në sektorët e mjedisit (ujë, kanalizime, impiante trajtimi të ujërave të zeza, sisteme menaxhimi të mbetjeve, infrastruktura e transportit etj.).
- në zhvillimin e bizneseve të reja dhe përmirësimin/modernizimin e atyre ekzistuese dhe në promovimin e teknologjive inovative dhe praktikave pioniere.
- në zhvillimin e projekteve të efikasitetit energetik dhe optimizimit.
- në investimet në zhvillimin turistik të bashkisë.
- në rritjen e konkurrencës përmes zhvillimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në sektorët e tregtisë dhe të shërbimeve.

Si përfundim, investimet e planikuara pritet të janë pole tërheqëse dhe faktor për zhvillimin e aktiviteteve të biznesit, si edhe një mjet për forcimin e kohezionit social. Bazuar në të dhënat e mësipërme, Bashkia do të zhvillojë dhe zbatojë një strategji

specifike zhvillimi, e përshtatur plotësisht dhe në përputhje me fizionominë dhe nevojat e saj specifike. Komponentët kryesorë të strategjisë ekonomike do të bazohen në:

1. Zbatimi i një plani për rehabilitim gradual ekonomik – vetë mbështetjeje ekonomike që do të përfshijë:
  - Uljen e kostos së shërbimeve dhe shpenzimeve
  - Përshtatjen të shpenzimeve me normat e rritjes së të ardhurave
  - Krijimin e infrastrukturës, stimujve dhe iniciativave për stimulimin e ekonomisë vendase
  - Shfrytëzimin e programeve kombëtare dhe evropiane për zhvillimin e infrastrukturës së zhvillimit
  - Njohjen dhe zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit
2. Shfrytëzimi i mundësive - perspektivave për zhvillimin e turizmit që do të përfshijë:
  - Shfrytëzimin dhe promovimin e thesareve, monumenteve natyrore dhe historike.
  - Krijimin e institucioneve kulturore, sportive dhe tregtare dhe infrastrukturave të fushës ndër-bashkiakë dhe kombëtare.
3. Burimet e shfrytëzimit - ristrukturimi dhe përmirësimi cilësor i bazës prodhuese vendore që do të përfshijë:
  - Përkrahjen, promovimin dhe reklamimin e produkteve dhe shërbimeve vendore
  - Rritjen e sipërmarrjes lokale në të gjithë sektorët e prodhimit përmes trajnimeve dhe veprimeve të integruara
  - Shfrytëzimin e potencialit lokal në hulumtim dhe inovacionin sipërmarrës.
4. Forcimi i qeverisjes lokale që do të përfshijë:
  - Përmirësimin e kapacitetit të vetëqeverisjes - shfrytëzimin e aftësive të qeverisjes elektronike.
  - Drejtimin e veprimeve përgatitore për ndërhyrjet zhvillimore - veprimet e rrjetëzimit dhe forcimin e pozitës së bashkisë në nivel ndër-rajonal.
  - Inkurajimin e shoqërisë civile.

Strategja për zhvillimin e brendshëm të Bashkisë synon përmirësimin e kapaciteteve administrative, të funksionimit dhe të mjedisit të brendshëm të saj dhe në fund të fundit synon përmirësimin e:

- **efektivitetit**, d.m.th, se sa daljet dhe rezultatet e secilit veprim të Bashkisë devijojnë nga objektivat e përcaktuara në PPV si edhe në Programin Buxhetor Aftamesëm,
- **efikasitetin**, d.m.th, se sa veprimet e secilës Bashki japin maksimumin e mundshëm të rezultatit me koston minimale të mundshme dhe në kohën minimale të mundshme)



- **legjitimitetin e funksionit të saj**, dmth, se sa objektivat secilës Bashki ndryshojnë nga nevojat, vlerat dhe pritet e të gjithë atyre që janë të përfshirë nga mjedisë i jashtëm dhe i brendshëm i saj.

#### 1.6.7. Struktura e ndërtimeve

Duke ndjekur udhëzimet e PPK, objektivat e përgjithshme dhe specifike të këtij studimi, parashikimet e popullsisë dhe ato ekonomike, formulohen udhëzime për zhvillimin e vendbanimeve dhe përmirësimin e mjedisit urban.

Për këtë nevojitet një lidhje dhe arritshmëri më të mirë në dy nivele: të qendrës së bashkisë me vendbanimet e mëdha dhe qendrat ekonomike të Shqipërisë, qytetet - porta të vendit dhe shpërndarësit kombëtarë të transportit. Në të njëjtën kohë, i rëndësishëm është edhe bashkëpunimi në nivel kombëtar (me pushtetin vendor e qendror, OJQ-të) dhe me bashkitë fqinje dhe Prefekturën (sidomos me këto të fundit) në drejtim të forcimit të pozitës dhe rritjes së saj duke maksimalizuar dhe stabilizuar përfitimet që do të rrjedhin nga zbatimi i strategjive dhe projekteve të propozuara.

Mjedisi ndërtuar i Bashkisë Pukë karakterizohet nga vendbanime të shpërndara në të gjithë tërësinë e territorin. Kufizimi kundrejt zhvillimeve të reja dhe përqafimi i formave bashkëkohore të zhvillimit urban, mund të jetë kritike për qëndrueshmërinë e bashkisë. Sygjerohet të bëhet një zhvillim i kontrolluar i ndërtimeve të reja përmes ndalimit ose kufizimit të tyre, sidomos në zonat e ndjeshme ose të papërshtatshme ku ballafaqohen konflikte mes përdorimeve konkurruese si zonë me miniera dhe me potencial turistik. Gjithashtu, në përgjithësi, gjendja jo e mirë e një pjese të madhe të stokut të ndërtesave kërkon përmirësin e eficiencës energetike dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese.

Bazuar në përcaktimet e PPK-së në lidhje me hierarkinë e qendrave, vendbanimet e Bashkisë ndahen në tri nivele:

- **Pukë: qendër terciare**
- **Gjegjan: qendër lokale e specializuar**
- **Vendbane të tjera: lokalitete**

Duke u fokusuar në nivel vendor, në bazë të analizës dhe strategjisë së propozuar, PPV ruan hierarkinë e mësipërme dhe stabilizojnë rolin e këtyre qendrave. Megjithatë, disa lokalitete të cilat bartin role të veçanta, tashmë përfitojnë më shumë peshë nga zhvillimet e pritura. Bëhet fjalë për qendrat e njësive administrative si edhe për disa fshatra me rëndësi historike, kulturore dhe natyrore, shfrytëzimi i të cilave do të ofrojë mundësi për zhvillim të specializuar dhe të diferencuar.

Gjithashtu, propozohet organizimi të koordinimi i dy rrjeteve rezidenciale, me qendër Bashkinë. Në nivelin e parë, qendrat e njësive administrative, përvëç qytetit, do të funksionojnë si qendra multifunksionale me orientim të ndryshëm zhvillimor. Në nivelin e dytë vendbanimet brenda çdo njësie administrative do të funksionojnë si një



rrjet i hapur me infrastrukturë dhe veprimtari shtesë. Qëllimi është që të ketë sinergji në mes tyre (me mundësinë për tu integruar në rrjete, p.sh. kulturore, urbane, historike, turistike) dhe të kenë ndikim të shumëfishtë për komunitetin vendas.

Më konkretisht, për qendrën e Bashkisë, **Pukë**, drejtimet kryesore propozohen të janë përforcimi dhe rigjenerimi.

Përveç projekteve të ndërtimit në qendër të qytetit Pukë, të cilat janë aktualisht në proces, ndërhyrjet që parashikohen janë:

- Restaurimi i pjesës së mbetur të qendrës së qytetit, ku përfshihen zona të rëndësishme turistike (p.sh. Muzeu Migjeni).
- Ristrukturimi i lagjeve të reja me infrastrukturë e nevojshme dhe hapësira publike shtesë si kënde lojërash, parqe etj.
- Ri-përdorimi i zonave të vjetra industriale, të cilat janë kryesisht të braktisura dhe sipas rastit mund të akomodojnë aktivitete të reja ekonomike (depo, njësi agro-përpunuese etj).
- Rizhvillimi i zonave joaktive ose të degraduara, si njësitë ushtarake.
- Krijimi i poleve të reja për të térhequr vizitorët e sipërmarrësit vendas dhe të huaj, bazuar në avantazhe natyrore dhe ide inovative.
- Përmirësimi i gjendjes së ndërtesave publike si Bashkia dhe Qendra e Kulturës.
- Ndërtimi i infrastrukturave moderne urbane, kryesisht për energjinë dhe telekomunikacionin.
- Promovimi dhe reklamimi i vlerave të pasura historike, kulturore dhe monumentale, si të tilla si veprimitaria e poetit të mirënjojur Migjeni, Kodër Hani etj.
- Mbrojtja e pyjeve rreth qytetit, të cilat formojnë identitetin e qytetit dhe peizazhin e tij të spikatur.

Zbatimi i këtyre projekteve do të kërkojë përdorimin e instrumentave dhe kushteve të përshtatshme për zhvillim si dhe përdorimeve të duhura të tokës. Në të njëjtën kohë, propozohet shtimi dhe plotësimi i qendrës urbane me shërbime cilësore si financiare, tregtare, sociale, arsimore, rekreative e turistike, bujqësore, administrative, kulturore e shëndetësore.

Për sa i përket kufije të qytetit dhe llojeve të përdorimeve përkatëse, propozohet dendësimi dhe konsolidimi i zonave më të reja të banimit me qëllim që ato të fitojnë një strukturë dhe formë të identifikueshme, të përmirësohet funksionimi i tyre dhe të lidhen më mirë me njëra-tjetrën edhe me qendrën. Zgjerimi me zona të reja, nëse është e nevojshme, duhet të bëhet me kujdes, duke siguruar lidhjen, shërbimin me rrjetet dhe infrastrukturën e nevojshme, dhe përshtatshmërinë me peizazhin natyror.

**Gjegjani** është një qendër rurale me potencial të rëndësishëm në sektorin primar dhe potencial për zhvillimin e sektorit terciar (agroturizëm). Pozicionohet në qendrën e një lugine produktive, përgjatë segmentit rrugor (tashmë të përmirësuar) Pukë-Rrëshen

dhe shumë afér korridorit trans-evropian E-851 (Ruga e Kombit). Akset e ndërhyrjes që propozohen janë rigjenerimi dhe konsolidimi, me fokus në:

- Rehabilitimin e qendrës (ku ndodhen ndërtesat më të rëndësishme publike) dhe zonave përgjatë rrjedhjes së lumit, në krahë të së cilit mund të krijohen shtigje këmbësoresh/bicikletash dhe vende qëndrimi.
- Dendësimin e lagjeve dhe përmirësimin e lidhjes së tyre me qendrën.
- Përdorimin e qëndrueshëm të zonave joaktive (p.sh. zona e vjetër ushtarake) për ripërdorime të reja me qëllime ekonomike dhe rezidenciale.
- Mirëmbajtjen dhe përmirësimin e stokut të ndërtimeve ekzistuese.

Zhvillimi duhet të jetë në përputhje me karakterin rural dhe të respektojë ambientin e veçantë të banimit.

**Vendbanimet rurale** në përgjithësi kanë karakteristika të përngjashme përsa i përket strukturëave hapësinore (përbëhen nga pjesë të ndara - lagje, të distancuara midis tyre dhe jo të lidhura drejtpërdrejt), dendësisë (e shpërndarë, e rrallë, me hapësira të unifikuara të kultivuara), madhësisë (popullsi e vogël) dhe nivelit të shërbimit (përgjithësisht zona rezidenciale dhe objekte bujqësore). Zhvillimi i vendbanimeve duhet të jetë në përputhje me karakterin rural, por gjithashtu ti shërbejë zhvillimeve turistike të formave alternative të propozuara në plan, gjë e cila është plotësish e mundur në disa fshatra. Për të përmirësuar strukturën urbane, formën dhe funksionin nevojitet të bëhet konsolidimi dhe kufizimi i tendencave së shpërndarjes, me synim përmirësimin e infrastrukturave sociale e teknike dhe përvitjen e investimeve. Zgjerimet e strehimit duhet të jenë të kufizuara dhe proporcionale me peshën dhe rolin e vendbanimit. Në anën tjetër, infrastruktura që shërben për prodhimin bujqësor dhe blegtoral dhe gjithë të tjerat që varen nga lëndët e para mund të pozicionohen në mënyrë të pavarur dhe në raport me to. Përveç kësaj, propozohen strategji e:

- ndërhyrjeve urbane në shkallë të gjerë (si përmirësimi i qendrës) ose në zona të caktuara (krijimi i hapësirave të përbashkëta dhe/ose i këndeve të lojrave përfëmijë, ndërtimi i godinave multifunksionale, sociale e kulturore) dhe mirëmbajtja-përmirësimi i infrastrukturës së qëndrave shëndetesore e arsimore.
- ndërhyrjeve mjedisore, si përcaktimi i kufinjve, mbrojtja e zonave lumore, mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore/reziqet (të tillë si erozioni), restaurim i ndërtesave me vlerat monumente e kulturore.

Në përgjithësi, mbrojtja dhe promovimi i monumenteve kulturore dhe natyrore, ruajtja e karakterit arkitektonik dhe krijimi i infrastrukturës së gjelbër (si shtigje kalimi e peizazhe natyrore) do të favorizojnë zhvillimin e turizmit duke tërhequr vizitorët dhe duke nxitur sipërmarrësit vendas për të rritur identitetin e tyre.

#### 1.6.8. Niveli i cilësisë së mjedisit

Zhvillimi i qëndrueshëm i zonës lidhet drejtpërdrejt me nivelin e lartë të mbrojtjes dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit. Me fjalë të tjera, proceset e zhvillimit, nuk duhet të rrezikojnë cilësinë e jetës së gjeneratave të ardhshme nga pikëpamja e mjedisit

natyror dhe burimeve natyrore të cilat nuk janë të pashtershme. Prandaj, bazuar në udhëzimet e qëndrueshmërisë, për të ruajtur mjedisin natyror cilësor në Bashkinë Pukë sygjerohet mbajtja pastër e ujërave (nëntokësore dhe sipërfaqësore), mungesa e pranisë së ndotësve në ajër, ekzistenca e tokave pjellore, nivelet e ulëta të zhurmës dhe peizazhi i pashqetësuar natyror.

Përcaktimi i nivelit të cilësisë së mjedisit, kërkon ekzistencën e disa standardeve, në rastin më të mirë të atyre kombëtare, evropiane ose ndërkombëtare.

### Cilësia e ujit

Sa i përket cilësisë së ujit, kjo varet në masë të madhe nga menaxhimi i mbeturinave dhe ujërave të zeza të zonave urbane dhe industriale. Mbeturinat urbane ose industriale depozitohen pa kriter në ambient të hapur, duke u transportuar më pas nga uji dhe ajri dhe duke u shpërndarë në gjithë siperfaqen. Mungesa e menaxhimi të këtij procesi ka rënduar gjendjen e cilësisë së ujit. Për këtë arsyе konsiderohet i nevojshëm menaxhimi i mbeturinave, i cili do të synojë në largimin e mbeturinave dhe depozitim të tyre në landfill-e, duke respektuar të gjitha kushtet e nevojshme mjedisore.

Uji, duke pasur shkëmbime të vazhdueshme të lëndës me pjesën tjetër të mjedisit, pasurohet me metale toksike të rënda si zhiva dhe plumbi, me kimikate të rrezikshme për jetën, me pesticide dhe plehra kimike, të gjitha produkte dhe nënprodukte të aktivitetit bujqësor. Në shtretërit e sipërfaqeve ujore që përdoren për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet, në 6 pikë aktive, aktualisht bëhet nxjerrja e inerteve (rërë, zhavorr). Banimi relativisht i kufizuar i Bashkisë Pukë (me prirje në rënie të popullsisë), aktiviteti i kufizuar bujqësor si dhe veprimtaria pothuajse inekzistente industriale, ndikojnë në mënyrë të favorshme, të paktën në çështjen e mjafqeshmërisë të burimeve ujore.

Në Bashkinë Pukë, theks i veçantë i kushtohet numrit të madh të digave që takohen në të gjithë zonën. Në veçanti, me ndërtimin e digave dhe rezervuarëve në vendet ku gjeomorfologjia, gjeologjia dhe tektonika e lejojnë, bëhet përqëndrimi i një vëllimi të madh uji që përdoret për aktivitete njerëzore dhe për nevojat për ujite, furnizim me ujë, prodhimin e energjisë elektrike. Megjithatë, ekzistenca e disa digave të njëpasnjëshme përgjatë një lumi mund të ndikojë negativisht në faunën e peshkut si dhe të pengojë lëvizjen e lirë të tij në ujë, përvèç se nëse janë parashikuar kanalet e duhura në afërsi të digës për të kaluar nëpër to një pjesë e tyre.

Analizat kimike të mostrave të marra nga lumi Drin treguan cilësi të mirë të ujit, me përbërje konstante minerale përgjatë lumit. Jonet metalike janë të pranishme në sasi të vogla, përvèç hekurit në disa raste. Sipas këtyre rezultateve, nuk ka asnjë kufizim në lidhje me përdorimin aktual të ujit, për prodhimin e energjisë elektrike dhe ujites.

Për të siguruar ruajtjen e cilësisë mjedisore dhe mbrojtjen e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, propozohet krijimi i një kuadri ligjor që synon menaxhimin e integruar dhe të qëndrueshmë të burimeve ujore. Në veçanti, ky objektiv mund të arrihet përmes një sërë politikash udhëzuese:



- Programe operacionale për monitorimin e situatës (kimike, ekologjike, morfologjike, sasiore) të ekosistemeve ujore.
- Analiza e karakteristikave të secilës zonë, me vlerësimin e presioneve dhe ndikimeve në mjedisin ujor.
- Krijimi i regjistrit të zonave të mbrojtura në rezervuarët dhe basenet e lumenjve, me theks në pjesën jugore të Bashkisë.

### Cilësia e ajrit

Një çështje e rëndësishme mjedisore është ndotja e ajrit pasi lidhet drejtpërdrejt me probleme të tjera serioze mjedisore. Në nivel kombëtar, Shqipëria ka miratuar vlera kufitare për ndotësit atmosferikë: bazuar në Vendimin nr. 803, datë 4.12.2003, dhe nenin 5 të Ligjit nr. 8897, datë 16.05.2002. Ndotësit kryesorë atmosferikë që monitorohen janë SO<sub>2</sub>, NO<sub>2</sub>, NOx, PM, CO.

Parashikimi total i emetimit GHG për gazrat në atmosferë paraqitet në ton CO<sub>2</sub> ekuivalente (CO<sub>2</sub>-e), dhe bëhet sipas metodologjisë së Konventës së OKB-së "Konventa mbi Ndryshimet Klimatike" (UNFCCC). Performanca IFC, Standardi 3, për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes, si edhe Kërkesa e Performancës 3 për parandalimin dhe pakësimin e ndotjes e EBRD, thekson se pragu është 100.000 ton CO<sub>2</sub>-ekuivalente në vit për një projekt të vetëm ose një aktivitet.

Në Bashkinë Pukë, ndotja e ajrit takohet kryesisht përgjatë akseve kryesore rrugore, siç është rruga shtetërore SH5 e cila mbart trafikun më të madh të automjeteve. Gjithashtu, djegia e drurit (i cili është burimi kryesor i ngrohjes për banorët vendas) ndikon në lëshimin e sasive të gazrave ndotës në ajër, por nuk mund të bëhet një vlerësim i përgjithësuar i këtij ndikimi.

Mekanizmat e auditimit për mos-kalimin e limiteve të shkarkimeve nga sektorët e transportit, si dhe mekanizmat e kompensimit, mund të parandalojnë fenomene të tilla dhe të mbajnë në nivele të ulëta ndotjen e ajrit. Është i nevojshëm zhvillimi i menjëherëshëm i një sistemi monitorimi, informimi, shoqëruar me hartimin dhe miratimin e politikave për të mbrojtur ajrin. Së fundi, rezultate shumë të mira për nivelet mjedisore të Bashkisë mund të sjellin politikat e përshtatshme, sipas të cilave qëllimi kryesor do të jetë verifikimi i origjinës së grimcave të shkarkuara dhe përmirësimi i Planit Kombëtar te Veprimit ekzistues, për zvogëlimin e mëtejshëm të përqëndrimit të Grimcave të Shkarkuara në atmosferë. Plani Veprimit duhet të marrë parasysh gjithashtu edhe sektorë të veçantë siç janë transporti rrugor.

### Cilësia e tokës

Toka është habitati ku njeriu zhvillon aktivitetin e tij, ku bashkë-ekzistojnë peizazhet natyrore e historike, duke shërbyer si një ofrues të lëndëve të para. Këto funksione janë të denja për tu mbrojtur për shkak të rëndësisë së tyre socio-ekonomike dhe mjedisore.

Për vlerësimin e tokës interes paraqesin parametrat e mëposhtëm:

- Mbetjet në 105°C në total;



- Fraksionimi në sitë me diametër 2 mm me bazë të thatë në  $105^{\circ}$ ;
- Metale të rënda (Al, Sb, As, Be, Cd, Co, Cr, Fe, Mn, Hg, Ni, Pb, Cu, Se, Ta and Zn);
- Totali i Karburanteve të Naftës (TPHs);
- Bifenile të Polikloruara (PCBs);
- Hidrokarburet aromatike policiklike (PAHs).

Mbrojtja e burimeve territoriale është me rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik të Bashkisë, pasi është baza mbi të cilën zhvillohet ekonomia rurale dhe pasuria pyjore. Ekskluzivisht për Bashkinë Pukë nuk ka të dhëna të mjaftueshme sasiore. Tokat e Pukës janë të ngarkuara me niksel (Ni), bakër (Cu), krom (Cr) dhe plumb (Pb). Për më tepër, ngarkesa e tokës me këto metale të rënda mund të çojë në degradimin e burimeve të ujërave nëntokësore.

Problemet në tokë janë shkaktuar edhe nga erozioni i saj, që çon në reduktimin e prodhimit bujqësor dhe zhdukjen e burimeve pyjore. Ekzistojnë disa faktorë që kontribuojnë në përshtypjen e erozionit të tokës, midis të cilëve përfshihen edhe ata natyrorë (p.sh. reshjet e parregullta, tokat e cekëta, pjerrësitë e larta, brishtësia e materialit të tokës) dhe faktorët njerëzorë si braktisja e tokës, shpyllëzimi etj. Një formë tjetër e degradimit është rrëshqitja e tokës, gjë që redukton ndjeshëm jo vetëm qëndrueshmërinë e bujqësisë, por edhe sigurinë afatgjatë të vendbanimeve rurale.

### Cilësia e peizazhit

Në siperaqen e Bashkisë, ndërhyrjet më të shpeshta të bëra nga njeriu në peizazhin natyror (i përbërë nga masivet malore me peizazh karstik, rrafshina të vogla me siperaqe të kultivuara dhe kullotat), janë rezervuarët artificialë dhe digat të cilat shkaktojnë ndryshime në peizazhin natyror.

Efektet e ndërhyrjeve të mësipërme në peizazh janë të ndryshme dhe lidhen me ndryshimet në mikroklimën dhe ekosistemet ujore, ndërhyrjet në relievin e tokës etj.

Së fundmi, ndryshime në peizazh krijon edhe hedhja e pakontrolluar e mbeturinave shtëpiake dhe inerteve të ndërtesave si pranë zonave të banuara ashtu edhe në lumenj e liqene.

### Cilësia e mjedisit akustik

Mjedisi akustik është rezultat i karakteristikave territoriale të zonës nga e cila mblidhen mostrat e zhurmës. Nivelet më të larta të zhurmës vërehen në zonat me popullsi të dendur dhe në akset rrugore kryesore.

Në nivel kombëtar, indeksi i zhurmës në Shqipëri është mesatar (51.25, 100 është niveli më i lartë) sipas matjeve të 2017.<sup>10</sup> Në përgjithësi, burimet kryesore të zhurmës janë autostrada dhe rrugët urbane kryesore, zonat me rrjet hekurudhor, zonat industriale dhe zonat tregtare, dyqanet, ndërtesarat rekreative, disa objekte sportive dhe infrastruktura turistike.

<sup>10</sup> [www.numbeo.com](http://www.numbeo.com)



Burimet kryesore të zhurmës në zonën e studimit shkaktohen nga rrugët kryesore automobilistike, si ajo SH5 (që përbën aksin kombëtar Shkodër-Kukës, SH5, që lidh Shqipërinë me Kosovën), si dhe pjesa tjeter e rrjetit rrugor primar dhe sekondar. Qendra e Bashkisë Pukë paraqet nivele më të larta zhurme sesa njësitë rurale për shkak të kalimit të akseve kryesore rrugore; ndërsa në pjesën tjeter zhurmat cilësohen me nivel mesatar deri të ulët për shkak të ekzistencës përgjithësisht të dyqaneve e ambjenteve rekreative me shqetësim të ulët në mjedis. Raste të izoluara përbëjnë guroret dhe zonat e minierave, apo industri të tjera të rënda, por zakonisht ato ndodhen larg zonave të banuara.

Trajtimi i problemit të zhurmës, lidhet kryesisht me përqëndrimin ndaj akseve rrugore të cilat mund të shtrohen me një lloji specifik asfalti dhe të pajisen me barrierat e përshtatshme (apo bimësi) për mbrojtjen nga zhurmat dhe rritjen e sigurisë rrugore. Pra, ndërhyrjet e lehta në infrastrukturën rrugore pritet të ulin emetimet e zhurmave në të ardhmen.

### 1.7. Ndryshime të mundshme të sistemeve

Duhet të kuptohet se strategja e propozuar territoriale, e cila ka si objektiv kryesor zhvillimin e qëndrueshëm të bashkisë dhe që do të zbatohet përmes një sërë projektesh dhe veprimeve të propozuara (plani i veprimit), do të rezultojë në ndryshime të sistemeve ekzistuese territoriale (rurale, natyrore, ujore, urbane dhe infrastrukturore) siç përcaktohet në VKM Nr.671, datë 29.07.2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit". Ky ndryshim është i dëshirueshëm dhe shpesh i nevojshëm, pasi synon:

- në mbrojtjen e mëtejshme të mjedisit (natyror dhe kulturor) dhe të peizazhit
- në shuarjen e konflikteve dhe sigurimin e përputhjes dhe përbushjes së përdorimeve të tokës
- sigurimin e infrastrukturës teknike, që është e nevojshme për të hequr ose kufizuar situatat negative që janë krijuar
- përmirësimin e kushteve të jetesës, punës dhe sigurimin e një nivelit të lartë ekonomik për të gjithë popullsinë, i cili pritet të rritet gjatë 15 viteve të ardhshme.

Këto ndryshime në sistemet territoriale (shih Tabelën 1.7.1) mund të ndodhin si për shkak të projekteve/veprimeve të propozuara ashtu edhe prej angazhimeve institucionale që rezultojnë nga legjislacioni i përgjithshëm ose ai i specifik. Kufijtë dhe zonat e ndryshimeve të mundshme të sistemeve janë indikative. Përfundimi i tyre do të zhvillohet në fazën e ardhshme me organizimin përfundimtar të territorit të Bashkisë dhe përcaktimin përfundimtar të kushteve të zhvillimit.

Për shkak të karakterit rural të zonës, madhësia së vogël të popullsisë dhe mjedisit të gjerë natyror, ndryshimet në sistemet tokësore që mund të ndodhin janë të kufizuara. Ato kryesisht lidhen me infrastrukturën teknike dhe zonat rekreative-sportive, të cilat



janë të lidhura drejtpërdrejt me elementet e veçanta të mjedisit natyror (peisazhet, pyjet, ujërat, monumentet, florën dhe faunën).

Duke marrë parasysh reliefin e zonës dhe duke synuar, shmangien e izolimit të të Bashkisë dhe lehtësimin e ndërlidhjes me akset dhe zonat e zhvillimit të nivelit kombëtar, propozohet rindërtimi dhe/ose ndërtimi i rrugëve të reja. Për përcaktimin përfundimtar të karakteristikave të tyre do të nevojiten studime të specializuara.

Ndërhyrje të rëndësishme janë propozuar në zonën rreth qytetit të Pukës, një qendër e rëndësishme e banimit, e integruar në sistemin kombëtar, me synim akomodimin e aktivitete të reja ekonomike (turistike, tregtare, etj.), të nevojshme për qytetin për t’iu përgjigjur rolit të saj të ri. Ndërkohë, synohet vendosja e tyre në zona jo aktive të sistemit urban, të cilat do të rigjenerohen dhe do të ripërdoren.

Gjithashtu, ka të ngjarë të rezultojnë ndryshime në kufijtë e zonave urbane, si për shkak të racionalizimit të kufijve tashmë të miratuara në bazë të VKM Nr.5, datë 29.12.2014 ashtu edhe për shkak të përcaktimit të kufinjve të rinj të vendbanimeve (me ndërtimetë dendura apo të rralla) dhe zonave ekonomike/natyrore/bujqësore.

Bazuar në sa më lart, vlerësohet një rritje e vogël e sistemit infrastrukturor (me 0.25 %) dhe rritja e madhe e sistemit urban (me 4.04 %).

Duke iu referuar tokës bujqësore, është propozuar forcimi i i infrastrukturës së duhur për rritjen e efikasitetit dhe produktivitetit (rrjete të ujitjes, magazina dhe njësi frigoriferike).

Për sa i përket rrjetit hidrografik, qëllimi është ruajtja dhe mbrojtja e sipërfaqeve të ujërave sipërfaqësore dhe për këtë arsy nuk do të ndodhin ndryshime në këtë sistem.

Së fundmi, në sistemin natyror propozohet përfshirja në statusin e zonave të mbrojtura (sipas Ligjit 81/2017), zbatimi i planeve të menaxhimit të qëndrueshëm krijimi i objekteve dhe infrastrukturës për zhvillimin e formave të reja e alternative të turizmit, dhe mbështetja e aktiviteteve ekonomike për projekteve të qëndrueshme.

Sistemi Territorial	Sipërfaqja e vlerësuar pas aplikimit të projekteve të propozuara (përqindja %)	Ndryshimi (%)
Sistemi natyror	90,5%	-0.02
Sistemi ujor	1,3%	0
Sistemi bujqësor	6,2%	-0.15
Sistemi urban	1,2%	4.04
Sistemi infrastrukturor	0,8%	0.25

Tabela 1.7.1:Sistemi Territorial pas aplikimit të projekteve të propozuara



Për zbutjen dhe kufizimin e ndikimeve të mundshme negative nga ndryshimet e sistemeve territoriale, do të parashikohen masa të përshtatshme dhe do të jepen udhëzime përkatëse në fazën e ardhshme. Sidoqoftë, ndërhyrjet e propozuara, strategjitet e rregulloret e propozuara të PPV do të vlerësohen nga VSM që do të ndjekë më pas. Së fundmi, theksohet se legjislationi aktual parashikon kontroll mjedor të projekteve dhe licencsim të subjekteve para zbatimit të tyre.

## 2. PLANI I VEPRIMEVE STRATEGJIKË DHE PROJEKTET PILOT TË ZHVILLIMIT

### 2.1. Plani i Veprimit

Për mbështetjen e vizionit dhe zbatimin e objektivave strategjike propozohet Plani i Veprimit me projekte dhe veprime konkrete që konsiderohen të nevojshme dhe do të mbështesin zhvillimin e bashkisë gjatë 15 viteve të ardhshme (2018-2032). Ky është një program kuadër në të cilin do të bazohet hartimi i listës vjetore të prioriteteve, por edhe programet afatmesme të Bashkisë. Krijimi i këtij rrjeti koherent projektesh bazohet:

- në përfundimet e analizës, të vlerësuar dhe dokumentuar edhe gjatë analizës SWOT, të paraqitur më lart,
- në rezultatet e konsultimeve me të gjithë aktorët, shërbimet e Bashkisë, banorët dhe sipërmarrësit e lirë,
- në planifikimin aktual afatshkurtër dhe afatmesëm të bashkisë, siç pasqyrohet në vendimin e Bordit Drejtues për miratimin e Listës së investimeve prioritare për vitin 2017 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2018-2020.

Projektet/veprimet ndahen në tre kategori bazuar në rëndësinë dhe fushëveprimin që pritet të kenë: lokale, ndër-bashkiake/ndër-rajonale dhe kombëtare. Disa janë përzgjedhur për t'u realizuar si projekte pilot, pasi ato mund të veprojnë si katalizatorë të rritjes, me një kosto të ulët dhe ndikim të lartë. Gjithashtu, projektet e propozuara gjenden në një fazë tjeter të zbatimit dhe kanë një shkallë të ndryshme të pjekurisë.

Në Tabelën e mëposhtme përshkruhen të gjitha projektet e propozuara të ndara në kategorji të përgjithshme dhe duke iu referuar një sërë informacionesh si më poshtë:

- kodi
- titulli
- aks i prioritetit në të cilin është integruar projekt. Një projekt mund ti shërbejë më shumë se një prioriteteve.
- buxheti i vlerësuar. Si bazë për vlerësim u përdorën projektet sipas studimeve të fundit në bashki, projektet e ngjashme në territorin shqiptar dhe eksperiencia e Bashkisë dhe Qarkut në investimet e projekteve. Kostot e paraqitura janë



paraprake pasi në këtë fazë nuk mund të bëhen vlerësime të sakta përveç rasteve kur projektet janë në një fazë të pjekur dhe bashkia apo institucioni kompetent ka përparuar tashmë në parashikimin e buxhetit bazuar në draft-projektet apo projektet finale te hartuara.

- burime të mundshme të financimit. Si bazë për vlerësimin e financimeve u konsideruan praktikat, mundësitet aktuale dhe planifikimi i Bashkisë. Vlen të theksohet se lista e burimeve të financimit nuk është e plotë, por përmban vetëm burimet kryesore.
- institucioni me përgjegjësinë kryesore, kompetencën për planifikim, hartim dhe zbatimin e ndërhyrjes. Në shumicën e projekteve, të cilat janë në kuadrin lokal, kompetencën e ka vetë Bashkia, si palë e interesuar drejtpërdrejtë.
- priorititet e zbatimit, të ndara në pesë periudha (në përputhje me databazën e RIT).
- tregues për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të ndërhyrjeve.
- vlerësim për nevojën e ndryshimeve institucionale dhe ligjore.
- burime njerëzore, në nivel të organit kompetent, i cili do të ngarkohet me planifikimin, hartimin dhe zbatimin e ndërhyrjes. Nisur nga fakti se përgjegjësinë primare për shumicën e projekteve e ka Bashkia, siç edhe u përmend më lart, personeli i bashkisë është ai që do të kryejë realizimin e pjesës më të madhe të këtij Plani i Veprimit.
- vërejtje të përgjithshme që nxjerrin në pah veçoritë specifike ose shpjegojnë përbajtjen për pjesët komplimentare të veprave.

Vërehet se Plani i Veprimit shërben dhe mbështet planifikimin strategjik në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm. Është e qartë se përveç kësaj ekzistojnë një sërë projektesh dhe veprimesh që kanë të bëjnë me punën e përditshme të bashkisë, shërbimin e qytetarëve dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës, e cila nuk është përfshirë në Planin aktual.

Bashkia mund të modifikojë Planin e Veprimit për të përshtatur veprimet e saj me ndryshimet e vazhdueshme në realitet, duke marrë parasysh mundësitet dhe kufizimet e reja. Megjithatë, rishqyrtimi i tij propozohet të jetë i dokumentuar dhe të bëhet një herë në vit kur hartohet buxhetor vjetor.

Plani i Veprimit është një mjet shumë i rëndësishëm për funksionimin e brendshëm dhe të saktë të bashkisë dhe në të njëjtën kohë përbën një mjet zhvillimi përmes të cilit mund të kërkohen fonde dhe investime dhe ndihmon pjesëmarrjen e saj në skema (PPP) dhe iniciativa investimesh.



Kodi	Titulli i Projekteve	Përfshihet në Aksesh e prioritetit me numër	Buxheti i nevojshëm (ALL me TVSH)	Burimet e mundëshme të financimit	Nësitet administrative që preket	Përgjegjës përzbatimin	Prioritet Fazat e Zbatimit				Treguesi për matjen, monitorimin e zbatimit	Burimet njerëzore	Ndryshimet e nevojshme institucional e dhe ligjore	Shënie
							I: '18	II: '19-'20	III: '21-'27	IV: '28-'32				
<b>Infrastruktura Urbane</b>														
1.	Sistemimi i blokut të banimit sipër Muzeut Migjeni dhe rrugës (unaza) Halil Çel Terbuni	16,2	117,136,559	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve	Njësia Administrative Pukë	Bashkia Pukë	X				Dendësia e popullsisë, Numri i modaliteteve të transportit, Pajisja me banesë, Ndryshimet mbi përdorimin e tokës, Akses ndaj shërbimeve, Rritja e numrit te strukturave, Rritja e aktivitetit te bizneseve	Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	Vendim Nr.66 dt. 19.12.2016 Për miratimin e prioriteteve për investime e shërbime në bashkinë Pukë për vitin 2017
2.	Rivitalizimi i Blokut të Pallateve, Pukë	16,2	100,000,000	Fondi për Zhvillimin e Rajoneve	Njësia Administrative Pukë	Bashkia Pukë					Dendësia e popullsisë, Numri i modaliteteve të transportit, Pajisja me banesë, Ndryshimet mbi përdorimin e tokës, Akses ndaj shërbimeve	Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	Vendim Nr.66 dt. 19.12.2016 Për miratimin e prioriteteve për investime e shërbime në bashkinë Pukë për vitin 2017
3.	Rikonstruktion i të gjithave fasadave, çatite të banesave të Qytetit të Pukës.	16	55,000,000	Bashkia Pukë, Agjensia për Zhvillimin Rajonal	Njësia Administrative Pukë	Bashkia Pukë						Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	Vendim Nr.66 dt. 19.12.2016 Për miratimin e prioriteteve për investime e shërbime në bashkinë Pukë për vitin 2017
4.	Rivitalizimi i Konviktit, Pukë	13	25,000,000	Bashkia Pukë, Agjensia për Zhvillimin Rajonal	Njësia Administrative Pukë	Bashkia Pukë					Numri i nxënësve që frekuentojnë strukturat	Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	Vendim Nr.66 dt. 19.12.2016 Për miratimin e prioriteteve për investime e shërbime në bashkinë Pukë për vitin 2017
5.	Projekti për rruajtjen e eficiencës së energjisë, Pallati i Gjuetarit	12,14	8,000,000	Bashkia Pukë, Agjensia për Zhvillimin Rajonal	Njësia Administrative Pukë	Bashkia Pukë						Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	Vendim Nr.66 dt. 19.12.2016 Për miratimin e prioriteteve për investime e shërbime në bashkinë Pukë për vitin 2017
6.	Projekti për rruajtjen e eficiencës së energjisë në ndërtesarat	12,14	198,000,000	Bashkia Pukë, Agjensia për Zhvillimin Rajonal	Njësia Administrative Pukë	Bashkia Pukë, Donatorë të ndryshëm						Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• instalimi i paneleve djellore në çatitë e shkollave,</li> <li>• instalimi i termoizolimit dhe dritare për kursim energjie</li> <li>• instalimi llambave për kursim të</li> </ul>



	administrative dhe infrastrukturën bashkiakë												energjisë brenda ndërtesave dhe ndriçim të rrugëve, • integrimi i burimeve e rinovueshme të energjisë në furnizimin me ujë dhe rrjetin e ujtjes
7.	Rikonstruktion i i Zyrave të administratës së Bashkisë	13,17	35,000,000	Bashkia Pukë, Agjensia për Zhvillimin Rajonal	Njësia Administrative Pukë	Bashkia Pukë		X			Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	Vendim Nr.66 dt. 19.12.2016 Për miratimin e prioriteteve për investime e shërbime në bashkinë Pukë për vitin 2017
8.	Rivitalizimi dhe projekti për ruajtjen e efiqësës dhe përmirësimin e kushleve të ruajtjes dhe ekspozimit të objekteve në Muzeumin Etnografik, Qyteti Pukë	2,4,13	5,500,000	Bashkia Pukë, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve	Njësia Administrative Pukë	Bashkia Pukë		X		Aksesi ndaj shërbimeve, Zonat e gjelbëra	Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit, Sektori i Zhvillimit të Kulturës	Nuk ka nevojë për ndryshime.	• Ruajtja e objekteve të trashegimisë kulturore në muzeun
9.	Rigjenerim i Qëndrës Gjeqjan	16,2	17,537,616	Bashkia Pukë, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR): Granti konkurrues për infrastrukturën vendore; Granti koncurrues për kulturën; Donatorë; Kompanitë e sektorit të shërbimeve	Njësia Administrative Gjeqjan	Bashkia Pukë	X			Dendësia e popullsisë, Numri i modaliteteve të transportit, Pajisja me banesë, Ndryshimet mbi përdorimin e tokës, Akses ndaj shërbimeve	Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	Vendim Nr.66 dt. 19.12.2016 Për miratimin e prioriteteve për investime e shërbime në bashkinë Pukë për vitin 2017 Projekti do te zbatohet nepermjet hartimit të Planit Urbanistik • Krijim i hapësirave publike (sheshe, parqe, këndë lojrash) • Rikuvalifikim i fasadave të ndërtesave dhe rritje e eficiencës energjike të tyre • Lidhje të strukturave sociale dhe hapësirave publike nëpërmjet rrugëve këmbësore dhe bicikletash për shqyrtyzimin e peizazhit të fshatit dhe sistemimit i tyre. • Rigjenerim i strukturave sociale (shkollës dhe qëndrës shëndetësore) • Promovim i fuksioneve mikse dhe shtim i shërbimeve turistike dhe tregtarë për të mundesuar akomodimin e vizitorëve • Organizimi i eveneve të përkohshme që promovojnë përdorimin e hapësirave publike të lokalitetit
10.	Rigjenerim i Qëndrës Kabash	1,2,16	15,000,000	Bashkia Pukë, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR): Granti konkurrues për infrastrukturën vendore; Granti	Njësia Administrative Rrapë	Bashkia Pukë		X		Dendësia e popullsisë, Numri i modaliteteve të transportit, Pajisja me banesë, Ndryshimet mbi përdorimin e tokës,	Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	• Rivlerësim i pasurive historike • Rikuvalifikim i fasadave të ndërtesave dhe rritje e eficiencës energjike të tyre • Krijim i hapësirave publike (sheshe, parqe, këndë lojrash)



				konkurrues për kulturën; Donatorë; Kompanitë e sektorit të shërbimeve				Akses ndaj shërbimeve			<ul style="list-style-type: none"> <li>Lidhje të strukturave sociale dhe hapësirave publike nëpermjet rrugëve këmbësore dhe biçikletash për shqyrtëzimin e peizazhit të fshatit dhe sistemim i tyre.</li> <li>Rigjenerim i strukturave sociale (shkollës dhe qendrës shëndetësore)</li> <li>Promovim i fukcioneve mikse dhe shtim i shërbimeve turistike për të mundësuar askesin në pikat kulturore dhe fetare</li> <li>Organizimi i eveneve të përkohshme që promovojnë përdorimin e hapësirave publike të zonës</li> <li>Vizita dhe pelegrinazh në monumentet e kultit vende të shejta, gjemonumente</li> </ul>
11.	Rigjenerim i Qëndrës Koman	1,2,16	18,000,000	Bashkia Pukë, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve (FZHR); Granti konkurrues për infrastrukturën vendore; Granti konkurrues për kulturën; Donatorë; Kompanitë e sektorit të shërbimeve	Njësia Administrative Qelëz	Bashkia Pukë	X	Dendësia e popullsisë, Numri i modaliteteve të transportit, Pajisja me banesë, Ndryshimet mbi përdorimin e tokës, Akses ndaj shërbimeve	Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rivlerësim i pasurive historike</li> <li>Rikualifikim i fasadave të ndërtesave dhe rritje e eficiencës energjike të tyre</li> <li>Krijim i hapësirave publike (sheshi, parqe, këndë lojtrash)</li> <li>Lidhje të strukturave sociale dhe hapësirave publike nëpermjet rrugëve këmbësore dhe biçikletash për shqyrtëzimin e peizazhit të fshatit dhe sistemim i tyre.</li> <li>Rigjenerim i strukturave sociale (shkollës dhe qendrës shëndetësore)</li> <li>Promovim i fukcioneve mikse dhe shtim i shërbimeve turistike për të mundësuar askesin në pikat kulturore dhe fetare</li> <li>Organizimi i eveneve të përkohshme që promovojnë përdorimin e hapësirave publike të zonës</li> <li>Vizita dhe pelegrinazh në monumentet e kultit vende të shejta, gjemonumente</li> </ul>
12.	Rigjenerim i zonës ish prodhuese ne qytetin e Pukës	7, 16	25,000,000	Bashkia Pukë	Njësia Administrative Pukë	Bashkia Pukë		Punësim, Diversifikim, Lehtësia e të bërit biznes, Shkalla e inovacionit, Bashkëepunimi ekonomik, Përshtatja ndaj nryshimeve dhe faktorëve të jashtëm, Shpenzimi bruto për kërkim dhe zhvillim,	Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit, Sektori i Shërbimeve Publike dhe Emergjencave Civile, Sektori i Burimeve Njerëzore, Sektori i Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë	Nuk ka nevojë për ndryshime.	<ul style="list-style-type: none"> <li>Konvertimi i një zone me përdorime mikse aktivitete ekonomike, institucionale dhe shërbime</li> <li>Sistemin dhe rigjenerim urban i zonës</li> <li>Rikuperim i strukturave ekzistuese</li> <li>Përmirësim i infrastrukturave teknike dhe rrugore</li> </ul>



									Produktiviteti			
13.	Rrethimi e sistemimi i varrezave të qytetit Pukë	16	16,000,000	Bashkia Pukë, Agjensia për Zhvillimin Rajonal	Njësia Administrative Pukë	Bashkia Pukë			Aksesueshmëria në hapësirat publike	Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	Vendim Nr.66 dt. 19.12.2016 Për miratimin e prioriteteve për investime e shërbime në bashkinë Pukë për vitin 2017
14.	Ndërtimi i thertores Pukë	7,16	2,500,000	Bashkia Pukë, Agjensia për Zhvillimin Rajonal	Njësia Administrative Pukë	Bashkia Pukë			Aksesueshmëria në hapësirat publike	Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	Vendim Nr.66 dt. 19.12.2016 Për miratimin e prioriteteve për investime e shërbime në bashkinë Pukë për vitin 2017
15.	Rikonstruksion i tregut të qytetit Pukë, dhe sistemimi i oborrit dhe rrethimi i tij	16,5	5,000,000	Bashkia Pukë, Agjensia për Zhvillimin Rajonal	Njësia Administrative Pukë	Bashkia Pukë			Aksesueshmëria në hapësirat publike	Bashkia - Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit	Nuk ka nevojë për ndryshime.	Vendim Nr.66 dt. 19.12.2016 Për miratimin e prioriteteve për investime e shërbime në bashkinë Pukë për vitin 2017
11.	Agroturizmi përbën një pikë të fortë për bashkinë	<p>Për përballimin e këtij problemi, janë parashikuar një sërë projekteve në Planin e Veprimit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i fermave organike për zhvillim e agroturizmit dhe kutivimin dhe përpunimin e bimëve mjekësore dhe frutave të pyllit në shkallë të vogël në zonat Munellë, Koman, Qelëz, Gomsiqe, Gojan, Shkozë, Lumzi, Dedaj etj.</li> <li>• Promovimi i trajnimeve profesionale për fermerët e rinx</li> <li>• Krijimi i markave të produkteve bujqësore (frutat e pyllit, bimët mjekësore, djathi e deles, produktet e bulmetit)</li> <li>• Trajnim i të rijnve për aftësimin profesional në kuadër të zhvillimit të turizmit malor, duke krijuar specialistë me orientime të ndryshme përf: këshillim e asistim; me qëllim ofrimin e investimeve të qëndrueshme në Bashki</li> </ul>
12.	Të bëhet lidhje e malit Tërbun me Pukën përmes një teleferiku	Do të merret parasysh në fazën e ardhshme, ku projektet e propozuara të Planit të Veprimit do të finalizohen.
13.	<p>Të realizohen lidhje rrugore mes vendbanimeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Qelëz – Fushë Arrëz</li> <li>• Luf- Koman</li> </ul>	Në Planin e Veprimit parashikohet ndërtimi i një segmenti rrugor që do të lidh Qerretin e Madh me Komanin. Fshati Luf lidhet me Qerretin e Madh përmes një rrjeti të asfaltuar rrugor. Me realizimin e këtij projekti do të mundësohet edhe lidhja e vendbanimeve Luf-Koman.
14.	Të parashikohet lidhje mes Fusha e Korit me Levrushkun	Çështja e lidhjes së këtyre dy rajoneve është identifikuar dhe analizuar. Për lidhjen e këtyre zonave, është parashikuar hapja e shtigjeve për këmbësorë.



15.	Treguesi më i rëndësishëm për zhvillimin e Bashkisë është reduktimi dhe lëvizja e popullatës në qytete të tjera.	Këto çështje janë identifikuar dhe analizuar. Propozimet përfundimtare dhe masat e mundshme do të finalizohen në fazën e ardhshme, ku do të propozohen kushtet për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve dhe do të finalizohen projektet e propozuara në Planin e Veprimit.
16.	Të kihen kujdes dhëni e lejeve për të ndërtuar hidrocentrale, për prodhimin e energjisë elektrike pasi janë vërejtur ndikime negative mjedisore.	Këto çështje janë identifikuar dhe analizuar. Propozimet përfundimtare dhe masat e mundshme do të finalizohen në fazën e ardhshme, ku do të propozohen kushtet për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e të gjitha aktiviteteve dhe do të finalizohen projektet e propozuara në Planin e Veprimit.
17.	Të kryhet regjistrimi i gjithë monumenteve historike dhe kulturore me qëllim promovimin dhe shfrytëzimin e tyre	<p>Për përballimin e këtij problemi, janë parashikuar një sërë projektesh në Planin e Veprimit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Konsolidimi i aseteve historike, kulturore dhe shpallja e tyre si monumente kulturore (Xhamia e Koder Hanit, Kisha e Jeremisë)</li> <li>• Ngritje e një sistemi GIS për promovimin e aseteve kulturore dhe historike dhe sportive të Bashkisë</li> <li>• Program i regjistrimit të trashëgimisë kulturore: ndërtesa tradicionale, kisha, xhami, vende arkeologjike</li> </ul>
18.	Të përfshihet Komani si një destinacion turistik dhe të shfrytëzohen monumentet turistike që gjenden përreth kësaj zone.	<p>Për përballimin e këtij problemi, janë parashikuar një sërë projektesh në Planin e Veprimit si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi dhe mirëmbajja e shtigjeve të bicikletave dhe këmbësorëve që lidhin Komanin me monumentet natyrore dhe kulturore përreth tij (Kalaja e Dalmacës, Shpella e Kolikut, Varrezat e lashta të Komanit)</li> <li>• Zhvillim i aktiviteteve nautike në liqenin e Komanit dhe Vaut të Dejës</li> <li>• Krijim i qëndrave për informacionin dhe orientimin e vizitorëve në Bashki të Pukë, Koman</li> </ul>

19.	Të ri-përcaktohen kufijtë e bashkisë dhe të përfshihet Komani brenda kufijve të Bashkisë Puke.	Për hartimin e Planit të Përgjithshëm Vendor merren parasysh kufijtë më të gjerë administrativë që mund të ketë Bashkia. Pas finalizimit të tyre, do të sqarohet se cilat rajone dhe në çfarë sipërfaqe i përkasin Bashkisë.
20.	Gjykohet e nevojshme lidhja e Komanit përmes Qerretit të Madh dhe Qelëz.	Për trajtimin e kësaj çështjeje, është parashikuar ndërtim i rrugës Qerret i Madh-Koman
21.	Pavarësisht prerjeve dhe tregëtimit të drurëve brenda Bashkisë Pukë, ajo nuk gjëzon asnj përfitim nga ky aktivitet.	Për trajtimin e kësaj çështjeje janë parashikuar: Që prej vitit 2015, Këshilli i Ministrave ka miratuar ligjin “Për administrimin e fondit pyjor dhe kullosor kombëtar në Republikën e Shqipërisë”, i cili ndalon kategorikisht eksporti dhe tregtimi i lëndës drusore në masën 100%
22.	Të bëhen kërkesa drejt institucioneve të ndryshme financiare evropiane dhe ndërkombëtare për zhvillimin e kultivimit të bimëve medicinale në toka shterpë të Bashkisë.	Përgjatë planifikimit strategjik dhe përcaktimit të projekteve për zbatimin e strategjisë, propozohen edhe burime financiare për zbatimin e këtyre projekteve, si organizatat evropiane e ndërkombëtare.
23.	Të planifikohet aktiviteti rural në Bashki me bazë burimet prodhuuese të rajonit.	Për përballimin e këtij problemi, janë parashikuar një sërë projektesh në Planin e Veprimit si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Hartimi i planit menaxhimi të qëndrueshëm për bimët mjekësore dhe frutat e pyllit</li> <li>• Hartimi i strategjisë për e bujqësisë vendase</li> </ul>





Foto 3: Zhvillimi i dëgjesës publike, për Fazën e Strategjisë Territoriale, në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Pukë



Foto 4: Zhvillimi i dëgjesës publike, për Fazën e Strategjisë Territoriale, në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Pukë



Foto 5: Zhvillimi i dëgjesës publike, për Fazën e Strategjisë Territoriale, në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Pukë



Foto 6: Zhvillimi i dëgjesës publike, për Fazën e Strategjisë Territoriale, në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Pukë



	Bashkia Puke
Dëgjës Publike	
Prezantimi i Fazës se II-te, ne kuader te Hartimit te Planit te Përgjithshem per Bashkinë Puke	
Puke 25/10/2017	

Nr.	EMER	MBIEMER	POZICION	INSTITUCIONI	NR. TELEFONI	EMAIL
1.	Rustim	Ibrahim			065114784	
2.	Vasil	Pjetri			0622647392	
3.	Taulant	Acim		A KPT	06911116	taulant@dashqimi.pku.al
4.	Zeljka	Hyseni	H.U.PK			
5.	Gjergj	Gjergj		N. Ad. Puke	062844788	
6.	Kadri	Sulejzi	Sp. Ushq.	Albanian	0685567788	
7.	Davion	Hoxha	Sp. Ushq.	B. Puke	0692885123	albanianprojekti@yahoohes.com
8.	Gjermi	Mete	P. Z. B. B. D. G. E. T. D. D. E. K.		0682151881	
9.	Muhamed	Pulemu	Sp. Shpk.	J. Puke	0695053381	schweiz@yahoohes.com
10.	Ergjë	Georgi	J. Puke	J. Puke	069288488	
11.	Gjergj					
12.	Julie	Filipaj	Albanian	Det. uft.	065236118	
13.	Adel	Kurdi		ZPK Kruja	06911625	adeli.kurdi@gmail.com
14.	Gjergj	Dorjet			06911625	gjergj.dorjet@minfin.al
15.	Kerxhej	Nedzlan		Tepuziqaf Bashkia Puke	065315762	
16.						
17.						
18.						
19.						
20.						
21.						
22.						

Foto 7: Listprezenca për Dëgjesën publike, për Fazën e Strategjisë Territoriale, në kuadër të hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Pukë



### **3. TAKIM E FORUMIT TË BASHKËRENDIMIT TË PLANIFIKIMIT VENDOR (FBPV)**

AKPT më datë 14.11.2017 (ditën e martë), në orën 10:30, në ambientet e Hotel Tirana International realizoi takimin e FBPV, ku u diskutua mbi e Planin e Zhvillimit Territorial, Rregulloren e Planit për PPV Vau i Dejës, Klos dhe mbi Strategjinë Territoriale për PPV Pukë, Mirditë, Gramsh, Belsh dhe Dropull.

○ **Pjesëmarrës në takimin e FBPV ne lidhje me Bashkitë Pukë, Mirditë**

➤ *Stafi i AKPT:*

- Adelina Greca – Drejtore e Përgjithshme;
- Fiona Mali – Drejtore e Planifikimit Vendor;
- Ermal Pashollari – Koordinator;
- Glejdi Floku – Koordinator;
- Malvina Ferra – Koordinatore;

➤ *Stafi i Bashkive:*

- Mehill Paçuku – Nënkyrytar, Bashkia Mirditë
- Gjon Gjonaj – Kryetar, Bashkia Pukë
- Eduard Sokoli – Drejtore i Planifikimit, Bashkia Pukë

➤ *Stafi i bashkive kufitare:*

- Anduel Gjinaj – Drejtoria e Planifikimit, Bashkia Fushë-Arrëz;
- Tonin Prenga – Drejtoria e Planifikimit, Bashkia Fushë-Arrëz.

➤ *Stafi i Ekipave Konsulente “GAIA S.A. MELETON”*

- Elena Petsani
- Panagiotis Zacharos
- Diana Bardhi
- Etmira Kanani
- Elton Toska
- Georgios Bellas

➤ *Stafi i Ekipave Konsulente “UTS-01” e bashkisë Vau i Dejës*

- Roberto Mascarucci
- Mario Eboli
- Edmond Pergega
- Markel Baballiku

➤ *Përfaqësues nga institucione të tjera:*

- Mariglen Lena – AdZM Dibër;
- Ndoc Mulaj – Qendra Alpe;
- Festim Hoxha – DRKK Shkodër
- Fabjola Meçaj – FSHZH;
- Ilir Shyti – PPNEA;
- Arbjona Bala – IMK;
- Greta Alikaj – MTM;
- Enkeleda Vehbi – MTM;
- Taulant Dibra – AZHR 1;



- Gjon Laska – AZHR 1;
- Pjetër Tani – AdZM Lezhë;
- Suela Kavaçi – Qarku Lezhë;

### ○ Rreth takimit të FBPV

Hapjen e takimit e bëri Drejtoresha e Përgjithshme e AKPT-së, Znj. **Adelina Greca**, duke theksuar shkurtimisht rëndësinë dhe arsyet e organizimit të Forumit për Bashkërendimin e Planifikimit në Nivel Vendor. Më pas u vijua me prezantimin e pjesëmarrësve.

### ○ Rreth PPV për Bashkitë Pukë dhe Mirditë

Prezantimin e filloi përfaqësuesi i studios konsulente, **Z. George Bellas**, i cili fillimisht bëri një përbledhje të gjendjes ekzistuese dhe potencialeve të të dy bashkive Pukë & Mirditë dhe më pas u vijua me prezantimin e Strategjisë Territoriale për secilën nga bashkitë sipas temave të mëposhtme:

- Përbledhje e gjendjes ekzistuese;
- Direktivat e marra nga PPK;
- Hartat e 5 Sistemeve dhe konvertimet e pritshme midis tyre;
- Profili i bashkive Pukë dhe Mirditë;
- Metabolizmi;
- Vizioni;
- Objektivat Strategjikë;
- Plani i Veprimit;
- Projektet Pilot.

### ○ Diskutim

Pas prezantimit, Znj. Adelina Greca ftoi pjesëmarrësit për të diskutuar mbi materialin e prezantuar për bashkitë Pukë dhe Mirditë, ku disa nga çështjet e diskutuara kishin të bënин me:

- Rëndësinë e pjesëmarrjes së aktorëve në procesin e hartimit të PPV. Duke sqaruar faktin se kjo pjesëmarrje e aktorëve duhet të jetë përgjatë hartimit të Plani të Përgjithshëm Vendor si dhe jo në momentin e fundit kur plani është në fazën e miratimit.
- Studio konsulente e bashkisë Vau i Dejës: *Në PPV Vau i Dejës është propozuar një Park Rajonal në luginën e Drinit dhe mbështetur ky propozim do të shtrihet edhe në bashkinë Pukë.*  
Z. Bellas sqaroi se ky propozim do të shqyrtohet për të propozuar zgjerimin e këtij parku edhe në territorin e luginës së lumit Drin në territorin e bashkisë Pukë.
- Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit: *Si është menduar të realizohet trajnimi i njerëzve në këtë zonë në lidhje me zhvillimin e turizmit?*



Z. Bellas sqaroi se këto trajnime do të mundësohen duke sjellë ekspertë të jashtëm për të organizuar seminare disa javore me tematike specifike, por dhe duke ngritur qendra për trajnimin e të rinjve.

- Bashkia Fushë-Arrëz: *Bashkia Fushë-Arrëz, si bashki kufitare, do të ketë përfitimet e saj në fushën e turizmit, me zhvillimin e turizmit në bashkitë Pukë dhe Mirditë. Gjithashtu një çështje tjeter e vlerësuar nga kjo bashki ishte dhe kujdesi i treguar në hartimin e PPV-së mbi mbrojtjen e Rrëqebullit, e cila është një specie në zhdukje.*
- AZHR 1: *Komunikimi me studion konsulente mbi shkëmbimin e informacionit dhe njohurive për bashkitë Pukë dhe Mirditë, ka qenë i vazhdueshëm. Gjithashtu ai vlerësoi këtë proces duke i cilësuar Planet e Përgjithshme Vendore si mundësi për ti kthyer vlerat e vërteta që meritojnë këto zona.*



Foto 8: Takim e Forumit të Bashkërendimit të Planifikimit Vendor





Foto 9: Takim e Forumit të Bashkërendimit të Planifikimit Vendor



#### **4. TREGUESIT E MONITORIMIT DHE VLERËSIMIT**

Treguesit e monitorimit dhe vlerësimit të zhvilluar më poshtë synojnë të krijojnë një sistem "Menaxhim përmes Objektivave" me qëllim që të arrihet një veprimitari më efikase e shërbimeve dhe një reagim më i mirë i burimeve njerëzore në lidhje me nevojat moderne dhe standartet e reja të qeverisjes.

##### **Qëllimi**

Qëllimi i "Menaxhimit përmes Objektivave" është matja e efikasitetit dhe efektivitetit të Menaxhimit, përmes të cilit arrihet vlerësimi i shërbimit.

Zbatimi i modelit "Menaxhimi përmes Objektivave" synon arritjen e objektivave të mëposhtme:

- A) shërbimi i qytetarëve
- B) rritjen e besimit të qytetarit dhe plotësimin e nevojave të tij nga administrata
- C) rritjen e transparencës
- (D) përdorimin më të plotë të burimeve në dispozicion
- (E) ushtrimin i administratës në dobi të qytetarit.

##### **Metodologjia**

Matja e efikasitetit dhe efektivitetit të një autoriteti lokal arrihet përmes përcaktimit të objektivave. Proçesi i përcaktimit të objektivave që duhet ndjekur nga një autoritet lokal është si më poshtë:

- (A) Me vendim të tij Kryetari i Bashkis bën të ditur dhe i cakton shërbimeve të tij objektivat strategjike për vitin e ardhshëm. Objektivat strategjikë vjetorë janë në përputhje me objektivat e Programit Operacional të miratuar nga Këshilli Bashkiak.
- B) drejtuesit e drejtorive kryejnë, fillimihst, një analizë të objektivave strategjikë të mësipërm, informojnë departamentet vartëse të tyre dhe kërkojnë prej tyre të identifikojnë objektivat specifike të çdo departamenti.
- C) Drejtorët e departamenteve përcaktojnë kontributin e çdo punonjësi në arritjen e objektivave të departamentit. Objektivat individuale përcaktohen në përputhje me funksionet e njësisë ku punonjësi shërben, pasi janë marrë parasysh aftësitë, njohuritë dhe përvojat e tij.

Në çdo nivel hierarkik, objektivat përcaktohen dhe pasqyrohen në një plan veprimi specifik pas bashkëpunimit dhe marrëveshjes ndërmjet mbikëqyrësit dhe vartësit. Nëse nuk arrihet marrëveshje, drejtuesi përkatës do të vendosë në përputhje me rrethanat.

Treguesit e monitorimit dhe vlerësimit janë të ndara në tregues të përgjithshëm dhe specifik.

Treguesit e përgjithshëm janë: koha për t'u përgjigjur kërkesave të qytetarëve, shkalla e kënaqshmërisë së ankesave të paraqitura, zbatimi i teknologjive të reja, kostot e menaxhimit dhe cilësia e shërbimeve të ofruara.

Treguesi i veçantë mund të aplikohet për secilin segment veç e veç dhe korrespondon me llojin e shërbimeve që ofron.



Ky departament ka detyrimin të hartojë raporte të matjeve individuale, në baza vjetore, një raport mbi veprimet e tij. Raportet e mësipërme i dorëzohen kryetarit të bashkisë dhe do t'i komunikohen Këshillit Bashkiak brenda një muaji nga paraqitja e tyre.

### **Kategoritë themelore të treguesve të monitorimit dhe vlerësimit**

Treguesit e monitorimit ndahen në dy kategori kryesore, përkatësisht:

- A) Tregues rezultatesh, përmes të cilëve monitorohet arritja e objektivave të përcaktuara nga programi operativ.
- B) Treguesit e hyrjes dhe të daljes, përmes të cilës monitorohet zbatimi i veprimeve bashkiake.

Nëpërmjet përpunimit dhe shfrytëzimit të rezultateve të dy kategorive të mësipërme, rezulton një kategori e tretë e treguesve të cilët janë quajtur tregues të vlerësimit të efikasitetit dhe efektivitetit të operimit dhe si rrjedhim të progresit të programit operacional.

Më poshtë është një përshkrim i shkurtër i karakteristikave të kategorive kryesore të treguesve të monitorimit dhe vlerësimit:

#### **Tregues rezultatesh**

Treguesit e rezultateve përdoren për të monitoruar objektivat e përgjithshme dhe specifike të programit operativ, me këta tregues vlerësohet efektiviteti i veprimeve të programit operativ.

Treguesit e rezultateve ndahen në katër nënkategori:

1. Tregues të zhvillimit dhe përfitimeve
2. Tregues të aktiviteteve dhe shërbimit të qytetarit
3. Tregues të infrastrukturës njerëzore dhe logistike
4. Tregues Ekonomikë

Komponentët që përbëjnë treguesit e rezultateve janë madhësi sasiore të përzgjedhur në mënyrë të përshtatshme ose lloje të dy variablate sasiorë. Me këtë mënyrë maten (direkt ose indirekt) karakteristikat e situatës aktuale të rajonit dhe mjedisit të brendshëm të bashkisë, duke ndjekur kështu ndryshimet e tyre gjatë zbatimit të veprimeve që pasqyrohen në programin operacional. Përveç kësaj, duke përdorur treguesit e rezultateve, arrihet kuantifikimi i objektivave të përgjithshme dhe specifike të programit operacional, me qëllim që të lehtësohet monitorimi i progresit të arritjes së tyre.

#### **Tregues të zhvillimit dhe përfitimeve**

Me këta tregues mund të maten rezultatet e aktiviteteve si tek marrësit (përfituesit) ashtu edhe tek zona (ndikimet zhvillimore) e bashkisë.

## Treguesit e Zhvillimit Lokal

Përmes përdorimit të treguesve të zhvillimit lokal është e mundur të vlerësohen kushtet ekzistuese mjedisore, sociale dhe ekonomike në zonën e bashkisë dhe të vlerësohet ndikimi i ndërhyrjeve të planikuara në zonë.

Treguesit e zhvillimit ndihmojnë në matjen e rezultateve të zhvillimit (ndikimeve) të aktiviteteve të të gjithë aktorëve që veprojnë në zonën e bashkisë. Bashkia nuk ka përgjegjësinë ekskluzive për zhvillimin e rajonit të saj, pasi zhvillimi i një zone nuk varet vetëm nga funksionimi i tyre. Por Bashkia është përgjegjëse për monitorimin zhvillimit të rajonit, për identifikimin e problemeve dhe mundësive për aktivizimin dhe koordinimin e të gjitha palëve të interesit me qëllim të përzgjedhjes së bashku të prioritetetëve të zhvillimit dhe zbatimin e ndërhyrjeve për arritjen e prioriteteve.

Treguesit e zhvillimit korrespondojnë me fushat tematike të analizës së zonës së Bashkisë dhe ndahanë në:

- Treguesit e mjedisit natyror dhe rezidencial, p.sh. përqindja e hapësirës së gjelbër urbane ose përqindja e hapësirave komunale në një qytet
- Treguesit socialë siç janë treguesit demografikë, vdekshmëria, krimi, papunësia etj.
- Treguesit ekonomikë, p.sh. të ardhurat për banor, struktura e punësimit, investimet lokale etj

Forma e përgjithshme e treguesve të ndikimit të zhvillimit është:

Vlera përfundimtare e një karakteristike të rajonit

Vlera fillestare e karakteristikës së rajonit

## Treguesit e përfitimeve

Rezultatet e cilësisë nga shërbimet bashkiake të ofruara për përdoruesit në kontekstin e zbatimit të planit të veprimit të Bashkis mund të maten nga këta tregues. Me këtë mënyrë matet ndryshimi i situatës në dobi të përdoruesve. Forma e përgjithshme e këtyre treguesve është:

## Vlera përfundimtare e një karakteristike të përdoruesve

Vlera fillestare e karakteristikës së përdoruesve

Për shembull:

- Rritje e të ardhurave të fermerëve
- Rritje e vlerës së pasurisë së patundshme në një lagje

Në disa raste, përfitimet maten përmes numrit të përdorueve përfitues. Forma e përgjithshme e këtyre treguesve është:

Numri i përdoruesve të përfituar

Numri total i përdoruesve

Për shembull, përqindja e të trajnuarve që kanë gjetur punë pas një programi trajnimi të organizuar nga një bashki.



### Treguesit e kënaqshmërisë të marrësve

Këta tregues masin shkallën e kënaqësisë së përfituesve (përdoruesve dhe jo përdoruesve) të shërbimeve bashkiake të ofruara. Përllogaritja e treguesve do të bëhet nga të dhënat e mbledhura përmes anketave periodike të pikëpamjeve të marrësve.

Numri i marrësve të kënaqrur

Totali i marrësve

### Treguesit e shpërndarjes së daljeve të aktiviteteve tek përfituesit

Këta tregues masin shkallën e shpërndarjes së daljeve të aktiviteteve në mesin e grupeve të ndryshme sociale ose gjeografike të pranuesve (p.sh. në njësitë administrative). Me rëndësi të veçantë është shpërndarja e daljeve në grupet e pafavorizuara të popullsisë (me të ardhura të ulëta, të papunë, të moshuar, etj.). Për shembull, "Numri i përdoruesve të pafavorizuar/Numri i individëve të pafavorizuar"

### Treguesit e aktiviteteve dhe shërbimit të qytetarit

Përshtatshmëria, cilësia, niveli i shërbimit të qytetarit, si dhe efikasiteti i aktiviteteve të kryera nga Bashkia maten nga treguesit e aktiviteteve dhe shërbimit të qytetarit.

### Treguesit e përshtatshmërisë sasiore të aktiviteteve

Korrelacioni i sasisë së mallrave të prodhua ose numrit të shfrytëzuesve të shërbyer me kërkësen, me qëllim për të vlerësuar përshtatshmërinë e shërbimeve të ofruara, bëhet duke përdorur treguesit e mjaftueshmërisë sasiore të aktiviteteve.

Për shembull, numri i fëmijëve parashkollarë të shërbyer nga kopshti në raport me numrin e kërkësave.

### Treguesit e përdorimit të shërbimeve nga marrësit

Shkalla e përdorimit (shfrytëzimi) të shërbimeve të ofruara nga përfituesit përllogaritet me treguesit e përdorimit të shërbimeve nga marrësit.

Forma e përgjithshme e këtyre treguesve është:

### Numri i përdoruesve (marrës të shërbyer)

Totali i marrësve

Për shembull, numri i të moshuarve të shërbyer nga një strukturë.

### Tregues të cilësisë dhe shërbimit ndaj qytetarit

Këta tregues masin karakteristikat e ndryshme të punëve/shërbimeve të ofruara dhe të proceseve të tyre të prodhimit, p.sh. koha e shërbimit, qasja, saktësia dhe besueshmëria, thjeshtësia e procedurave, ankesat e përdoruesve etj.

Më konkretisht, sipas karakteristikave cilësore të punëve/shërbimeve të ofruara mund të përllogariten madhësi të ndryshme, njohuritë e të cilave do të mund të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve të ofruara nga Bashkia. Për shembull:

Koha e shërbimit



- Koha mesatare e dorëzimit të produktit të një shërbimi bashkiak (p.sh. leje ndërtimi, lëshimi i certifikatave të ndryshme, dokumenteve, etj)
- Koha mesatare e reagimit të shërbimeve ndaj kërkesave të qytetarëve për informata të ndryshme
- Koha mesatare e përgjigjes për ankesa mbi dëmtime ose probleme të funksionimit të rrjeteve, rrugëve
- Koha mesatare e reagimit në rast emergjencë (borë, përmbytje, tërmete, etj)
- Koha mesatare e pritjes në radhë
- Dorëzimi në kohë i një projektit

#### Aksesueshmëria

- Orari i funksionimit të një shërbimi brenda 24 orëve dhe javës.
- Përqindja e përdoruesve që jetojnë në një rreze shërbimi të caktuar ose që kanë nevojë për një kohë të caktuar për të arritur pikën e shpërndarjes së shërbimit duke përdorur një mjet të caktuar të transportit.
- Saktësia dhe besueshmëria
- Përqindja e përgjigjeve të pasakta në informacionin e dhënë qytetarëve
- Përqindja e gabimeve në certifikatat, dëshmitë, dokumentet e ndryshme
- Numri i thirrjeve për shkak të dështimeve të rrjeteve të ndryshme, projekteve, instalimeve
- Thjeshtësia e procedurave
- Numri i kontakteve të nevojshme që duhet të kryejë qytetari me departamente ose punonjës të ndryshëm për të trajtuar një rast
- Numri i takimeve të nevojshme të qytetarëve në Autoritetet Lokale
- Numri i procedurave administrative të proceduara me telefon ose me e-mail ose faks

#### Ankesa të përdoruesve

##### Numri i përdoruesve me ankesa

##### Totali i përdoruesve

(Tek treguesi mund të kryhet qasje analitike duke dalluar ankesat sipas kategorive të tillë si jo-shërbimi, koha e gjatë e pritjes, sjellja e keqe e punonjësve etj. ose për shërbim të Autoritetet Lokale)

##### Treguesit e efikasitetit (ekonomisë dhe produktivitetit) të aktiviteteve

Këta tregues matin sasinë e burimeve njerëzore dhe materialeve të shpenzuara për prodhimin e mallrave/shërbimeve ose matin koston e prodhimit të mallrave/shërbimeve të Autoritetet Lokale.



##### Treguesit e infrastrukturës njerëzore dhe logistikës

Këta tregues i referohen rezultateve të menaxhimit të burimeve të autoriteve vendase dhe në varësi të llojit të burimeve, ndahen në:

- Tregues të burimeve njerëzore (stafi civil dhe nëpunësve të shërbimit)



- Tregues të kompjuterizimit
- Tregues të automjeteve dhe pajisjeve elektronike,
- Tregues të objekteve të ndërtimit

Shembull treguesish

#### Tregues personeli

- Totali i personelit/popullsisë së rajonit të Bashkisë
- % e mbulimit të vendeve organike bosh të çështjeve ekonomike dhe tregtare
- Përqindja e nëpunësve me arsim të lartë universitar
- Numri i orëve për person të trajnimit për çdo vit

#### Tregues të kompjuterizimit

- Numri i përdoruesve të PC/totali i personelit që punojnë në zyra
- Përqindja e përdoruesve të PC deri në tre vjet
- Operacione të kompjuterizuara/totali i operacioneve që mund të kompjuterizohen

#### Tregues të menaxhimit të automjeteve

- Mosha mesatare e çdo automjeti
- Automjete të reja – automjete të larguara/Totali i automjeteve

#### Tregues financiaro-ekonomik

Për matjen e rezultateve ekonomike përdoren :

- Tregues të ardhurash – shpenzimesh (Treguesit e strukturës dhe zhvillimit në afat kohor të të ardhurave dhe shpenzimeve, Tregues të kohezionit të ardhurave dhe shpenzimeve)
- Treguesit e buxhetit - raportimit (Treguesit e divergjencave midis shifrave financiare të buxhetuara dhe përmasave financiare të raportuara)
- Treguesit e likuiditetit
- Treguesit e huasë
- Treguesit e investimeve

#### Shembuj të treguesve ekonomikë

- Totali i të Ardhurave të Zakonshme / Totali i të Ardhurave
- Hyrjet rregullta/Të ardhurat totale
- Kostoja totale e stafit / shpenzimet totale
- Shpenzimet për investimet / Shpenzimet totale
- Shpenzimet për amortizimin / Të ardhurat e përgjithshme të rregullta
- Të ardgzra të arkëtuara / Të ardhura të vërtetuara

#### **Treguesit e daljeve dhe hyrjeve**

Monitorimi i zbatimit të veprimeve të programit operativ kërkon krijimin e treguesve për hyrjet dhe daljet e veprimeve.

#### Treguesit e hyrjeve dhe të daljeve:

Përmasa sasiore që matin progresin e një veprimi duke matur hyrjet e produhuara ose daljet (burimet) të konsumuara për zbatimin e veprimit, gjatë një periudhe kohore. Përdorimi i këtyre treguesve synon kryerjen e kontrollit nëse veprimet e programit po zbatohen në mënyrë korrekte, dmth. nëse prodhohet sasia e dëshiruar e daljeve (mallrave dhe shërbimeve) në kohën e duhur dhe me kosto të ulët.

Programi zbatohet përmes programit vjetor të veprimit të Bashkisë dhe personave juridikë të saj të mbikëqyrjes.

Daljet janë rezultatet operacionale të funksionimit të një bashkie, e cila në fillim të çdo viti duhet të kuantifikohen dhe të pasqyrohen në planin vjetor të veprimit të bashkisë (objektiva operacionale).

Treguesi më i shpeshtë i të hyrjeve janë shpenzimet e zbatimit të një veprimi, të cilat në fillim të çdo viti duhet të përllogariten dhe të pasqyrohen në buxhetin e bashkisë.

#### Treguesit e efikasitetit dhe efektivitetit

Si efektivitet përcaktohet arritja e objektivave specifike dhe të paracaktuara dhe si efikasitet përcaktohet maksimizimi i rezultateve nga veprimet e Bashkisë me burimet e dhëna.

Me synim të vlerësohet efektiviteti dhe efikasiteti i aktiviteteve të bashkisë, treguesit e hyrjeve, daljeve rezultateve për të zhvilluar tregues efikasiteti dhe efektiviteti vlerësohen me këtë mënyrë:

#### Efikasiteti

Forma e përgjithshme e treguesve të efikasitetit është:

Përmasa të realizura të daljeve ose rezultateve

Përmasa të realizura të daljeve apo rezultateve

Me treguesit e efektivitetit, gjejnë përgjigje pyetjet e mëposhtme:

-Çfarë kemi arritur në lidhje me qëllimet (rezultatet e dëshiruara)

-Çfarë kemi arritur në lidhje me veprimet (daljet e planifikuara)

#### Efektiviteti

Forma e përgjithshme e treguesve të efektivitetit është:

Përmasat e realizura të daljeve apo rezultateve të kostos, bjurime ose koha e shpenzuar për prodhimin e daljeve apo rezultateve

Me treguesit e efektivitetit gjejnë përgjigje pyetjet e mëposhtme:

- Sa njerëz dhe burimet materiale u konsumuan për të siguruar dalje
- Si u formësua kostoja për njësi daljeje
- Çfarë kemi arritur në lidhje me afatet kohore për zbatimin e veprimeve

Duke përfunduar këtë kapitull, gjyket që theksohet se të gjithë treguesit e mësipërm të rezultateve dhe të zbatimit (daljet) përbëjnë propozim dhe treguesit që përfundimisht do të përdoren për të monitoruar objektivat strategjike të përcaktuara.



por edhe për efektivitetin e shërbimeve bashkiake do të përcaktohet me vendim të autoriteteve bashkiake, siç edhe parashikohet.

Në lidhje me vlerat e synuara, gjithashtu do të përcaktohen me të njëjtën vendim të autoriteteve, të cilat duhet të janë subjekt i monitorimit të vazhdueshëm të Zyrës së Pavarur për Planifikimin, Zhvillimin, Efikasitetin dhe Cilësinë. Për përcaktimin më të saktë të vlerës së synuar, do të duhet të përcaktohen vlerat bazë, kur kjo është e mundur.

Shkalla e zbatimit do të përbëjë një rast rishikimi të vlerave, pasi do të duhet të përmbushin kushtet reale që mbizotërojnë si në mjedisin e brendshëm (shërbime) të bashkisë ashtu edhe në ambientin e jashtëm (komuniteti lokal).

Në këtë pjesë mblidhen dhe përcaktohen kushtet bazë të përdorura dhe kanë të bëjnë me përpilimin e treguesve për monitorimin e treguesve të programit të bashkisë.

- **Rajoni i bashkisë**

Njësia gjeografike e kufizuar që përbën territorin rajonal të Bashkisë.

- **Zhvillimi lokal**

Përmirësimi i karakteristikave të rajonit të bashkisë (natyrore, të banimit, ato sociale, kulturore dhe ekonomike) me qëllim përmirësimin e mirëqenies dhe cilësisë së jetës së banorëve të zonës.

- **Shërbimet bashkiake**

Njësitë administrative të mekanizmit zyrtar të një bashkie dhe personave juridikë të saj, që janë përgjegjës për zbatimin e planeve të veprimit të programit operativ. Shërbimet e bashkisë dhe të personave të saj juridikë ndahen dhe dallohen shërbime kryesore dhe shërbime mbështetëse.

**Kryesore**, janë shërbimet përmes të cilave ushtrohen përgjegjësitet e bashkisë. Shërbimet kryesore janë të ndara në shërbime horizontale dhe shërbime vertikale

**Vertikale** janë shërbimet kryesore përmes të cilave ushtrohen përgjegjësitet e bashkisë në një fushë tematike të zhvillimit lokal. Shërbimet vertikale prodhojnë shërbime dhe mallra publike për të përmbushur nevojat e përfshutesve, me qëllim final zhvillimin e një sektori të aktivitetit në bashki (p.sh. shërbimet sociale, mbrojtja e mjedisit, punësimi etj.).

**Horizontale**, janë shërbimet kryesore nëpërmjet të cilave ushtrohen përgjegjësitet e përgjithshme të bashkisë. Këto shërbime u drejtohen të gjithë qytetarëve në përgjithësi dhe janë horizontale në kuptimin e përfshirjes së tyre në të gjitha fushat e aktiviteteve të rajonit (p.sh. shërbimi administrativ për qytetarët, policia bashkiake, mbrojtja civile)

**Mbështetëse**, janë shërbimet që mbështesin funksionimin e shërbimeve kryesore të Bashkisë dhe organeve administrative (p.sh. Shërbimi Financiar, Shërbimi Ligjor, Shërbimi i IT, Shërbimi i Programimit). Roli i tyre është të sigurojnë burime (p.sh. të ardhurat, materialet, pajisjet, personeli, informacioni, njojuritë) dhe të ofrojnë shërbime mbështetëse (p.sh. menaxhimi i personelit, menaxhim ekonomik, furnizime

materialesh dhe pajisjesh, mbështetje administrative, mbështetje ligjore, dokumentim informacioni etj.)

- **Marrësit e shërbimeve**

Janë grupet e synuara të aktiviteteve të shërbimit, për të cilat do të lindin përfitime të drejtpërdrejta ose të tërthorta (përfituesit).

Marrësit të shërbimeve kryesore janë ndarje territoriale të zonës së bashkiaë (njësi bashkiakë, lagje të një qyteti) ose grupe socio - ekonomike të popullsisë (të rinjtë, të rriturit, të moshuarit, fermerët) ose grupe të aktorëve dhe organeve lokalë.

Shërbimi horizontal i shërben qytetarëve në shërbimet e përgjithshme dhe mbështetëse dhe shërbimet mbështetëse i shërbejnë organeve drejtuese dhe gjithë shërbimeve bashkiakë (marrës të brendshëm).

- **Entitet Juridike të bashkisë**

Entitetet juridike të së drejtës publike dhe institucionet bashkiakë, sipërmarrjet publike, sipërmarrjet private bashkiakë të së drejtës private dhe shoqëritë anonime bashkiakë

- **Ambienti i brendshëm**

Karakteristikat funksionale, organizative dhe ekonomike të një bashkie dhe të personave të saj juridikë si organizata. Mjedisi i brendshëm përshkruhet dhe vlerësohet në sektionet e mëposhtme:

Aktivitete dhe procedura funksionimi

Organizimi dhe Partneritetet

Burimet njerëzore dhe infrastruktura e logistikës

Ekonomike

- **Zhvillimi i brendshëm**

Përmirësimi i karakteristikave të mjedisit të brendshëm të Bashkisë dhe subjekteve të tij juridike, me qëllim përmirësimin e efikasitetit, efektivitetit dhe legjimitetit të funksionimit të tyre.

- **Efikasiteti**

Kriteri për vlerësimin e funksionimit të një bashkie, që vlerëson se sa daljet dhe rezultatet e veprimit të Bashkisë devijojnë nga objektivat e përcaktuara në Programin Operacional. Me fjalë të tjera, efikasiteti vlerëson përshtatshmërinë dhe cilësinë e daljeve, si edhe rezultatet (përfitimet) të krijuara nga veprimi i bashkisë.

- **Efektiviteti**

Kriteri për vlerësimin e funksionimit të një bashkie, i cili vlerëson nëse veprimet e bashkisë jepin maksimumin e mundshëm të rezultatit me koston minimale të mundshme dhe në kohën minimale të mundshme.

- **Legalizimi**

Kriteri për vlerësimin e funksionimit të bashkisë, i cili vlerëson objektivat e bashkisë në lidhje me nevojat, vlerat dhe pritjet e të gjithë atyre që janë të përfshirë në mjedisin e Jashtëm dhe të brendshëm të bashkisë.



Në mënyrë që të sigurohet legjitimiteti i funksionimit të një bashkie, kërkohet një geverisje lokale e hapur, e përgjegjshme, transparente, pjesëmarrëse dhe e ndershme.

- **Vlerësimi i situatës aktuale**

Një proces në të cilin identifikohen karakteristikat pozitive dhe negative të zonës dhe mjedisit të brendshëm të një bashkie, së bashku me identifikimin e faktorëve pozitivë dhe negativë të mjedisit të jashtëm.

Vlerësimi i situatës identifikon:

Problemet: Karakteristikat e zonës dhe mjedisit të brendshëm të bashkisë, të cilat vlerësohen negativisht pasi ato janë pengesa për përbushjen e misionit të bashkisë

Mundësitë: Karakteristikat e zonës dhe mjedisit të brendshëm të bashkisë, të cilat vlerësohen pozitivisht, sepse nëse ato përdoren ato do të lejojnë që Bashkia të kryejë më mirë veprimtarinë e saj

Vlerësimi i situatës së mjedisit të jashtëm identifikon Mundësitë dhe Reziqet ose Kufizimet.

Shanset: faktorët, kushtet, tendencat dhe zhvillimet në mjedisin e jashtëm që vlerësohen pozitivisht, sepse nëse ato përdoren, ato do të lejojnë bashkinë të kryejë më mirë veprimtarine e vet

Kufizimet ose reziqet: faktorët, kushtet, tendencat dhe zhvillimet në mjedisin e jashtëm që vlerësohen negativisht si pengesa ose kërcënime për përbushjen e misionit të bashkisë

- **Mjedisi i jashtëm**

Totali i faktorëve ekonomike, teknologjike, sociale dhe politike në nivel rajonal, prefektural, kombëtar dhe ndërkombëtar që ndikojnë në zhvillimin e rajonit dhe mjedisin e brendshëm të bashkisë.

- **Çështjet kritike**

Problemet e pakta në numër dhe (të rëndësisë strategjike) të rëndësishme të rajonit të dhe mjedisin e brendshëm të bashkisë, të cilat duhet të përballojë bashkia në periudhën e ardhshme, duke përfituar nga mundësitë dhe shanset e ofruara. Nga ana tjetër, çështjet kritike janë mundësitë dhe shanset e rëndësishme që Bashkia duhet të përdorë në periudhën e ardhshme për të adresuar problemet dhe pengesat.

Çështjet kritike lindin nga vlerësimi i situatës aktuale të zonës dhe mjedisit të brendshëm të Bashkisë dhe dallohen në çështjet e zhvillimit lokal dhe çështjeve të zhvillimit të brendshëm.

- **Strategjia**

Një grup koherent i objektivave të përgjithshme dhe politikave të veprimit të hartuara për të përbushur misionin dhe për të arritur vizionin e bashkisë. Formimi i një strategie të qytetit do të thotë:

(A) identifikimi i çështjeve kritike të zhvillimit lokal me të cilat ballafaqohet bashkia (objektivat e përgjithshme të zhvillimit lokal) dhe

B) zhvillimin dhe krijimin e zgjedhjeve të duhura të brendshme strategjike që do të sigurojnë një qasje të suksesshme të përgjithshme në objektivat e mësipërme lokale të zhvillimit (veprim dhe politikat e përgjithshme objektivave të zhvillimit të brendshëm).

Strategjia është korniza për hartimin e planeve të veprimit dhe duhet të jetë në përputhje me misionin, vizionin dhe parimet e funksionimit dhe qeverisjes së bashkisë.

- Objektivat e përgjithshme

Ndryshimet e vazdueshme në situatën aktuale të zonës dhe mjedisit të brendshëm të bashkisë, me qëllim përbushjen e misionit dhe arritjen e vizionit të bashkisë.

Ato korrespondojnë me çështjet kritike që organet qeverisëse vendosin të trajtohen nga bashkia gjatë katër viteve të ardhshme dhe janë të specializuar me qëllim identifikimin e objektivave specifike të një plani veprimi.

Për të arritur një objektiv të përgjithshëm caktohet departamenti përkatës, i cili harton planin përkatës të veprimit.

Në varësi të qëllimit të tyre, objektivat e përgjithshëm dallohen nga objektivat e përgjithshme të zhvillimit lokal dhe objektivat e përgjithshme të zhvillimit të brendshëm.

Në varësi se sa shërbime vertikale janë të përfshira në arritjen e tyre, qëllimet e përgjithshme të zhvillimit lokal dallohen në sektoriale dhe ndër - sektoriale.

Objektivat e përgjithshme relevante janë grupuar në prioritete - Masa dhe masat e ndërlidhura janë grupuar në prioritete më të përgjithshme - Akse.

Objektivat e përgjithshme, Masat dhe Akset përbëjnë një tabelë hierarkike (pema e prioriteteve), në të cilën bëhet specializimi gradual i misionit dhe vizionit të Bashkisë

- Qëllimet sektoriale

Objektivat e përgjithshme të zhvillimit lokal që korrespondojnë me objektin e një shërbimi vertikal, i cili është përgjegjës për arritjen e tyre dhe rrjedhimisht përgatitjen e planit përkatës të veprimit.

- Qëllimet ndër - sektoriale

Objektivat e përgjithshme të zhvillimit lokal, për arritjen e të cilave kërkohet koordinimi i veprimit të dy ose më shumë shërbimeve vertikale ose mundësish strukturave të tjera jashtë bashkisë. Objektivat ndërsektoriale kanë të bëjnë me çështje shumë të rëndësishme që shkojnë përtej kompetencave të departamenteve individuale të Bashkisë. Ata gjithashtu mund të tejkalojnë kompetencat e Bashkisë, sepse Autoritete Lokale kanë përgjegjësi të kufizuara ose nuk ekzistojnë në këtë çështje.



- **Veprime politike**

Udhëzime të përgjithshme drejtuese, orientojnë ose kufizojnë vendimet operative të drejtorive gjatë përzgjedhjes së veprimeve të planeve të veprimit. Ato janë formuluar në seksionet e mëposhtme:

Aktivitete dhe procedura funksionimi

Organizim dhe Partneritet

Burimet njerëzore dhe infrastruktura e logistikës

Ekonomike

- **Plani i veprimit**

Një grup koherent i objektivave dhe veprimeve që synojnë arritjen e një objekti të përgjithshëm. Një plan veprimi përfshin:

(a) objektivat që lidhen me përbushjen e nevojave të përfituesve dhe zhvillimin e brendshëm të shërbimit që është përgjegjës për objektivin e përgjithshëm, (b) veprimet e grupuara në modulet e mëposhtme:

Aktivitete dhe procedura funksionimi

Organizim dhe Partneritete

Burimet njerëzore dhe infrastruktura e logistikës

Ekonomike

- **Qëllimet**

Përshkruajnë rezultatet e pritshme të një plani veprimi dhe lidhen me përmirësimet në situatën e përfituesve ose me përmirësimet e situatës së shërbimit kompetent (objektiva të zhvillimit të brendshëm).

- **Veprimi**

Totali i veprimeve të kryera nga shërbimet ose organet e menaxhimit të bashkisë, konsumojnë burime (hyrje) dhe prodhojnë dalje, të cilat synojnë arritjen e një ose më shumë objektivave të një plani veprimi.

Veprimet ndahen në funksione dhe projekte domethënë veprime vazhdimesh të përsëritura, me një kohë fikse të fillimit dhe fundit të zbatimit.

Veprimet e një plani veprimi duhet të jenë në përputhje me politikat përkatëse.

- **Veprimet**

Komponentët e një veprimi (operacioni ose projekt).

- **Funksionimi**

Veprimtari e vazhdueshme përsëritëse të departamenteve ose organeve administrative të një bashkie, që zbatohet përmes një sërë veprimesh.

Operacionet e vazhdueshme mund të përfshijnë: a. Funksionet kryesore b. Funksionet mbështetëse,

Veprimet individuale të një funksioni mund të grupohen në procese që janë pjesë të dallueshme të objektit të përgjithshëm të funksionit.

- Procedura

Një rend i veprimeve vazhdimesht të përsëritura (njerëzore ose mekanike) që përbëjnë pjesë të dallueshme të objektit të përgjithshëm të një operacioni.

- Hyrjet

Janë faktorët produktiv (burimet) që konsumohen për zbatimin e një veprimi gjatë një periudhe të caktuar kohe.

- Daljet

Produktet që prodhohen nga një veprim i shërbimeve dhe organeve administrative të Autoriteteve Lokale, në një periudhë të caktuar kohore.

Ato mund të janë produkte me natyrë fizike (siç janë rrugët, uji i pijshëm) ose ofrimi i shërbimeve të paprekshme për lokale (p.sh. teatri ) ose vendimmarrija dhe prodhimi i rregulloreve.

- Rezultatet

Ndryshimet e kryera të karakteristikave të përfituesve, shërbimeve, zonës dhe mjedisit të brendshëm të bashkisë për shkak të zbatimit të një ose më shumë veprimeve të EP. Rezultatet krahasohen me objektivat e përgjithshme dhe specifike të EP për të vlerësuar efektivitetin e veprimit të Bashkisë.



## REFERENCAT

- Agoruka, *Vlerësimi i Shpejtë i Zhvillimit të Zinxhirit të Vlerës së Turizmit në Zonën e Pukës*, 2016
- Agoruka, *Analiza e Zinxhirit të Vlerës të Djathit të Dhisë në Rrethin e Pukës – Analiza e Zinxhirit të Vlerës të Prodhimeve të Dyta të Pyllit në Rrethin e Pukës*, 2016
- Agropuka, *Gjendja e bimëve mijekësore – tanifere dhe frutave të pyllit në territorin e Bashkisë Pukë*
- Agoruka, *Studim Gjinor në Rrethin e Pukës*, 2013
- Bashkia Pukë, *Plani Strategjik i Zhvillimit të Bashkisë Pukë*, 2008
- Bashkia Pukë, *Plani Operacional i Zhvillimit Vendor*, 2016
- Bashkia Pukë, *Guida Turistike*, 2017
- Co-PLAN, *Towards Regional Operational Programming*
- FZHSH, *Plani Rajonal Shkodër-Lezhë 2005-2020*, Eptisa, 2006
- INSTAT, *Tipologjia e njësive vendore/ komunave*, 2014
- Kennedy C., Cuddihy J. and Engel-Yan J. (2007), *The changing metabolism of cities*, Journal of Industrial Ecology, vol. 11 (2),
- Këshilli i Qarkut Shkodër, *Skenarët e Zhvillimit Nënrajonal në Qarkun Shkodër*, 2015
- Ledio Allkja, *Changing Planning Cultures - The Case of Albania*, July 2012
- Sfera Studio Arkitekture, *Hartimi i projekt-preventivit të zbatimit për rikualifikimin urban të qendrës dhe liqenit të vogël të qytetit të Pukës - Raporti teknik i arkitekturës*, Dhjetor 2016
- UNDP, *Integrated Support for Decentralization Project “Working for Regional Development”*, Regional Disparities in Albania, 2010
- Universiteti Polis, Arizona State University, Metropolis sh.p.k, Bashkia Shkodër, *Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Shkodër*, 2016
- USAID, *Planifikimi dhe Zhvillimi i Territorit në Shqipëri- Manual Teknik*
- Wolman A (1965), The metabolism of cities. *Scientific American*, vol. 213 (3), p.179-190.

## PLANET DHE STRATEGJITË

Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin, 2015-2030

Plani i Integruar Ndërsektorial për Zonën Ekonomike Tiranë-Durrës, 2015-2030

Plani i Përgjithshëm Kombëtar, 2015-2030

Plani Kombëtar Sektorial i Turizmit për Rajonin e Alpeve Shqiptare

